

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 7

ÇËSHTJE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 7, pranverë 2008

Bordi botues:***Kryetar***

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Ambasador Pëllumb Qazimi Gj. Lt. (rez.)

Begator Mane - President i RO-GAT

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Ky numër u përgatit nga

Erjon Alikaj

Elira Hroni

*Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe
Kompania Private e Sigurisë RO-GAT, Tiranë*

PËRMBAJTJA

Friis Arne Petersen, Hans Binnendijk Nga qasja e plotë tek aftësia e plotë	7
Ron Asmus Rikonsiderimi i Partneriteteve të NATO-s për shekullin XX	16
Petr Lunak Tregimet e së kaluarës, mësimet për të ardhmen	20
Amb. Pëllumb Qazimi Pronësia rajonale në Çështjet e Sigurisë	25
Peter van Ham NATO-ja dhe Kthesa e Madonës: pse është vital një koncept i ri Strategjik	35
Keith Krause Drejt një Axxhende Praktike të Sigurisë Njerëzore	42
Intervistë Pjesë nga Seminari i Partneritetit për Paqen - Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike (MIK) dhe Planifikimi i Emergjencës Civile (PEC)	69
Qendra për studime të Sigurisë (QSS) Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) Drejt një qasje të re në parandalimin e krimit	75
Caroline Holmqvist Kompanitë private të Sigurisë. Rasti për rregullim	90

Kol. Zeno Jahaj

11 vjet në mbështetje të paqes. Kontribut domethënës i
Shqipërisë në Operacionin Paqeruajtës në Bosnje-
Hercegovinë 121

Brief summery in english 130

Friis Arne Petersen
Hans Binnendijk

NGA QASJA E PLOTË TEK AFTËSIA E PLOTË

Friis Arne Petersen dhe *Hans Binnendijk* argumentojnë se Samiti i Bukureshtit mund të jetë stad i duhur për ndërmarrjen e hapit tjetër drejt bashkëpunimit më të mirë civil-ushtarak.

Le të shohim se sa gjithëpërfshirës mund ta bëjmë këtë... Një projekt spanjoll në Afganistan i hartuar për të përmirësuar furnizimin me ujë, e tregon mënyrën duke përfshirë agjencitë e ndihmës, ushtrinë spanjolle, ushtrinë afgane dhe punonjësit lokalë.

Zhvillimi i një Qasjeje të Plotë ndaj bashkëpunimit civil-ushtarak paraqet një nga sfidat madhore me të cilat përballet Aleanca sot. Afganistani mbetet ilustrimi më i mirë i kësaj.

Çështja nuk është më nëse NATO-s i duhet kjo qasje por është përcaktimi i përmbajtjes.

Kjo nuk është një detyrë e lehtë përballë kompleksitetit të konceptit. Kërkohet më shumë punë për të farkëtuar një kuptim të përbashkët mbi qëllimin, natyrën dhe drejtimin e Qasjes së Plotë të Aleancës. Samiti i Bukureshtit do të jetë një tjetër gur i rëndësishëm vazhdimësie në këtë proces.

Si një shtojcë të rrugës formale të NATO-s, është e rëndësishme që të vazhdojmë dialogun informal, shkëmbimin e ideve dhe mbledhjen e mësimeve të marra mbi bashkëpunimin civil-ushtarak të NATO-s. Si një kontribut ndaj diskutimit transatlantik, janë zhvilluar dy workshop-e në Uashington, të bashkëdrejtuar nga Ambasada e Danimarkës dhe Qendra për Teknologjinë dhe Politikën e Sigurisë Kombëtare të Universitetit të Mbrojtjes Kombëtare.

Këto ngjarje bashkuan praktikantë, akademikë dhe diplomatë nga të dyja anët e Atlantikut, duke adresuar

parametrat e gjera të bashkëpunimit civil-ushtarak, si dhe specifikat e bashkëpunimit të NATO-s me organizatat ndërkombëtare. Pikat vijuese u ngritën në bazë të shume ideve dhe propozimeve të vlefshme që dolën gjatë këtij procesi për një Qasje të Plotë të NATO-s.

Si pikënisje, pesë propozime modelojnë çdo reflektim mbi këtë sfidë për Aleancën:

- Forcat e NATO-s janë aktualisht të angazhuara në operacione luftimi në Afganistan. Për të arritur fitore, Aleanca duhet të ketë një Qasje të Plotë ndaj operacioneve civil-ushtarake që bashkon burimet e saj, bashkëpunimin e saj me komunitetin ndërkombëtar dhe ç'është më e rëndësishmja punën e saj me Qeverinë e Afganistanit. Ky nuk është një debat për të nesërmen, është një kërkesë e të sotmes.
- NATO-ja nuk mund të ketë sukses në arritjen e qëllimeve të miratuara politike të Aleatëve në një operacion pa aftësi të mirëkoordinuara civil-ushtarake në mbarë fushatën.
- Aftësitë e mirëkoordinuara duhen planifikuar dhe zbatuar; ato kërkojnë trajnim të integruar. Praktikrat e mira dhe mësimet e marra duhet të përditësojnë programet e trajnimit dhe arsimimit për t'u kuptuar dhe përdorur. Ato nuk mund të arrihen përmes metodave ad-hoc.
- Deri tani, si një Aleancë ne nuk e kemi gjetur shtegun për ta kapërcyer ad-hoc-un. Megjithatë, kjo i ka kushtuar e vazhdon t'i kushtojë aleatëve burime të harxhuara dhe qëndrim më të gjatë (në misione ushtarake).
- Meqë shohim tek e ardhmja, i shikojmë misionet për NATO-n më komplekse, nëse ato udhëhiqen apo mbështeten nga Aleanca. Edhe nëse konkludojmë dhe zbatojmë propozimet për një Qasje të Plotë, i duhet kushtuar një energji shumë e madhe ndërthurjes së operacioneve të integruara civil-ushtarake nga terreni në shkollë dhe në arenën e ushtrimit. Përmirësimi i aftësive të NATO-s për të punuar me aktorë të tjerë, si BE-ja dhe OKB-ja, është vendimtare në këtë kontekst.

Ka dy grupe të ndryshme por të lidhura asetesh për përgatitjen e NATO-s si një organizatë që do të punojë ngushtësisht për një Qasje të Plotë – forcat ushtarake dhe

aftësitë vendimtare civile. Të dyja janë të domosdoshme nëse NATO-ja, brenda saj dhe me partnerët, do të arrijë bashkëpunimin optimal civil-ushtarak.

Së pari, komandat e NATO-s duhet të përcaktojnë burimet *ushtarake* të nevojshme për të arritur stabilitetin fillestar dhe rikthimin e shërbimeve kryesore menjëherë pas operacioneve ushtarake. Këto janë asete si policia ushtarake, CIMIC-i (Bashkëpunimi Civil Ushtarak), inxhinierët e ndërtimit dhe personeli mjekësor ushtarak. Këto forca kanë mision të lëvizin në terren menjëherë pas konfliktit dhe të punojnë me forcat luftarake që janë ende duke siguruar zonën. Ata duhet të ofrojnë siguri publike, qeverisje të përkohshme dhe shërbimet bazë. Këto forca duhet të jenë të informuar për anën kulturore dhe të mësuar të punojnë me popullata të traumatizuara dhe aktorë civilë, përfshirë OJQ-të që mund të jenë tashmë të pranishme në zonën e konfliktit.

Së dyti, organizimet ushtarake të NATO-s të çdo niveli duhet të jenë në gjendje të përgatisin dhe drejtojnë misione të integruar civil-ushtarake, kjo edhe nëpërmjet urave dyfish organizative lidhëse. Kjo kërkon ndarje të paracaktuar të informacionit, metoda gjithëpërfshirëse planifikimi, integrimin e rolit dhe së fundi mbështetje operacionale. Mbështetja ushtarake ndaj agjensive civile mund të jetë shumë e gjerë dhe përgjithësisht kërkon burime (makina, strehim, komunikim, siguri, furnizim etj.) që e tejkalojnë atë çka i duhet një njësie të vetme ushtarake. Ushtrimet dhe trajnimet e përbashkëta para misionit janë kyçe për të siguruar mirëkuptimin e përbashkët të qasjeve, kulturave dhe objektivave të organizatave të ndryshme.

Në misionet e Stabilizimit dhe Rindërtimit (S&R), ku ushtarakët dhe civilët do të integrohen ngushtësisht, forcat e NATO-s duhet të përpunojnë kërkesat e misionit për të adresuar katër fusha:

- Ushtria duhet të ofrojë një ambient të sigurt për veprimin e operacioneve civile të stabilitetit.
- Forcat e sigurisë duhet të mbrojnë viktimat e konfliktit po aq sa dhe të përpiqen të neutralizojnë autorët e dhunës së paligjshme.

- Ushtrisë do t'i kërkohet të ofrojë siguri fizike dhe mbështetje logjistike për civilët në veprim dhe të drejtojnë operacionet humanitare dhe të rindërtimit.
- Planifikimi ushtarak duhet përshtatur për të dhënë mundësinë për planifikimin e integruar civil-ushtarak.

NATO-ja ka procesin e vet të Planifikimit të Mbrojtjes (DDP) për të zhvilluar nevojat e forcës për operacionet ushtarake. Megjithatë, procesi i DDP-së nuk është shtrirë në zhvillimin e nevojave gjithëpërfshirëse civil-ushtarake.

Së pari, DDP-ja duhet të identifikojë aftësitë ushtarake për dislokimin e forcave fillestare të luftimit dhe për operacionet imediate të stabilitetit post-konfliktuale.

Së dyti, ajo duhet të zhvillojë paketa të qëndrueshme S&R për rastet pa luftime. Me këto plane, NATO-ja mund të ndjekë gjenerimin e forcës së aseteve të S&R-së në të njëjtën mënyrë si dhe të aseteve luftarake.

Gjithashtu, nuk ka asnjë ekuivalent të DDP-së për të mbledhur dhe menaxhuar burimet e nevojshme civile. Këto nuk duhet të zotërohen nga NATO-ja, por mund të vijnë nga burime të ndryshme (siç përshkruhet më poshtë). Megjithatë, drejtuesit politikë e ushtarakë të NATO-s duhet të njohin paraprakisht mbi çfarë burimesh civile mund të planifikojnë nivelin e gatishmërisë e aftësitë e tyre dhe çfarë mbështetje do të kërkojnë nga njësitë e dislokuara ushtarake.

Aftësitë civile që mund të integrohen me ato ushtarake mund të vijnë nga dy burime të mëdha.

Së pari, ato mund të vijnë nga asetet kombëtare të aleateve e partnerëve të NATO-s. Në fakt, si me asetet ushtarake ashtu edhe me ato civile – shumica e kapaciteteve zotërohet nga shtetet. Këto përfshijnë p.sh. departamentet ndëragjensi të qeverive anëtare. Mbështetja e kontraktorëve është bërë gjithashtu një faktor i madh në mbështetjen kombëtare. Nëse kjo duhet të jetë vërtet parësore dhe burimi më i sigurt për mishërimin e një Qasjeje të Plotë, ka arsye të konsiderohet ngritja e një kapaciteti modest të NATO-s për të koordinuar kontributin kombëtar dhe përpjekjet planifikuese.

Së dyti, mbështetja civile mund dhe zakonisht vjen nga organizatat ndërkombëtare, joqeveritare e shumëkombëshe, shumica me aftësi shumë të dëshirueshme dhe të specializuara. Partnerët kyç për NATO-n në këtë fushë janë të mirënjohur: OKB-ja, BE-ja dhe OSBE-ja. Partnerë të tjerë të mundshëm përfshijnë organizata dhe OJQ të mëdha, si Kryqi i Kuq.

Mbështetja dhe komunikimi reciprok janë nga parimet kyçe të përmbushjes sa më mirë të një qasjeje të plotë.

Kur punohet me këto organizata, sa më përpara e për sa më gjatë duhet miratuar një memorandum mirëkuptimi për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, veç punës specifike gjatë krizave nga statet e para të fazës së planifikimit përpara dislokimit. Shumë operacione kanë një mungesë të burimeve civile dhe komandantët ushtarakë janë të etur për partneritet me çdo burim të tillë cilësor. Kjo kërkon bashkëpunim me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë, joqeveritarë e shumëpalësh. Për çdo bashkëpunim civil-ushtarak, lidhja institucionale është esenciale në nivelet operacionale dhe taktike dhe teorikisht edhe në nivelin strategjik.

Fatkeqësisht, ndryshe nga mundësitë ushtarake, burimet civile rrallë janë të disponueshëm dhe të gatshëm në shkallë të gjerë për dislokimet në krizat aktuale. Identifikimi dhe dislokimi i burimeve të nevojshme civile mund të marrë shumë kohë. Aleatët duhet të konsiderojnë një trupë të qëndrueshme civile për reagimin ndaj krizave ndërkombëtare. Një mundësi e tillë mund të përdoret nga NATO-ja apo BE-ja duke qenë e disponueshme për të dyja organizatat. Thjesht përpilimi i një liste vullnetarësh dhe aftësish nuk mjafton. Këtyre burimeve duhet t'u sigurohet arsimim i specializuar dhe mundësi ushtrimi që i ekspozojnë ato në mjedisin operacional që u duhet të menaxhojnë.

Çdo Qasje e Plotë ndaj bashkëpunimit civil-ushtarak duhet të adresojë sektorët e drejtësisë, zbatimit të ligjit dhe të qeverisjes. Pa një përpjekje sistematike në këtë fushë, sigurimi i një tranzicioni të qëndrueshëm të zhvillimit dhe rindërtimit post-konflikt është provuar të jetë tepër i vështirë.

Vendimtare për këtë është trajtimi i problemit të krimit të organizuar që shpesh mbush hapësirat në qeverisje menjëherë pas luftimeve të mëdha. Kapacitetet civile duhet të marrin drejtimin e trajtimit të këtij kërcënimi destabilizues. Kjo kërkon planifikim të specializuar e të përparuar të inteligjencës dhe akses të vazhdueshëm informacioni nga agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit dhe nga qeveritë lokale. Nga ana tjetër ushtria duhet të lidhet ngushtësisht me fluksin e informacionit mbi aktivitetin kriminal dhe veprimet ligjzbatuese në zonën e tyre operacionale.

Një detyrë tjetër vendimtare civile në zgjidhjen e krizave është trajnimi i policisë. Këtu sërish, koherenca e ngushtë e përpjekjeve civile e ushtarake është çelësi për efektivitetin operacional. Drejtësia e zbatimi i ligjit mund të jetë një fushë e duhur për rritjen e bashkëpunimit mes NATO-s dhe BE-së, p.sh. përmes ngritjes së qendrave të përbashkëta të ekselencës me qëllim rritjen e të menduarit transatlantik dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta, bazuar në mësimet e marra, mbi mënyrën e zgjidhjes së kësaj sfide të vështirë në misionet e ardhshme të paqes.

Një sfide tjetër për t'u kaluar në ndërtimin e një aftësie të integruar gjithëpërfshirëse është detyra e komunikimit mes kulturave të ndryshme. Si shumë ushtarake të NATO-a që kanë diferencë kulturore, edhe organizatat civile kanë një kulturë unike. Operacionet në Afganistan e Kosovë provuan rrugët e vështira të komunikimit mes organizatave të cilat e patën të vështirë ta përballonin. Për organizatat civile që punojnë me një organizatë të fortë, të madhe dhe gjithmonë të pranishme ushtarake, individualiteti është i rëndësishëm. OJQ-të janë organizata të veçanta me kultura të paanshmërisë strikte që janë esenciale për vetëmbrojtjen dhe efektivitetin. Ushtria nuk duhet të bëjë asnjë veprim për të kompromentuar paanshmërinë e OJQ-ve.

Për të hequr barrierat mes partnerëve ushtarake e civilë, NATO-ja duhet të angazhohet në trajnimin, arsimimin, ushtrimin dhe planifikimin e integruar të personelit ushtarak e civil që mund të jenë duke vepruar së bashku. Duhet, gjithashtu, të theksojë si një prioritet kryesor

domosdoshmërinë për të ndarë informacionin horizontalisht e vertikalisht përmes rrjeteve.

Në përgatitjen për të punuar me organizata të tjera, duhen miratuar katër pika:

- Autonomia e vendimmarrjes dhe veprimtarisë. Kjo nuk pengon konsultimet e ngushta apo përmbushjen e marrëveshjeve të mëparshme, formalisht apo informalisht.
- Principet përkatëse të unitetit të përpjekjeve dhe unitetit të komandës janë thelbësore. Në shumë situata, operacionet e integruara ngushtë civil-ushtarake janë e vetmja rrugë për të arritur suksesin.
- Ka vetëm një rezervë burimesh civile e ushtarake mes vendeve aleate e partnere për operacionet. Këto asete i përkasin kryesisht vendeve që i vënë ato në dispozicion të organizatave, si BE-ja, NATO-ja apo OKB-ja.
- Vënia e mundësisë në një kanal apo mekanizëm ndër-organizate nuk pengon vënien e tij në një tjetër. Standardi është thjesht efektivitet. NATO-s mund t'i duhet të investojë në disa aftësi të kufizuara veçanërisht të plotësojë a punojë me BE-në kur është e mundur.

Organizatave më të fuqishme civil-ushtarake për bashkëpunimin transatlantik janë BE-ja dhe NATO-ja. Në përgjigje të krizave ekzistuese në Bosnje, Kosovë e Afganistan, këto dy organizata kanë krijuar kushte “në varësi të vendit” për të punuar së bashku. Një qasje shumë më e mirë është planifikimi për rastet ku bashkëpunimi BE-NATO funksionon siç duhet. Kjo është e mundur për një a dy vitet e ardhshme për hapat e mëdha në përpjekjet e shumta reciproke, përfshirë maturimin e përgatitjeve të BE-së për misione ushtarake e civile, integrimin e plotë të vetë kapaciteteve të NATO-s dhe të një mekanizmi për koordinimin e planifikimit dhe vendimmarrjes së shpejtë mes tyre.

Disa iniciativa që NATO-ja dhe BE-ja mund të marrin për të ndihmuar realizimin e këtyre qëllimeve mund të përfshijnë:

- Forcimin e vazhdueshëm të ESDP-së (Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes) ku është praktike.

- Kërkohe miratimi i aleatëve për mënyrat e rinovimit të efektivitetit dhe volitshmërinë e proceseve politike vendimmarrëse të NATO-s, formalisht dhe/ose informalisht.
- Racionalizimin e mëtejshëm të strukturës komanduese të NATO-s për të përshtatur pjesëmarrjen nga Franca dhe për komandim e kontroll më optimal, përfshirë një Qasje të Plotë në të gjithë nivelet.
- Kombinimi i një Qasjeje të Plotë ndaj mundësive dhe operacioneve, brenda NATO-s dhe përmes strukturave NATO-BE, si p.sh. një grup i qëndrueshëm planifikimi NATO-BE.
- Konsiderimi i ngritjes së një kuadri transatlantik për bashkëpunimin civil-ushtarak për të mbledhur sistematikisht përvoja, për të zhvilluar koncepte të përbashkëta dhe për të drejtuar trajnime e ushtrime për stafin zyrtar e ushtarak të angazhuar në rindërtimin e zhvillimin në misionet e paqes.

Këta hapa, nëse hidhen paralelisht, mund të lejojnë me kohën një evolucion që do të forconte NATO-n dhe BE-në dhe do t'u bënte apel interesave të gjithë aleatëve. Një përbërës themelor i suksesit do të ishte për gjithë aleatët përqafimi i gamës së gjerë të mundësive dhe roleve të NATO-s në praktikë, për shumë nga të cilat krerët e shteteve kanë rënë tashmë dakord parimisht t'ia japin Aleancës.

Ajo çka mund të konkludohet nga kjo ese e shkurtër mbi mundësitë reale civil-ushtarake që veprojnë brenda konceptit të Qasjes së Plotë, është që planifikimi dhe koordinimi paraprak, i integruar civil-ushtarak janë esenciale për arritjen dhe ruajtjen e suksesit të momenteve të para post-konflikt dhe për vendosjen e kushteve optimale për një rikthim në normalitet. NATO-ja ka qenë angazhuar për më shumë se 12 vjet në përgjigjen ndaj krizave për të mbrojtur interesat e popujve të NATO-s dhe këto misione nuk tregojnë shenja pakësimi.

Sa më efektiv të jetë ekipi civil-ushtarak aq më shpejt kalon operacioni në fazat pasardhëse e së fundi në kulminacionin

dhe tërheqjen e tij, duke zvogëluar kohën, kostot dhe fatkeqësitë civile e ushtarake. Ka një rrethanë shtrenguese për një mundësi dhe marrëveshje të qëndrueshme të NATO-s për planifikimin e përparuar dhe për ekipe të integruara e më efektive civil-ushtarake.

Me këtë, NATO-ja duhet të ketë parasysh se duhet të ridyfishojë përpjekjet e saj për të tejkaluar marrëveshjet e kufizuara aktuale ad-hoc dhe të bëjë një hap tjetër në Bukuresht për të siguruar që iniciativa e Qasjes së Plotë t'i afrohet më shumë Aftësisë së Plotë.

Friis Arne Petersen është Ambasadore e Danimarkës në SHBA.
Hans Binnendijk është Drejtor i Qendrës për Teknologjinë dhe Politikën e Sigurisë Kombëtare në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes, në Uashington.

Pikëpamjet e shprehura këtu janë personale të autorëve.

Ron Asmus

RIKONSIDERIMI I PARTNERITETEVE TË NATO-S PËR SHEKULLIN XX

Sot, kërcënimet e sigurisë janë botërore dhe jotradicionale. Është koha që edhe partneritetet e NATO-s të bëhen të tilla, thotë *Ron Asmus*.

Në vitet '90, partneritetet e reja të NATO-s ishin një komponent kyç i rinovimit të Aleancës për erën e pas Luftës së Ftohtë. Zgjerimi i NATO-s dhe ndërhyrja në Ballkan ishin në shumë mënyra hapat e reja më të mëdha strategjike të Aleancës.

Sidoqoftë, zhvillimi i mjeteve të partneriteteve të reja ndihmoi në parandalimin e shfaqjes së vijave të reja ndarëse pas zgjerimit dhe i mundësoi NATO-s ngritjen e marrëdhënieve me vendet e rëndësishëm strategjikë, por që nuk ishin kandidatë për anëtarësim, si dhe lehtësoi bashkimin e koalicionit të udhëhequr nga NATO-ja që ndihmoi ruajtjen e paqes në Ballkan. Prandaj, partneritetet ishin një pjesë vendimtare e suksesit të NATO-s në vitet '90 dhe të strategjisë së madhe të projektimit të stabilitetit në kontinent.

Në një analizë të mëvonshme, këto mjete partneritetesh të reja mund të duken si përshtatje e ndjenjës së përbashkët ndaj një realiteti të ri strategjik. Megjithatë, në atë kohë nuk ishte e lehtë për Aleancën të hapej ndaj vendeve jo-anëtare dhe t'i angazhonte ata.

Shumë prej nesh kujtojnë shumë mirë si na shikonin me dyshim kur sugjeruam këto hapa në fillim të viteve '90. Pak vite më vonë, NATO-ja zhvilloi Partneritetin për Paqe dhe më pas Aktin Themelues NATO-Rusi, Këshillin NATO-Ukrainë dhe EAPC-në. E risjell këtë histori vetëm për të nënvizuar pikëpamjen se e pamundura në dukje u zhduk dhe

Aleanca u tregua shumë fleksible dhe rinovuese vetëm atëherë kur u bë i qartë imperativi strategjik dhe konsensusi politik për të ndryshuar.

Sot jemi në një situatë të ngjashme. Anëtarët e Aleancës janë të pasigurt dhe të ndarë për qëllimin dhe strategjinë e ardhshme të përbashkët për NATO-n. Shumë nga sfidat e reja strategjike që po përballim shtrihen përtej Evropës dhe imponojnë angazhim në rajonet potencialisht të paqëndrueshme të botës ku Aleanca nuk ka shkelur kurrë. Por, sipas meje, ne nuk do ta zgjidhim problemin e objektit të gjeneratës së re të partneriteteve pa arritur qartësi më të madhe mbi këto çështje të gjera strategjike. Janë tre në veçanti që duhet të trajtojmë.

E para është roli i ardhshëm i partneriteteve të NATO-s me komunitetin aktual euro-atlantik. Ka një ndjenjë në rritje se këto partneritete dhe struktura po vjetrohen. Shumë nga anëtarët më të devotshëm të EAPC-së janë bashkuar dhe me Aleancën ose janë fokusuar në partneritete dypalëshe përmes MAP dhe instrumenteve të ngjashëm.

Rezultati është që EAPC-ja po gërryhet nga brenda. Meqë Rusia po bëhet më kategorike dhe antiperëndimore, ajo mund të jetë po ashtu më pak bashkëpunuese. Azia Qendrore po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për Perëndimin por asnjë nuk di si t'i përdori mjetet e partneritetit të NATO-s si pjesë të një strategjie të gjerë angazhimi. Sërish, problemi është mungesa e një strategjie të plotë të Perëndimit për të cilën mjeti i partneritetit të NATO-s mund të jetë një pjesë vendimtare.

Po Lindja e Mesme?

Çështja e dytë është roli i ardhshëm i NATO-s në Lindjen e Mesme. Dialogu Mesdhetar i NATO-s (MD) dhe Iniciativa e Bashkëpunimit e Stambollit (ICI) janë në gjendjen e braktisjes strategjike. Sigurisht, të dyja iniciativat janë shumë të ndryshme në origjinë. MD-ja u zhvillua në mes të viteve '90 si një plotësim dhe balancim i hapjes së NATO-s ndaj Lindjes. Ajo ka qenë gjithmonë si një lloj motre e dobët ndaj zgjerimit dhe partneritetit - me pak mbështetje strategjike nga

Aleanca dhe me më pak partnerë entuziastë nga ana tjetër. ICI i iniciuar në Stamboll pas 11 shtatorit dhe luftës së Irakut, ishte një hap i parë në njohjen nga NATO-ja të interesave të mëdha të Perëndimit në Gjirin Persik.

Sot, të dyja strategjitë vuajnë nga mungesa e qartësisë strategjike në NATO për objektivat tanë në Lindjen e Mesme. Ata janë mekanizma të lënë pa një vizion apo strategji të plotë. Ka vende në Lindjen e Mesme që kërkojnë lidhje më të ngushta me NATO-n dhe ku Aleanca është pengesa. Lista fillon me Izraelin, por përfshin vende të tjera mesdhetare si dhe anëtare të Këshillit të Bashkëpunimit të Golfit. Edhe këtu, NATO-ja nuk ka qenë e aftë të përfitojë nga këto hapje strategjike, në sajë të mungesës së një vizioni dhe strategjie të gjerë e të përbashkët të Perëndimit.

Çështja e tretë kyçe strategjike është partneriteti i mundshëm botëror në të ardhmen. Këtu përdorimi zyrtar i Aleancës i termit “vende kontakti” është tashmë tregues i ambivalentes. Operacionet, si i Afganistanit, kanë nevojë për NATO-n për të tërhequr kontribuuesit jo-evropianë për arsye të ndarjes së përgjegjësisë. Dhe kur shtete të tilla kontribuojnë më shumë se aleatët e NATO-s, ata natyrshëm duan të jenë në tryezën e vendimmarrjes. Kjo kërkon hapjen e vendimmarrjes së NATO-s në mënyra të reja.

Edhe këtu, gjejmë çështjen pa përgjigje të asaj së çfarë duan vërtet anëtarët e NATO-s. A janë vërtet partneritetet me Australinë apo Japoninë duke marrë më shumë trupa e para nga ato të parashikuara për misionet e udhëhequra nga NATO-ja? Apo a duhet ata të ndërtojnë marrëdhënie strategjike në rajone të reja e të rëndësishme? Është një rrugë me një kalim apo me dy drejtime lëvizjeje? A është një ushtrim ndarjeje përgjegjësish apo po provojmë të formësojmë dinamika të reja sigurie në rajone të rëndësishme? NATO-ja nuk mund e nuk duhet të shkojë gjithkund apo të zgjidhë të gjitha problemet. Por një udhëtim në Japoni apo Australi zbulon shpejt se këto vende po e arrijnë NATO-n për arsye shpesh të injoruara në debatin tonë aktual.

Çfarë duhet konkluduar nga gjithë kjo? Aleanca është sërish në një kryqëzim strategjik. Pasi rinovoi veten në vitet '90 për

të adresuar sfidën e ndërtimit të një rregulli të ri pas Luftës së Ftohtë në Europë, tani ajo përballet me nevojën e ririnovimit në një aktor sigurie të aftë për mbrojtjen e vlerave dhe interesave të anëtarëve në një stad më global. NATO-ja e ka bërë këtë kapërcim strategjik me Afganistanin, por ende nuk dihet nëse do ketë sukses. Suksesi i ISAF-it aty do t'i hapte derën reflektimit të ri dhe më ambicioz rreth partneriteteve dhe një roli të mundshëm të madh në sigurinë e Azisë Jugore e më tej. Dështimi mund të vejë në pikëpyetje të ardhmen e Aleancës.

Nuk duhet të jesh Clausewitz-i për të parashikuar që krizat si e Afganistanit nuk mund të jenë ngjarje të së kaluarës. Gjithashtu, është i arsyeshëm një bast i sigurt që tjetra do të jetë në Lindjen e Mesme. Nëse e ardhmja e këtij rajoni është vërtet çështja primare strategjike e kohës sonë, atëherë është sigurisht një anomali që aleanca e parë perëndimore nuk gjendet kurrkund kur duhet adresuar për shkak të mungesës së ndonjë strategjie të madhe të përbashkët, ku NATO-ja mund të bëjë pjesë. Më afër shtëpisë sfida e ripërkufizimit apo e partneritetit për Euro-Azinë mund të duket më pak e frikshme, por edhe këtu ka probleme reale.

Nëse ndokush i bën këto pyetje sot në Bruksel, ai ndeshet me një heshtje të rëndë - njësoj si në fillim të viteve '90. Partneritetet edhe një herë duket t'i përkasin kategorisë "shumë të rëndë për t'u mbajtur". Në realitet, kërkesa për partneritetin krijues si një mjet i ri për botën ku jetojmë, është më e madhe së kurrë. Problemi që duhet të zgjidhim është gjetja e qëllimit dhe vullnetit të përbashkët politik për të vendosur çfarë duam të arrijmë nga ana strategjike. Atëherë do të ketë mjaft njerëz të mençur në NATO që do të na ndihmojnë të modernizojmë arsenalin tonë të partneriteteve në ndihmë të arritjes së qëllimeve.

Ron Asmus është Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Transatlantike në Fondin Gjerman Mareshal të SHBA-së në Bruksel. Nga 1997-2000 ka punuar si Zv/Ndihmës Sekretar Shteti për çështjet europiane.

Petr Lunak

TREGIMET E SË KALUARËS, MËSIMET PËR TË ARDHMEN

Petr Lunak rishikon librin e fundit të Lawrence Kaplan, i cili hedh një vështrim mbi mënyrën si ndryshoi e ardhmja e Traktatit të Varshavës nga ajo e NATO-s dhe pse.

Pse NATO-ja nuk e ndoqi Traktatin e Varshavës në togun e skrapit të historisë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë?

Çdo përgjigje duhet të nisë me demaskimin e mitit që NATO-ja dhe kundërshtari i saj lindor ishin imazhe pasqyre të njëri-tjetrit.

Në 1955 udhëheqësi sovjetik Nikita Hrushov krijoi Traktatin e Varshavës në Europën Lindore si një përgjigje ndaj hyrjes së Republikës Federale Gjermane në NATO. Por, siç tregojnë provat arkivore të zbuluara së fundi, objektivi real i ngritjes së Traktatit të Varshavës ishte NATO-ja. Moska mendoi se mund të konkurronte NATO-n – që ishte atëherë një organizatë fuqiplote sigurie – me Traktatin e Varshavës, i cili mbeti një guaskë e zbrazët deri në fund të viteve '60.

Kur më në fund vendet e Europës Lindore shembën sistemin leninist dhe bllokun stalinist, ata gjithashtu shfrytëzuan të parën mundësi për t'u çliruar dhe nga aleanca e Hrushovit. Shumë parashikues shihnin një fat të ngjashëm për NATO-n, tashmë e mbetur pa armikun e saj. Do të kishte qenë logjike për NATO-n që dhe ajo të kishte vdekur, pa rënkime, nëse do të ishte një imponim i SHBA-së në Europën Perëndimore, e detyruar ta pranonte përballë kërcënimit ushtarak e politik sovjetik. Por NATO-ja nuk qe e tillë.

Siç shpjegon Lawrence Kaplan në librin e tij të fundit “NATO 1948: Lindja e Aleancës Transatlantike” ideja e një aleance të ngatërruar me çdo shtet europian ishte një lloj

mallkimi për SHBA-në që nga fillimi i shekullit XIX. Qëndrimi amerikan ndaj Europës Perëndimore, i përmbledhur në logjikën e Planit Mareshal, ishte që Europa Perëndimore duhet fillimisht të jetë e aftë të demonstrojë që mund të flasë me një zë të përbashkët e të veprojë në unison. Amerika mund të ndihmojë – por jo domosdoshmërisht të marrë pjesë – në marrëveshjet europiane me qëllim që Europa të ecë me këmbët e veta. Përkundër këtij sfondi, iniciativa për të bërë një marrëveshje mbi sigurinë transatlantike duhet të vinte së pari dhe kryesisht nga Europa.

Siç tregon gjerësisht Kaplani, është meritë e Sekretarit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe Ernest Bevin, i cili i kuptoi plotësisht ndjeshmëritë dhe caqet e SHBA-së. Menjëherë mbas takimit të dështuar të Ministrave të Jashtëm me sovjetikët në Berlin në dhjetor 1947, Bevini përdori aftësitë e tij për ta bërë jo vetëm të mundshme, por dhe të paevitueshme për SHBA-në të përfshihej në marrëveshjet e sigurisë europiane. I dyzuar e ndoshta edhe i pasigurt për drejtimin e tij real, Bevini filloi të aludonte se sa i dëshirueshëm do të qe një “bashkim shpirtëror i Perëndimit” rreth Britanisë dhe Francës – një bashkim që do të kishte lidhje sigurie me SHBA-në dhe Kanadanë.

Shanset nuk qenë të mira: me gjithë disa përjashtime, si John Foster Dulles, Senati i dominuar nga Republikanët ishte i prirur ndaj izolimit. Sekretari i Shtetit George C. Mareshal nuk u entuziazhua. Ndërsa një numër zyrtarësh të nivelit të mesëm të Departamentit të Shtetit u tërhoqën nga ideja e një aleance transatlantike, dy mitet intelektuale Charles Bohlen dhe George Kennan u kundërvunë. Ata argumentuan se përmbushja e dëshirave britanike do të militarizonte pa qenë nevoja Luftën e Ftohtë, kurse sfida që përballte Perëndimi ishte më shumë politike sesa ushtarake. Ministri i Jashtëm francez dhe heroi i Rezistencës Georges Bidault u rreshtua në mbështetje të përpjekjeve të Bevinit. Por atij iu desh të përballlej me akuzat nga e majta komuniste dhe e djathta golliste sipas të cilave fokusimi te sfida sovjetike ishte kundër interesit primar të Francës: siguri që Gjermania nuk do të përbënte më kurrë një kërcënim.

Zhvillime të tjera ndodhën në Europën Perëndimore dhe u desh aftësia e guximshme politike e Presidentit Truman që SHBA-ja të bënte hapin vendimtar.

Një vullnet i përbashkët për një mbrojtje të përbashkët.

Evropiano-perëndimorët treguan vullnetin për të mbrojtur të bashkuar veten e tyre duke firmosur Traktatin e Brukselit për mbrojtjen e përbashkët në mars 1948, pjesërisht si reagim ndaj pushtimit të Çekosllovakisë dhe vetëvrasjes së Ministrit të Jashtëm çekosllovak Jan Masaryk. Trumani u përgjigj duke deklaruar mbështetje ndaj këtyre përpjekjeve europiane.

Në realitet, Londra e kishte konceptuar Traktatin e Brukselit vetëm si një makinë për të mundësuar pjesëmarrjen e SHBA-së në marrëveshjet europiane të sigurisë. Në atë kohë, britanikët pyesnin veten rreth ndikimeve nëse mbylleshin në një strukturë vetëm europiane, pa SHBA-në.

Fatmirësisht për ata, dhe për të tjerët, një rezolutë e Senatit e sponsorizuar nga kreu i Komitetit të Punëve të Jashtme Arthur Vandenberg dhe i hartuar nga Departamenti i Shtetit përfshiu një fjali që mbështeste bashkimin e SHBA-së me marrëveshje të përbashkëta të sigurisë. Që në atë moment, Departamenti i Shtetit të SHBA-së mbështeti idenë e një Aleance transatlantike.

Kjo po ndodhte ndërsa sovjetikët po përpiqeshin të tërhiqnin Perëndimin në një raund tjetër negociatash për të ardhmen e Gjermanisë, fillimisht duke bllokuar rrugët drejt Berlinit Perëndimor – me përjashtim të atyre ajrore. Tashme e dimë që vendimi i Stalinit për të mos ndërprerë hyrjen ajrore ishte kundër rekomandimeve të ushtrisë sovjetike. Stalini, duke përjashtuar mundësinë që Perëndimi do të mund të mbështeste Berlinin Perëndimor nga ajri, zgjodhi të mos provokonte një konflikt ushtarak.

Por Stalini arriti krejt të kundërtën e asaj çka kishte shpresuar: Berlini jo vetëm që mbijetoi, por militarizimi i Luftës së Ftohtë siguroi një tjetër argument për krijimin e një aleance transatlantike sigurie. Sekretari i dytë i Përgjithshëm i

NATO-s, belgu Paul-Henri Spaak, perifrazoi njëherë se NATO-ja duhet t'i ngrejë një statujë Josif Stalinit. Edhe sot, ndokush mund të pyesë: pa shtrirjen e tepruar të dorës nga Stalini në Europën e Lindjes dhe në Berlin, a do të lindte NATO-ja? Fatkeqësisht, nuk gjejmë shumë analiza në librin e Kaplanit për sjelljen dhe keqlllogaritjet e sovjetikëve që kontribuuan në krijimin e aleancës së koklavitur.

Sipas deklaratës së NATO-s, Vandenbergut iu desh dhe një vit tjetër për të arritur në tekstin e Traktatit të Uashingtonit. Kaplani tregon se ndërsa shtysa fillestare për krijimin e një aleance formale transatlantike erdhi nga evropianët, janë amerikanët ata që kanë meritën e krijimit të strukturave funksionale. Ishin ata që insistuan që aleanca e ardhshme do të përfshinte jo vetëm pesë firmëtarët e traktatit të Brukselit (Franca, Britania dhe Beneluxi), por edhe të tjerë (Norvegjia, Islanda, Portugalia, Danimarka, Italia) si anëtare me të drejta të plota. Në të njëjtën kohë, përshtatja e minutës së fundit e Nenit kyç 5 për ta bërë tekstin e tij të pëlqyeshëm nga Senati, vetëm sa ilustroi vështirësitë që po kalonte SHBA-ja në formulimin e një angazhimi detyrues përballë Botës së Vjetër.

Krijimi i NATO-s nuk ndikoi menjëherë në balancën ushtarake mes Perëndimit e Lindjes, e cila gëzoi ende një avantazh të konsiderueshëm ushtarak në terren. Ajo çka ndryshoi ishte qartësia e angazhimit të SHBA-së ndaj mbrojtjes së Europës. Miratimi sovjetik ndaj sulmit të Koresë së Veriut kundër asaj të Jugut erdhi nga bindja se SHBA-ja nuk do të përfshihej në një konflikt në gadishullin korean. Por ideja që SHBA-ja do të ngulej në Europë, me një aleancë formale të miratuar në prill 1949, do të kishte qenë e paimagjinueshme.

Le të kthehemi te pyetja e fillimit. Pse, në ndryshim nga vendet e Traktatit të Varshavës, aleatët e NATO-s e ruajtën aleancën e tyre? Përgjigjja: sepse ata nuk e panë atë si një mjet të dominimit të jashtëm, por më shumë si një aleancë që për 40 vjet iu përshtat nevojave të tyre dhe që vazhdon ta bëjë që atëherë.

Por do të ishte e lehtë të thuhej se një e kaluar krenare garanton një të ardhme të lavdishme. Që NATO-ja të vazhdojë të jetë e përshtatshme, Aleatët duhet t'i japin fund konflikteve

në Ballkan, të kontribuojnë në luftën kundër terrorizmit dhe përveç të tjerash të marrin përsipër ISAF-in në Afganistan. Ata duhet të jenë të gatshëm për të vazhduar investimin në aftësitë ushtarake dhe operacionet e nevojshme.

Një detyrë jo e lehtë. Por e tillë nuk ishte as krijimi i aleancës në fund të viteve '40.

*Lawrence S. Kaplan: "NATO 1948: Lindja e Aleancës Transatlantike",
botuar nga Rowman dhe Littlefield, Nju Jork, 2007.*

*Dr Petr Lunak është një oficer ndërlidhës informacioni
me Republikën Çeke, Rusinë dhe Moldavinë në
Divizionin e Diplomacisë Publike,
Shtabi i Përgjithshëm i NATO-s, Bruksel.*

Amb. Pëllumb Qazimi

PRONËSIA RAJONALE NË ÇËSHTJET E SIGURISË

Objektiv i përbashkët – Integrimi European dhe Euro-Atlantik

Objektiv parësor i vendeve të Evropës Juglindore është forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes gjithë shteteve të rajonit, për transformimin e rajonit në një zonë paqe, sigurie, qëndrueshmërie dhe bashkëpunimi. Prirja europiane e Ballkanit është e padiskutueshme. Synimi është krijimi i një Europe Juglindore, e ardhmja e të cilës mbështetet në paqe, demokraci, prosperitet ekonomik dhe integrim të plotë në strukturat europiane dhe euro-atlantike.

Integrimi në BE dhe NATO përmes meritave

Çdo hap zgjerimi në strukturat europiane dhe euro-atlantike prezanton sfida të reja për integrimin e gjerë politik dhe ekonomik të BE-së dhe NATO-s. Problemi i stabilitetit dhe të ardhmes së Ballkanit është një problem europian, përderisa stabiliteti në Europë varet në një kuptim të gjerë në stabilitetin e rajonit të saj juglindor. Për këtë arsye të gjithë vendet europiane kanë të drejtën dhe detyrën të marrin pjesë në procesin e përshtatjes së vendimeve, si edhe të marrin përgjegjësi së bashku për vendimet e marra. Milan Kucan, ish-Presidenti i Sllovenisë, thekson se brenda rajonit më vite, qartazi nuk ka zgjidhje. Duke vijuar, konsiderohet jetike se për sa parimet janë përcaktuar, të jenë përshtatur pozicionet që do të mbështesnin perspektivën realiste të përfshirjes së vendeve të këtij rajoni në proceset europiane. Dhe kjo nuk

mund të jetë thjesht premtim, por një angazhim i fortë në ofrimin e asistencës, që këto vende të mund të plotësojnë me sukses kërkesat për përfshirje dhe më vonë të jetojnë me sukses dhe me përgjegjësi brenda një Europë të integruar. Të jetuarit me përgjegjësi nënkupton meritimin e integritit.

Kushtet e vlerave, si politike dhe ekonomike janë të njëjta për të gjitha vendet. Kështu, është i rëndësishëm krijimi i një perspektive realiste përfshirjeje në proceset e integritit europian - perspektivë e cila do të siguronte për njerëzit e të gjitha vendeve jo vetëm prosperitet të madh dhe siguri, por gjithashtu një jetë në përputhje me standardet dhe vlerat demokratike, të cilat përbëjnë thelbin e idesë europiane. Pra, integrimi nuk ka si të falet, ai duhet të meritohet nga secili prej vendeve.

Të gjithë bien dakord për një “Europë të vlerave të njëjta”. Parimet e njëjta të lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të një gjyqësori të pavarur janë ndërtuar mbi bazën e vlerave europiane. Në Europë ka vend për të gjithë vendet europiane, por gjithmonë duke ndarë të njëjtat vlera përmes realiteteve që ofrojnë siguri, të drejta humane, tregje pune dhe mirëqenie.

Reforma në sektorin e sigurisë dhe rajoni

Në Europën Juglindore përmes shumë nismave dhe veprimtarive është inicuar dhe realizuar një spektër i gjerë bashkëpunimi në fushat politike, ekonomike, të sigurisë etj. Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë ka krijuar kushte më të mira për mirëbesim dhe siguri në rajon. Reforma në sektorin e sigurisë dhe qeverisja e sektorit të sigurisë në Europën Juglindore përfaqësojnë një çështje kyç për rajonin, rajon që ende bën përpjekje për të lënë pas të kaluarën e turbullt. Nga ana tjetër, integrimi i vendeve të Europës Juglindore përfaqëson një përmirësim masiv të sigurisë për të gjithë Europën.

Integrimi në Bashkimin Europian dhe në NATO, pjesë qendrore e axhendës së vendeve të rajonit, përbëjnë një shtytje

unike për reformën në institucionet e sigurisë. Megjithatë, evidentohet fakti se jo rrallë, është më tepër e fokusuar në ripërshtatjen e legjislacionit. Lidhshipi politik i institucioneve të sektorit të sigurisë ka nevojë për të ndryshuar dhe investuar në përmirësimin e kulturës institucionale, me synim rritjen e efektivitetit dhe zhvillimin e pronësisë lokale për reformat. Shpesh, në praktikë evidentohet se nisma politike ndaj reformave, përfshin sektorin e sigurisë, ose reflektojnë axhendën e ndërkombëtarëve dhe pritjet e tyre, ose përfaqësojnë nisma politike për të mbështetur objektiva të caktuar politikë partiakë. Gjithashtu, shpesh politika të rëndësishme publike të sektorit të sigurisë zhvillohen mbi bazë nevojash të perceptuara dhe përpunuara në nivel lokal, si nga institucionet publike ashtu dhe nga aktorë të shoqërisë civile.

Dokumentet e Strategjive të Sigurisë Kombëtare në vendet e rajonit në një nivel të caktuar qëndrojnë si dokumente formale, më tepër referuar ndërkombëtarëve dhe jo si dokumente kombëtarë që drejtojnë reformën në sektorin e sigurisë. Drejtues dhe ekspertë të sektorit të sigurisë pranojnë nevojën e një procesi më të hapur e më përfshirës në riformulimin e dokumenteve të Sigurisë Kombëtare. Për më tepër, shtrohet nevoja e funksionimit të institucioneve udhëheqëse përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tyre.

Mbikëqyrja parlamentare e Sektorit të Sigurisë duhet të zhvillojë sistem të rregullt seancash dëgjimore dhe veprimtari mbikëqyrëse për sektorët e sigurisë. Komisionet parlamentare përkatëse, në kushtet edhe të mungesës së ekspertizës së plotë, do të mund të kompensojnë edhe mungesa, në mënyrë demokratike do të përmirësojnë qeverisjen e sektorit të sigurisë përmes insistimit për një bashkëpunim më të mirë dhe përfshirjen e ekspertëve nga sektori jo qeveritar.

Progresi i realizuar në bashkëpunim rajonal përbën start të mirë dhe premtues, por jo shumë efektiv përderisa në njëfarë mënyre dhe në mënyrë pasive ndjek drejtime të caktuara thjesht sepse ato janë në axhendën integruese në BE dhe NATO. Kështu, shumë nisma ekzistuese në nivel të lartë janë të lidhura me sponsorizimin ndërkombëtar dhe përbëjnë një proces që nuk zotërohet si duhet në plan bilateral apo rajonal.

Pra, është e nevojshme të adresohen dhe të bashkëpunohet në nivel rajonal për kërcënimet e rreziqet ndaj sigurisë.

Në rastin e Shqipërisë, për shembull, mendohet se nisura rajonale nuk duhet të provokohet thjesht nga rrethanat, por të institucionalizohet në forma efektive bashkëpunimi. Në rastin e Bosnje-Hercegovinës, fokusi aktual i vendit për Integrimin Euro-Atlantik evidenton neglizhim të potencialeve për bashkëpunim rajonal në fushën e sigurisë. Deklarimet apo qëndrimet politike, p.sh. ekzistojnë në politikën e mbrojtjes, ku dhe përcaktohet për bashkëpunim më të madh rajonal për sigurinë. Njëkohësisht, mungesa e dukshme e ndjenjave negative ndaj fqinjëve të Ballkanit Perëndimor është tregues i fortë për vendosjen e një bashkëpunimi rajonal më të madh për sigurinë. Megjithatë, vlerësohet se pak është bërë për të shfrytëzuar mundësitë e krijuara.

Ndërkohë që të gjithë vendet e rajonit aspirojnë për t'u bërë pjesë e familjes europiane dhe euro-atlantike, ato kanë rastin të kontribuojnë në zhvillimin e një sensi më të madh të sigurisë kolektive mes tyre, e më tej për forcimin e këtij sistemi të ardhshëm të sigurisë kolektive. Dhe nëse këto sfida afatshkurtër të sigurisë trajtohen si duhet, atëherë ato ndihmojnë në arritjen e objektivave të sigurisë kolektive që ato synojnë duke u përballur me sukses edhe me sfidat afatgjata të sigurisë.

Në rastin e Kroacisë, anëtarësimi i saj në integrimet dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e procesit të globalizimit, dhe bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare, është përgjigjja më e mirë ndaj sfidave. Dhe, në nivel rajonal, sidomos pas 11 Shtatorit, është konsideruar si shumë i rëndësishëm krijimi i një zone sigurie nën rajonale në Europën Juglindore. Gjithashtu, konsiderohet i rëndësishëm bashkëpunimi rajonal funksional, si dhe shkëmbimi i informacionit mes agjencive të policisë dhe të zbulimit. Kjo mundëson luftë të përbashkët rajonale kundër terrorizmit, si pjesë e luftës globale kundër terrorizmit. Mesazhi kryesor, i cili evidentohet nga mësimet e nxjerra nga zhvillimet aktuale në rajon është se vetëm në sektorë të vendosjes së ligjit rajonal në fushën e sigurisë, i cili do të jetë

në gjendje të përballet me kërcënimet dhe sfidat e reja të sigurisë rajonale.

Ndërkohë, në rastin e Maqedonisë, megjithëse dokumentet kombëtarë të sigurisë nuk identifikojnë fusha konkrete të bashkëpunimit rajonal si instrumente të zgjidhjes të problemeve praktike të sigurisë, drejtuesit e sektorit të sigurisë kanë identifikuar mundësi të ndarjes së kostos lidhur me sisteme rajonale të sigurisë që kanë kosto të lartë.

Një tjetër problem që haset shpesh në vendet e Ballkanit Perëndimor është mungesa e dialogut me publikun në fushën e politikës. Politikanët jo rrallë ndodh që nuk shkëmbejnë informacion, apo nuk angazhohen në një dialog konstruktiv, i cili mundëson që publiku të kuptojë çështjet aktuale, si dhe opsionet e ardhshme.

Qeveritë dhe shoqëria civile duhet të fillojnë të theksojnë ndjesinë kolektive jo vetëm për të drejtat, por gjithashtu edhe për përgjegjësitë, duke dalë nga gjendja e vetëm reagimit ndaj problemeve, por duke përcaktuar në mënyrë aktive axhendën e sigurisë njerëzore për t'i parandaluar ato. Na duhet në mënyrë pro aktive të gjejmë e përdorim çdo mundësi për të bërë që publiku të kuptojë se të gjithë ne do të jemi më të sigurtë kur punojmë së bashku për të realizuar shumicën e nevojave tona bazë. Është rruga e duhur që të gjithë ne të kuptojmë dhe pranojmë këtë realitet, i cili kërkon një përgjigje të përbashkët. Rajoni mund të ecë drejt Bashkimit Europian vetëm përmes demokracisë dhe stabilitetit.

Çfarë tregon përvoja

Vendet e Europës Juglindore kanë treguar se ato kanë krijuar përvojë për bashkëpunim në fushën e sigurisë e të çështjeve të mbrojtjes, duke përfshirë si qeveritë ashtu edhe sektorë të tjerë të shoqërisë civile, të angazhuara drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti me problemet e sigurisë. Ndër shembujt e shumtë, mund të përmendim tre: angazhimi i suksesshëm gjashtë-mujor i shtabit të SEEBRIG-ut në Afganistan, në 2006, të gjithë veprimtarinë në kuadrin e Kartës SHBA-A3, duke

veçuar angazhimin që vijon edhe sot të Ekipit të Përbashkët Mjekësor të dalë nga të tre vendet e Kartës. Karta e Adriatikut përfaqëson një program dhe një shembull të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal; krijimi i “Aleancës Civile 08” nga Organizma Jo Qeveritare nga të tre kryeqytetet e Kartës dhe pikërisht IDN në Shqipëri, IMO në Kroaci, FORUM në Maqedoni, me synim rritjen e mbështetjes publike për anëtarësim në NATO. Si të gjithë përballemi me një botë të globalizuar. Diçka që ndodh shumë larg, p.sh. në Afganistan, influencon edhe gjendjen në Europën Juglindore. Përderisa gati të gjithë vendet e rajonit janë angazhuar si pjesë e Komunitetit ndërkombëtar për një situatë shumë larg rajonit, pse jo të mos bashkëpunohet për problemet e sigurisë në rajon.

Pronësia rajonale dhe bashkëpunimi

Pronësia rajonale në çështjet e sigurisë është e një rëndësie të veçantë. Transformimi po bëhet gjithnjë e më kërkuar dhe më kompleks. Kërkohen liri civile, siguri individuale dhe siguri në tërësi, gjyqësor i pavarur dhe qeverisje e mirë, që ecin paralelisht me ekonominë e tregut dhe iniciativën private dhe atë të sipërmarrjes - mundësisht për krijimin e një shoqërie normale. Në çdo shoqëri, njerëzit kanë nevojë për një perspektivë të qartë me qëllim që të zhvillohen dhe të shfaqin aftësitë dhe krijimtarinë e tyre. Standardet europiane, si një paketë vlerash demokratike dhe civile, janë të njëjta për funksionimin edhe të sektorit të edukimit, shëndetit dhe kujdesit shëndetësor, shërbimet e përgjithshme, mbrojtjen e mjedisit, organizatat jo qeveritare dhe kështu me radhë.

Duke vlerësuar përvojat e tashme dhe ato të kaluara njëherazi në nivel kombëtar dhe rajonal, kushdo mund të dallojë rolin e rëndësishëm të ndërkombëtarëve për të siguruar mbështetje ndaj zhvillimit, monitorimin e reformës në sektorin e sigurisë dhe inkurajimin e bashkëpunimit. Strategjia e ndërkombëtarëve në vendet e rajonit duhet të kalojë në më tepër bashkëpunim dhe ndërveprim të kapaciteteve ekzistuese lokale, madje edhe duke i përmirësuar ato. Forcimi i aktorëve

lokalë, pra kombëtarë në të gjithë këtë proces do të rezultojë në efektivitet dhe qëndrueshmëri të veprimeve dhe të reformës.

Kjo është arsyeja përse Bashkimi European nuk ka si të neglizhohet. Ekzistojnë një numër i madh kërkesash, gjithashtu një numër i madh standardesh për t'i arritur. Pra, BE është e nevojshme për t'u këshilluar, monitoruar, asistuar dhe ndihmuar. Por, vendet e Europës Juglindore duhet të ushtrojnë pronësinë dhe të kenë seriozitet në këtë drejtim, duke demonstruar maturi dhe aftësi përmes rezultateve konkrete dhe praktike në fushat respektive. Është pikërisht koha për përafrim e veprim rajonal.

Cilësia e të ardhmes të gjithë vendeve varet në nivel të konsiderueshëm në aftësitë e tyre për të marrë pjesë aktive dhe konstruktive në procesin e bashkëpunimit rajonal. Transformi i gjeometrive aktuale të ndryshme integruese dhe anëtarësuese në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve fqinjë në dimension europiano-perëndimor ekonomik-politik-gjeostrategjik të Europës Juglindore, është një sipërmarrje që rajoni duhet të punojë ngushtë dhe së bashku. Ka shumë gjëra që mund të përmirësojnë Europën Juglindore, duke bërë çdo vend individualisht më shumë të integruar, funksional dhe të përshtatur ndaj prirjeve globalizuese. Kjo vetëm do të përmirësonte imazhin e rajonit ndër votuesit e BE-së dhe do të ndërgjegjësohte politikanët e BE-së se rajoni është maturuar dhe përgatitur për t'u bërë pjesë e Bashkimit European. Duke vepruar në këtë mënyrë, rajoni mund të shndërrohet në më pak i ndikueshëm nga një sërë influencash negative.

Nëse në nivel rajonal vendoset për diçka, kjo përfaqëson vetëm germën e parë të alfabetit, pra germën "A". Deri te germa e fundit është një hapësirë e madhe që duhet mbushur. Nuk është detyrë e ndërkombëtarëve për të mbushur këtë hapësirë. Është kryesisht e rajonalëve, pra e vendeve të rajonit tonë.

Po rreth pronësisë? Është shumë e rëndësishme dhe njëherazi produktive të marrësh parasysh dhe të ushtrosh çështjet e koordinimit dhe bashkëpunimit në nivel rajonal.

Pronësi rajonale do të thotë të bëhesh pronar, të zotërosh aftësitë e kërkuara dhe të nevojitura, si dhe aftësitë e trajtimit të problemeve, përfshirë çështjet e sektorit të sigurisë. Kjo nënkupton kuptim, komandim (por jo domosdoshmërisht në kuptimin ushtarak), drejtim, monitorim, vlerësim, udhëheqësi.

Kuptim nënkupton të përfshish dhe të kuptosh përbërësit e paraqitur të problemit.

Komandimi i referohet aftësisë për të drejtuar, urdhëruar, realizuar diçka me ose pa fuqi autoriteti.

Drejtim do të thotë të kesh fuqi ose autoritet për të rregulluar, parandaluar, verifikuar, drejtuar ose komanduar.

Monitorimi i referohet procesit që lejon dikë të shikojë, dëgjojë, mbikëqyrë, ose të qëndrojë në lidhje me diçka, ashtu si edhe të këshillojë, paralajmërojë ose anulojë.

Vlerësimi i referohet njohjes së vlefshmërisë, perceptimit të qartë, kuptimit, përfshirjes, njohjes së detajeve.

Udhëheqësia (leadershipi) nënkupton artin e inkurajimit të njerëzve për të bashkëpunuar dhe në mënyrë entuziaste e të bindur të ndërmarrin veprim drejt arritjes së objektivave.

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë duhet të nënkuptojë bashkëpunim. Donatorët ndërkombëtarë mund të mbështesin vetëm programe që vërtetësisht kërkojnë nga nevojtarët. Të gjithë qeverive të rajonit u duhet të kenë vendosmëri për të shtyrë përpara reformën në sektorin e sigurisë, gjë e cila kërkon angazhime konkrete dhe përcaktim përparësish.

Kjo bëhet më se e vërtetë në kushtet specifike të Ballkanit Perëndimor, ku disa elementë të reformës në sektorin e sigurisë mund të shfaqen politikisht rrishtuese për qeveritë. Angazhimi politik duhet të gjenerohet si pjesë e të gjithë procesit. Mund të ndodhë që ministrinë e mbrojtjes, ministrinë e punëve të

jashtme dhe autoritete të lartë të mbrojtjes e kanë angazhimin e tyre. Por derisa ata nuk marrin mbështetje të plotë nga zyrat e presidentit, kryeministrit dhe ministrisë së financave, momenti i reformës nuk mund të kapet. Të sigurosh pronësinë rajonale do të thotë të përcaktosh përparësitë dhe gjithashtu të krijosh kapacitete ndërtuese në qeveritë respektive.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë është shumë kërkuar. Dështimi i reformës në sektorin e sigurisë dhe në qeverisjen e sektorit të sigurisë në njërin nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ka ndikime të drejtpërdrejta në sigurinë e të tjerëve. Vetëm po të marrim parasysh problemin e trafikeve ilegale, krimin e organizuar dhe kështu me radhë, gjë që bën menaxhimin e integruar të kufijve të domosdoshëm, kuptojmë sa i nevojshëm është bashkëpunimi. Gjithashtu, në këtë botë të globalizuar, asgjë nuk mund të arrihet në rajon, duke pasur vetëm angazhimin e vendeve individualisht. Efektiviteti arrihet vetëm përmes bashkëpunimit rajonal. Pra, pronësia rajonale në fushën e sigurisë shndërrohet në domosdoshmëri.

Me pak fjalë, pronësia rajonale në problemet e sigurisë mund të realizohet nëpërmjet: vizionit të qartë; objektivave të qarta për integrim në BE dhe në NATO; njohjes së përgjegjësive; ushtrimit të përgjegjësive; njohurive; marrjen parasysh të mësimave të nxjerra; përdorimit të ekspertizës; ecjes përmes programeve; ushtrimit të lidërshiptit; ndjekjes së rezultateve.

Përmirësimet aktuale të klimës politike në rajon, fryma e re në bashkëpunim dypalësh e shumëpalësh, mentaliteti i ri dhe kontributet individuale të vendeve të rajonit shërbejnë për krijimin e një imazhi pozitiv për rajonin dhe ridimensionimin e rolit të rajonit të Europës Juglindore në raport me NATO-n dhe Bashkimin European.

Përfundime

Reforma në sektorin e sigurisë dhe qeverisja e sektorit të sigurisë ofrojnë një sërë përfitimesh për vendet e Europës Juglindore.

Bashkëpunimi rajonal në çështjet e sigurisë e të mbrojtjes sjellin përfitime për të gjithë qeveritë e vendeve të rajonit, për njerëzit, mirëqenien e tyre, për paqen e stabilitetin në rajon dhe në Europë.

Pronësia rajonale në çështjet e sigurisë demonstroi maturi për të gjithë vendet e rajonit, bind BE-në dhe votuesit e BE-së për progresin e bërë nga vendet e rajonit në rrugën e tyre të integritetit evropian.

Marrja e përgjegjësisë për pronësinë rajonale në çështjet e sigurisë dhe ushtrimi i kësaj përgjegjësie, përfaqëson një sfidë reale. Për më tepër, ajo kërkon kuptim të mirë, lidhshmëri, kontakte rajonale produktive, edukim dhe aftësi, nisma që mbulojnë fusha e nivele përfshi lidhshmërinë dhe administratën, shoqëruar nga programe të qarta dhe veprim.

Pronësia rajonale në çështjet e sigurisë nuk do të thotë shmangie e BE-së. Ekziston një konsensus i gjerë mes vendeve të BE-së që ajo do të vijojë të jetë e angazhuar në çështjet e sigurisë dhe ndërtimin e reformës në sektorin e sigurisë në të gjithë vendet e Europës Juglindore. Lidhshmëria e BE-së inkurajon dhe shtyn zhvillimet në rajon. BE monitoron dhe kujdesshëm ndjek progresin e çdo vendi kandidat ose kandidat potencial.

Qendra rajonale, apo kombëtare të trajnimit e të edukimit në çështjet e sigurisë, por edhe organizata jo qeveritare me mision në këtë fushë, kanë shumë për të bërë në ofrimin e edukimit, si dhe në inicim e organizim të veprimtarive rajonale që synojnë pronësinë rajonale në çështjet e sigurisë.

Peter van Ham

NATO-JA DHE KTHESA E MADONËS: PSE ËSHTË VITAL NJË KONCEPT I RI STRATEGJIK

Rimodelimi i NATO-s është urgjent, sipas *Peter van Ham*.

Këtu, ai argumenton se riformatimi i NATO-s duhet të fillojë me përpjekjen për të krijuar një Koncept të ri Strategjik.

Tregimi i rrugës: Biznesi e përdor Madonën si një model i rolit të vetërinovimit. Tani është radha e NATO-s.

Firmat e pasura e rinovojnë veten e tyre çdo disa vjet. Pa rinovim, ato humbin fuqinë e tregut dhe bëhen të papërshtatshme.

Kjo është arsyeja pse NATO-ja ka nevojë për sipërmarrës politikash që janë të gatshëm t'i japin Aleancës një kontratë të re jetese dhe një fokus të ri.

Sot, është vështirë të gjesh një sfidë të Perëndimit që NATO-ja nuk është detyruar ta fusë në axhendën e saj të mbingarkuar. Krahas detyrave tradicionale, si mbrojtja territoriale dhe paqeruajtja, tani Aleanca merret dhe me përhapjen e Armëve të Shkaterrimit në Masë (WMD), mbrojtjen raketore dhe sigurinë informatike (cyber).

Në shumëfunktionalitetin e saj, NATO-ja fillon t'i ngjajë një biçaku zviceran me të gjitha pjesët e tij të ekspozuara. Por siç e dimë të gjithë, biçakët e pambyllur janë problematikë dhe ndërkohë që përgatiten për të bërë gjithçka, ata nuk vlejnë për asgjë. Për këtë arsye NATO-ja duhet të përshtatë veten e saj, duke filluar me një rishikim të konceptit të saj strategjik të vjetruar.

Koncepti aktual strategjik, që është formulimi themelor i misionit të Aleancës, u miratua në prill 1999, në mes të fushatës së NATO-s në Kosovë. Kështu, ky dokument kyç daton para

ndryshimit strategjik të modelit 9/11, si dhe misionit të NATO-s në Afganistan, i pari jashtë zonës euro-atlantike.

Në të kaluarën, aleatët nuk përgatisnin shpesh koncepte strategjike (në 1952, 1967, 1991 dhe 1999), por historia duhet të ecë me shpejtësi në ditët tona. Kjo është arsyeja pse Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer kërkoi një koncept të ri strategjik në shkurt 2007, duke argumentuar se operacionet në zhvillim në Afganistan e Kosovë i kishin dhënë Aleancës “leksione të sigurisë së shekullit XX. Ne duhet t'i mbajmë ato në dokumentet tanë udhërrëfyes në mënyrë që të zbatohen në praktikë”.

Megjithatë, shumë zyrtarë në kryeqytetet e NATO-s janë të shqetësuar se mos rreziqet e një rishikimi të tillë strategjik janë shumë të medha. Ata frikësohen se mos kjo ringjall debatet transatlantike të 2002-2003-shit dhe hap plagët që sapo kanë filluar të shërohen. Gjithashtu, ata sugjerojnë se me dokumentin Drejtimi Gjithëpërfshirës Politik, miratuar në nëntor 2006 në Samitin e Rigës, është gjetur një zgjidhje për situatën e vështirë të NATO-s.

Shkelmimi i bidonit në rrugë do të ishte ende një gabim serioz. Ky mentalitet “nëse nuk është prishur, mos e rregullo” nënvleftëson sfidat strategjike që ndesh NATO-ja sot.

Në debatin aktual, kancelaria gjermane Anxhela Merkel është e vetmja lidere politike që ka deklaruar qartë se ajo do të pëlqente të shihte një koncept të ri strategjik të miratuar nga Samiti i NATO-s më 2009. Kjo do të jetë e vështirë për t'u arritur në kushtet e kalendarit elektoral në SHBA ku do të fillojë punë një administratë e re në janar 2009 dhe do të kërkojë disa muaj për të krijuar një ekip të ri të përbashkët.

Paraqitja e një koncepti të ri strategjik në përvjetorin e 60-të të NATO-s do të ishte një dhuratë e merituar ditëlindjeje. Por më e rëndësishme se momenti tërheqës është që në Samitin e NATO-s në Bukuresht, aleatët angazhohen të qëndrojnë stoikisht dhe të bëjnë çka nevojitet: të pranojnë papërshtatshmërinë e mosmarrëveshjeve të përkohshme dhe të synojnë një koncept të ri strategjik të NATO-s që qartëson strategjinë politike dhe ushtarake të Aleancës – dhe ia komunikon këtë qartësisht mbarë botës.

Pse? Dhe pse tani?

Debati aktual rreth konceptit të ri strategjik është *déjà vu* për analistët strategjikë: të gjithë argumentet pro dhe kundër, që mund të dëgjoreshin në vitet '90, po përsëriten tani. Pse të hapet Kutia e Pandorës? Pse të humbasë energji diplomatike, e cila mund të harxhohet në çështje operacionale më të rëndësishme? Pse të rrezikohet dështimi duke larë rrobat e pista të NATO-s në publik?

Është interesante që konceptet strategjike të 1990-s e 1991-shit ishin përtëritës dhe të dobishëm në përgatitjen e NATO-s për anëtarë të rinj e misione të reja. Përvoja e kohëve të fundit nuk mbështet një qasje të kujdesshme, por më tepër sugjeron që një shpirt më guximtar i shërben mirë Aleancës.

NATO-ja po përballlet me një test lakmushi (reagent), i cili përcakton nëse organizata është ende një "Aleancë", e bazuar në interesa e vlera të përbashkëta apo thjesht një koalicion i lavdishëm sigurie. Ka katër arsye të ngutshme të nevojës së rikalibrimit strategjik të NATO-s.

Për të qenë e suksesshme, NATO-s i duhet paketë-marrëveshje kompromisesh të vështira, ku çdo shtet anëtar duhet të japë e të marrë.

Së pari, aleatët duhet të gjejnë një konsensus funksionues rreth legjitimitetit të përdorimit të forcës ushtarake në operacionet që s'parashikohen nga neni 5 (p.sh. për qëllime të ndryshme nga ato të vetëmbrojtjes) madje në raste ekstreme, dhe pa një mandat të shprehur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në njëfarë mënyre, kjo ka qenë çështja më e diskutueshme dhe e pazgjidhur e konceptit strategjik të 1999-s, e cila lidhet edhe më shumë me sulmin e SHBA-së në Irak dhe me doktrinën amerikane të luftërave parandaluese.

Nëse NATO-ja aspiron të merret me terrorizmin dhe përhapjen e WDM-së, ritmi dhe legjitimiteti i forcës ushtarake do të jetë një çështje kyç për të cilën aleatët duhet të jenë të një mendjeje me njëri-tjetrin. Por siç e tregon vështrimi mbi disa dokumente kryesore strategjike, kjo s'mund të ndodhë sot. Strategjia e Sigurisë së BE-së e 2003-shit hapet me një

vërejtje optimiste që “Europa nuk ka qenë kurrë kaq e begatë, kaq e sigurtë dhe kaq e lirë”, kurse Strategjia e Sigurisë së SHBA-së e 2006-s fillon me deklarinimin ogurzi që “Amerika është në luftë”. Ko dëshmon potencialin e infektimit të Aleancës me një nivel skizofrenie strategjike që nuk është e shëndetshme dhe e përshtatshme.

Ky refleks struci, me kokën në rërën e shpresës që problemi do të largohet, nuk ka për të ecur më. Duhet një angazhim për ta kthyer NATO-n në një organizatë *politike* të vërtetë funksionuese, të përgatitur për të debatuar sfidat kyçe strategjike që ndesh Aleanca. Fakti që kjo nuk po ndodh sot, shpjegon perceptimet divergjente të kërcënimit çka e bën problematik aksionin e përbashkët të NATO-s. Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC), struktura kyç politike qeverisëse e NATO-s i fokuson tani diskutimet e tij gjerësisht mbi operacionet në zhvillim të Aleancës, duke shpenzuar shumë pak kohë për krizat e mundshme që fshihen pas horizontit. Një koncept i ri strategjik duhet t’i japë fund këtij mosbalancimi, p.sh. duke ndryshuar procedurat për bërjen e axhendës brenda NAC-it.

Së dyti, zgjedhjet duhen bërë në lidhje me të ardhmen e NATO-s si një organizatë mbrojtjeje. Qartësisht, mbrojtja kolektive mbetet shtylla kurrizore e Aleancës. Por çfarë do të thotë kjo në një kohë ku ndërprerjet e energjisë dhe (cyber) terrorizmi janë linja të preferuara sulmi? Klauzola e mbrojtjes kolektive të NATO-s sipas Nenit 5 u mor si duhet për bazë pas 9/11-s, çka do të thotë teorikisht që NATO-ja si e tërë mbetet gati në një gjendje lufte. Fakti që ne thjesht e harrojmë këtë tregon se Aleanca duhet ta rimendojë natyrën e mbrojtjes kolektive, përgjigjet e saj dhe rëndësinë e përshtatjes së pajimeve të saj operacionale për t’i adresuar me më efektivitet sfidat e reja të sigurisë. Operacionet ushtarake të NATO-s sugjerojnë një strategji të re të “mbrojtjes paraprirëse”, ku interesat dhe vlerat e aleatëve mbrohen në nivelin më të lartë (në Hindu Kush - vargmal në Azi, shënim i përkthyer). Por me sigurinë e energjisë në krye të axhendës dhe me marrëdhëniet me Rusinë në pikën e ngrirjes, kuptimi i vërtetë

dhe ndoshta më i ri i Nenit 5 kërkon vëmendje serioze të përbashkët.

Kjo le të kuptohet se NATO-ja duhet të vendosë prioritetet. Hendeku pritshmëri-kapacitete i Aleancës është bërë rrezikshmërisht i madh. Si një organizatë, NATO-ja nuk mund të sjellë në tryezë shumë mjete politike dhe varet nga vullneti i shteteve anëtare për të punuar së bashku dhe për të bashkuar burimet dhe kapacitetet e përbashkëta. Por ashpërsia e vazhdueshme mbi financimin dhe gjenerimin e forcës për operacionet e udhëhequra nga NATO-ja ekspozojnë konsensusin në thermin brenda Aleancës, veçanërisht në rastin e Forcës së Ndhmës Ndërkombëtare të Sigurisë (ISAF). NATO-ja duhet të fillojë të shtrijë këmbët sipas jorganit. Koncepti i ri strategjik duhet të shpjegojë qartë kuptimin e Nenit 5 në shekullin XX dhe bazuar në këtë vlerësim të ri, t'i vendosë kufij qëllimit dhe natyrës së misionëve të udhëhequra nga NATO-ja.

Së treti, NATO-ja duhet t'i çojë marrëdhëniet e saj me partnerët e rinj, shpesh botërorë dhe lojtarët kyç si BE-ja dhe OKB-ja në një nivel të ri. Në Afganistan, ISAF-i përfshin aleatë vendimtarë si Australia, 1.000 ushtarët e të cilës angazhohen në provincën e rrezikshme jugore të Uruzganit. Meqë shumë shtete anëtare të NATO-s ngurojnë të rrezikojnë jetën e të gjymtohen në këto misione të rrezikshme, Aleanca rrezikon të bëhet një “koalicion i vullnetit”, çka do të minonte solidaritetin e brendshëm dhe më tej *raison d'être* të NATO-s. Nëse NATO-ja zgjedh të përparojë me të vërtetë në botë, duhet t'i tërheqë partnerët botërorë më afër organizatës dhe të qartësojë të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas rregullave të reja e transparent të lojës.

Nuk ka kohë perfekte për një riorganizim ekstrem strategjik të Aleancës. Kështu, edhe sot është një kohë e përshtatshme.

Kjo vlen dhe për lidhjet e NATO-s me BE-në dhe OKB-në. Aleanca krenohet me “qasjen e saj gjithëpërfshirëse” drejt operacioneve. Megjithatë, në realitet, kjo mund të realizohet vetëm duke u përdorur burimet e organizatave kyçe ndërkombëtare (ON) si BE-ja, OKB-ja dhe Banka Botërore.

Kjo është arsyeja pse ON-të u ftuan për herë të parë për të diskutuar rindërtimin e Afganistanit gjatë takimit informal të NATO-s të ministrave të mbrojtjes në Noordwijk, në tetor 2007. Meqë 21 shtete të BE-se janë gjithashtu anëtarë të NATO-s, dukshëm kërkohet më shumë koordinim dhe veprim i përbashkët mes organizatave.

Marrëveshja Berlin-Plus parashikoi përdorimin nga BE-ja të burimeve të NATO-s. Tani është koha për një të ashtuquajtur Berlin-Plus të anasjelltë meqë Aleanca mund të dojë të përdorë mjetet e BE-së si Forcat e Xhandarmërisë Europiane si dhe kapacitetet e menaxhimit të krizave civile të BE-së. Meqë Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse të OKB-së ka tashmë 90.000 trupa të shpërndarë nën autoritetin e tij (bazuar në një buxhet vjetor prej 5 bilion \$), lidhjet NATO-OKB natyrisht duhet të forcohen dhe formalizohen. Modalitete të shumta janë diskutuar në mënyrë informale, por zgjedhjet duhen bërë urgjentisht.

Së katërti, përballja me zgjedhjet strategjike dhe dilemat e NATO-s do të ketë direkt një efekt pastrues brenda Aleancës.

Ata që tremben se rruga drejt një koncepti të ri strategjik do të mbushet me konflikt dhe akuza reciproke kanë pjesërisht të drejtë. Problemi kryesor me NATO-n është që ruajtja e statukuosë është më e rrezikshme se reforma - çrregullimi është shenja më e qartë e dështimit. Sot, disa lojtarë kyç të NATO-s shqetësohen rreth bashkimit të perspektivave të tyre të ndryshme në një koncept të ri strategjik. Disa duan që NATO-ja të jetë realisht globale; të tjerë tremben se kjo mund t'i tërheqë nga ndërtimi i një qasjeje të fortë europiane.

Pa dyshim do të jetë e vështirë, por NATO-ja i ka borxh vetes një tentativë serioze. Megjithëse çmimi kryesor duhet të jetë një koncept strategjik rinovues dhe aktiv, për NATO-n procesi i gjenerimit të konsensusit mund të jetë i vlefshëm sa dhe vetë rezultati përfundimtar. Ndoshta Aleanca duhet të marrë kurajë dhe të bazohet në përvojën e BE-së, krizat e fundit kushtetuese të së cilës kanë pasur një efekt më tepër pastrues në procesin e integritetit evropian, sesa bllokues.

Madonën apo vdekjen?

Cilesia e përshtatjes ndaj detyrave të reja krahas qëndrimit besnik ndaj principeve të veta është diçka që analistët e biznesit e cilësojnë si kthesa e Madonës. Kësaj kthese iu dha emri i divës legjendare të popit, e cila rinovonte veten sa herë që stili dhe shkëlqimi i saj shkonin drejt një rënie të paevitueshme, por guximi i të cilës e ngriti atë në nivelet më të larta të përshtatshmërisë dhe famës.

NATO-ja duhet të ndjekë kthesën e Madonës dhe të mos presë deri sa kundërshtitë e saj të shkallëzohen në grindje publike. Argumenti që kallajisja e anëve do të funksionojë meqë sfidat mund të trajtohen një nga një, thjesht nuk qëndron. Për të qenë e sukseshme, NATO-s i duhet një paketë-marrëveshje kompromisesh të vështira ku çdo shtet anëtar duhet të japë e të marrë. Kjo kërkon një përpjekje reformuese gjithëpërfshirëse të cilën e ofron vetëm një koncept i ri strategjik.

Nuk ka kohë perfekte për një riorganizim ekstrem strategjik të Aleancës. Kështu, edhe sot është një kohë e përshtatshme.

Duhet mbajtur parasysh që koncepti aktual strategjik është i 1999-s kur NATO-ja po bënte luftën e parë në historinë e saj. Kjo duhet t'i japë Aleancës besimin e duhur çka mund të arrihet edhe këtë herë, veçanërisht meqë alternativa e vetme ndaj kthesës së Madonës duket të jetë një rënie e vazhdueshme në përshtatshmëri e vlerë.

Që të mos harrojmë, pjesa tjetër e botës vëzhgon me kujdes veprimet e NATO-s dhe dëshiron dukshëm një Aleancë të ngujuar nga çorientimi dhe ngurtësia. Një koncept i ri dhe rinovues strategjik do t'u provonte gabimet kritikëve të NATO-s dhe do të siguronte një forcë afatgjate të Aleancës.

Dr. Peter van Ham është drejtor i kërkimit mbi qeverisjen botërore në Institutin holandez të Marrëdhënieve Ndërkombëtare "Clingendael" në Hagë dhe profesor në Kolegjin e Europës në Bryzh, Belgjikë.

Keith Krause

DREJT NJË AXHENDE PRAKTIKE TË SIGURISË NJERËZORE

Dokument Politikash - 26 (DCAF)¹

Koncepti i *sigurisë njerëzore*, i cili sot po përdoret gjerësisht nga një numër i madh qeveritarësh, organizatash ndërkombëtare dhe organizatash joqeveritare (OJQ), është vetëm i fundit në një seri përpjekjesh të gjata për të zgjeruar konceptet tradicionale të sigurisë. Këto përfshijnë ide të tilla, si siguria botërore, siguria shoqërore, siguria e përbashkët, siguria gjithëpërfshirëse dhe siguria bashkëpunuese. Përveç qenies si përpjekja më e fundit për të riformuluar ose përkufizuar konceptin e sigurisë, trajtimi i sigurisë njerëzore është i rëndësishëm për dy arsye. Së pari, sepse ndryshe nga riformulime të tjera të mëparshme, ai qëndron në tension, ose potencialisht në konflikt, me konceptet centrike të shtetit për sigurinë, që kanë dominuar mendimet tona. Së dyti, është i rëndësishëm, sepse politikëbërësit e kanë adoptuar diskutimin për sigurinë njerëzore dhe e kanë përdorur atë për të gjeneruar iniciativa të rëndësishme dhe interesante të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Por një kuptueshmëri e plotë e ndërlikimeve konceptuale dhe praktike të sigurisë njerëzore - gjë e cila gjithashtu ndihmon për të shpjeguar dobishmërinë e tij dhe tërheqjen ndaj tij - duhet të zhveshë marrëdhënien komplekse ndërmjet sigurisë njerëzore dhe shtetërore, dhe veçanërisht të drejtat dhe detyrimet e shteteve gjatë përbaljes me nevojat për siguri të qytetarëve të tyre.

¹ Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) është një fondacion ndërkombëtar, misioni i të cilit është të asistojë komunitetin ndërkombëtar në ushtrimin e qeverisjes së mirë dhe reformave në sektorin e sigurisë. Dokumentet e tij të politikave ofrojnë një pikëpamje praktike politike-orientuese të çështjeve të Qeverisjes së Sektorit të Sigurisë.

Ky dokument eksploron pjesët e forta dhe disa dobësi të konceptit të sigurisë njerëzore, si dhe marrëdhënien e gërshetuar midis sigurisë njerëzore dhe asaj shtetërore. Ky dokument fillon me një diskutim të shkurtër mbi gjenezën bashkëkohore dhe zhvillimin e këtij koncepti, si dhe dy vizionet e ndryshme të sigurisë njerëzore që janë në qarkullim. Ai diskuton për një koncept “të ngushtë”, që fokusohet mbi sigurinë nga kërcënimet e dhunës si bazë e sigurisë njerëzore, dhe tregon se si ky vizion mund të lidhet me disa zhvillime qendrore në emergjencën dhe konsolidimin të shtetit perëndimor (Westphalian). Ky seksion i kushton vëmendje fondacioneve politike të diskutimeve për sigurinë njerëzore dhe tregon se si ato janë të lidhura në zhvillimin e shtetit modern, me ndarjen e ngadaltë të funksioneve të sigurisë së brendshme dhe të jashtme të shtetit, dhe me varësinë e forcave të armatosura nga autoritetet civile. Pjesa e tretë e dokumentit ekzaminon ndërlikimet bashkëkohore të kësaj, duke nënvizuar një numër iniciativash politike specifike që e kanë zanafillën nga rrethanat e favorshme të sigurisë njerëzore, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me minat tokësore dhe “mbrojtjen e axhendës civile”, armëve të lehta dhe reformës në sektorin e sigurisë, si dhe përgjegjësisë për të mbrojtur. Ai tregon, të paktën në mënyrë eksperimentale, se si axhenda e sigurisë njerëzore po zhvillohet për të marrë përsipër implikime më të gjera për marrëdhënien midis shtetit dhe qytetarëve të tij, që përfshihen brenda vizionit të sigurisë njerëzore, si “liri nga frika”.

Mbi të gjitha, ky dokument tregon se përdorimi i konceptit të *sigurisë njerëzore* nga shtetet dhe vendimmarrësit nuk është një çështje e parëndësishme slogani apo etiketimi, po ashtu edhe promovimi i sigurisë njerëzore nuk është thjesht një lojë konceptuale ose teorike sallonesh. Diskutimi dhe praktika e sigurisë njerëzore i drejton shtetet dhe politikëbërësit që të fokusohen në çështje të ndryshme, për të bërë pyetje të ndryshme, dhe për të promovuar politika të ndryshme, politika që janë duke pasur një ndikim të rëndësishëm në axhendën e sigurisë ndërkombëtare për shekullin XX.

1. Origjina dhe përhapja e konceptit të Sigurisë Njerëzore

Gjëja më e habitshme për konceptin e sigurisë njerëzore është se ka lindur në botën e politikës dhe nuk ka ardhur as nga akademikët as nga analistët. Është përdorur fillimisht në një mënyrë të rëndësishme në Programe Zhvilluese të Kombeve të Bashkuara 1994 (UNDP) *Raporti i Zhvillimit Njerëzor*, megjithëse kundërshtohet se rrënjët e tij janë më të thella. Siç ka vënë re Fen Hampson, “që nga krijimi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) në shekullin e nëntëmbëdhjetë, është pranuar gjerësisht nocioni se njerëzit duhet të mbrohen nga kërcënimet e dhunshme dhe, kur ata dëmtohen ose plagosen, atëherë komuniteti ndërkombëtar ka një detyrim t’i ndihmojë”. Së fundmi, dikush mund të debatojë se koncepti i sigurisë njerëzore në vetvete, të paktën në formulimin e tij më të fokusuar, nisi me punën e ICRC-së dhe komunitetit humanitar.

Në kontrast, vizioni i UNDP-së mbi sigurinë njerëzore ishte shumë i gjerë: ai mbulonte shtatë dimensione të ndryshme, duke përfshirë sigurinë ekonomike, ushqimore, shëndetësore, të mjedisit, personale, komunitare dhe politike. Qëllimi i përgjithshëm ishte të zgjeronte konceptin e sigurisë, i cili “për shumë kohë u interpretua ngushtësisht si siguri territoriale nga agresioni i jashtëm, ose si mbrojtje e interesave kombëtare në politikën e jashtme ose si siguri globale nga kërcënimi për holokaust nuklear”. Siguria njerëzore ishte pra e destinuar për të ndryshuar objektin referues “nga një tension i veçantë për sigurinë territoriale në një tension më të madh, atë të sigurisë njerëzore” dhe deri diku më problematike, për të përkrahur “sigurinë nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor”. Ky konceptim shkoi paralelisht me punën e Komisionit mbi Qeverisjen Globale, i cili në raportin e tij në 1995, përkrahu dhe zgjeroi konceptin e sigurisë njerëzore, që përfshinte: “Sigurinë nga kërcënimet kronike, si uria, sëmundjet dhe represioni si dhe, gjithashtu, mbrojtja nga përçarja e papritur dhe e dëmshme në modelet e jetës së përditshme. Komisioni beson se siguria e njerëzve duhet të

konsiderohet si një qëllim po aq i rëndësishëm sa edhe siguria e shteteve”.

Ideja, sipas raportit të UNDP-së, ishte praktike dhe politike. Politikisht, UNDP-ja argumentoi se *siguria njerëzore* (në dimensionin e saj politik) nënkuptonte që “njerëzit duhet të jetojnë në një shoqëri që respekton të drejtat themelore të njeriut”. Ajo vërejti, gjithashtu, se qeveritë ushtarake, vendet që po përjetonin shqetësime politike dhe vendet në të cilat kishte nivele të larta të shpenzimeve ushtarake nuk kishin gjasa të ishin politikisht të sigurta, meqenëse “qeveritë ndonjëherë përdorin ushtritë për të shtypur vetë njerëzit e tyre”. Në terma praktike, shpresohet se një vënie e theksit mbi sigurinë njerëzore do të bënte të mundur të arrihej i ashtuquajtur i “dividend i paqes” dhe të arrihej të sigurohej që burimet që i kushtoheshin ushtrisë gjatë Luftës së Ftohtë të drejtoheshin drejt një rezultati final më produktiv. Synimi i drejtpërdrejtë i Raportit të Zhvillimit Njerëzor të 1994-ës ishte të ndikonte mbi rezultatin e Samitit Shoqëror të Kopenhagenit 1995, pra që në fillim koncepti i *sigurisë njerëzore* ishte praktik e me qëllime të qarta strategjike.

Nga mesi i viteve '90 deri sot, koncepti i *sigurisë njerëzore* është përdorur nga një grup i madh organizatash joqeveritare, shtetesh dhe institucionesh ndërkombëtare. Nga ana e OJQ-ve janë përfshirë Oxfam, Këshilli Akademik i Sistemit të OKB-së, Universiteti i OKB-së, Fondacioni Arias, Qendra e Informacionit të Mbrojtjes, Instituti Worldwatch, Komisioni për Qeverisjen Globale, Komisioni Carnegie për Parandalimin e Konfliktëve Vdekjeprurës, Rrjeti Ndërkombëtar i Aksionit për Armët e Lehta, Pax Christi, Programi i Universitetit të Harvardit për Kërkimet mbi Politikën Humanitare dhe Konfliktet, Qendra e Sigurisë Njerëzore në Universitetin e British Columbia, Saferworld, Qendra Ndërkombëtare e Bonit për Shkëmbimin, Qendra për Dialog Humanitar (Gjenevë), Qendra Rajonale e Sigurisë Njerëzore (Amman), Konsorciumi kanadez mbi Sigurinë Njerëzore e kështu me radhë. Ai është bërë, gjithashtu, një themel i politikës për shtetet si Kanadaja, Norvegjia, Japonia dhe Zvicra dhe është formalizuar në një ambient shumëpalësh brenda Rrjetit të

Sigurisë Njerëzore, një grupim joformal prej 14 shtetesh që është takohet çdo vit që prej 1999 në nivel ministrash të jashtëm, dhe që kanë rënë dakord të vazhdojnë një axhendë të përbashkët të sigurisë njerëzore për një sërë çështjesh.

Brenda sistemit të OKB-së, shprehja *siguri njerëzore* është bërë një tipar i rregullt i diskutimeve shumëpalëshe dhe të OKB-së, duke u përdorur nga zyrtarët, si Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatët, ose Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Ky proces arriti majën me Dokumentin Përfundimtar të Samitit Botëror 2005, ku koncepti i sigurisë njerëzore mori një “nëntitull” dhe u trajtua në paragrafin 143:

Siguria Njerëzore

143. Ne theksojmë të drejtën e njerëzve për të jetuar në liri dhe dinjitet, të lirë nga varfëria dhe dëshpërimi. Ne pranojmë që të gjithë individët, veçanërisht njerëzit e pafuqishëm kanë të drejta të patjetërsueshme për t’u çliruar nga frika dhe nga nevojat materiale, me mundësi të barabarta për të gëzuar gjithë të drejtat e tyre dhe për të zhvilluar plotësisht potencialet e tyre njerëzore. Së fundmi, ne marrim përsipër që të diskutojmë dhe të përcaktojmë nocionin e sigurisë njerëzore në Asamblenë e Përgjithshme.

Sigurisht, këto shtete, OJQ-të dhe institucionet u joshën nga ideja, pasi *siguria njerëzore* ishte një slogan i mirë. Por sigurisht ishte dhe më shumë se kaq. *Siguria njerëzore* ishte një mënyrë për të përshkruar ose inkuadruar çfarë ata ishin duke bërë, gjë e cila lejoi një numër iniciativash të dëshpëruara politike për të qenë të lidhura dhe për t’iu dhënë një koherencë më e madhe. Me fjalë të tjera, *siguria njerëzore* po ndihmonte për të nxitur një inkuadrim më të gjerë të asaj se si dijetarët dhe praktikuesit i mendonin marrëdhëniet e ndryshme midis sigurisë, zhvillimit dhe të drejtave të njeriut në politikën botërore. Veçanërisht, duke ndryshuar objektin referues të sigurisë nga ai i shtetit tek ai i individit, u arrit të nënvizoheshin tensionet që ekzistojnë midis promovimit të sigurisë shtetërore dhe promovimit të sigurisë së individëve, e cila ka qenë historikisht shpesh e rrezikuar nga shteti.

2. Dy vizione të Sigurisë Njerëzore

Ka pasur, gjithsesi, dy vizione konkurruese të sigurisë njerëzore që dolën nga kontributet e ndryshme të debatit dhe që janë reflektuar me afërsi në dy qasjet e ndryshme politike. Vizioni i parë, i gjerë u mbështet mbi formulimin origjinal të UNDP-së, dhe mund të përkufizohet si “liri nga dëshira”-siguria njerëzore ishte për sigurimin e nevojave bazë njerëzore për sa i përket fushës ekonomike, shëndetësore, ushqimore, shoqërore dhe mjedisore. Kjo u pasqyrua në raportin e 2003-shtit të Komisionit të Sigurisë Njerëzore, si dhe në aktivitetet e financuara nga Trusti i Fondit për Sigurinë Njerëzore. Raporti i Komisionit u fokusua jo vetëm në situatat e konfliktit, por edhe në çështje të lidhura me tregtinë e rregullt, aksesin në kujdesin shëndetësor, të drejtën e patentës, aksesin në edukim dhe liritë thelbësore, ndërkohë që Trusti i Fondit për Sigurinë Njerëzore ka sponsorizuar projekte në fushat e ndryshme, si sigurimi ushqimor për fermerët në Timorin Lindor, ose peshkatarët në Sudanin Jugor, sigurimi shëndetësor në Tashkistan ose Mongoli, ose rindërtimi i shkollave në Kosovë. Një tjetër vizion, më ngushtësisht i përqendruar, ishte më i lidhur me aktivitetet e Rrjetit të Sigurisë Njerëzore dhe slogani i tij kyç ishte “liri nga frika” - siguria njerëzore ishte duke zhvendosur përdorimin ose kërcënimin nga forca ose dhuna në jetën e përditshme të njerëzve. Shembuj të iniciativave politike përfshinin gjëra të tilla si fushata për të ndaluar minat tokësore antinjeri, aksione ndërkombëtare për t’u përballur me shtimin dhe shpërdorimin e armëve të lehta, promovimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, si dhe fushën e gjerë të qeverisjes së sektorit të sigurisë. Disa nga iniciativat politike do të diskutohen më poshtë.

Megjithëse është e mundur që të ndiqen të dyja axhendat njëherësh, “liri nga frika” dhe “liri nga dëshira” (siç i nënkupton edhe Dokumenti Final i Samitit Botëror), autori debaton se kjo pikëpamje e ngushtë e sigurisë njerëzore si “liri nga frika” është intelektualisht dhe programatikisht më koherente, për të paktën dy arsye. Arsyeja e parë është negative: vizioni i gjerë i sigurisë njerëzore si “liri nga dëshira” është në fund të fundit

asgjë më shumë se një listë blerjeje; ai përfshin etiketimin e një sërë çështjesh jo domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën, si kërcënime për sigurinë njerëzore dhe si rezultat i kësaj, në një pikë të caktuar siguria njerëzore duket se pushton pothuajse gjithçka që mund të konsiderohet si një kërcënim i mirëqenies. Kjo bie në kurthin që Daniel H. Deudney përshkruan mjaft qartë: “Nëse gjithçka që shkakton një reduktim të mirëqenies njerëzore etiketohet si një kërcënim i sigurisë, termi humbet çdo vlerë dhe bëhet një sinonim i “të keqes”. Në këtë pikë, koncepti nuk ka më ndonjë dobi për politikëbërësit as aksidentalisht për analistët - meqenëse kjo nuk lehtëson përcaktimin e prioritetëve ose koherencën politike dhe errëson përkufizimet e qarta të konceptit të “sigurisë”, i cili është pazgjydhmërisht i lidhur me kërcënimet e sigurisë, konfliktet dhe përdorimin aktual apo potencial të forcës.

Ndoshta në mënyrë më të rëndësishme, nuk është e qartë që diçka fitohet duke vendosur etiketën *siguria njerëzore* për çështje të tilla, si e drejta për arsim, e drejta e sipërmarrjes dhe biznesit, ose sfidat e shëndetit publik. Dijetarët, si Ole Wæver, e kanë përshkruar këtë proces si “sigurizim”, si “lëvizja që e drejton politikën përtej rregullave të zakonshme të lojës” dhe si një proces që përfshin aktorët politikë, që deklarojnë se çështje specifike përlligjin një vëmendje të veçantë, përpjekje ose dhe sakrifica. Shembujt si “lufta kundër drogës” ose “lufta globale kundër terrorit” janë ilustrime të mira të këtij procesi. Por, a e ndryshon përshkrimi i alfabetizimit, si një kërcënim për sigurinë njerëzore, mendimin tonë për të drejtën e edukimit - a e lehtëson kryerjen e një veprimi më të efektshëm, a na ndihmon në zgjidhjen e problemeve? Apo faktikisht na drejton në disa raste në rrugë të gabuar, në trajtimin e problemeve të caktuara, të tilla si migracioni, përdorimi i drogave ilegale, ose HIV/AIDS, si kërcënime të sigurisë njerëzore, kur ato thjesht mund të konsideroheshin si sfida të thjeshta të politikës publike? Të paktën dy shembuj ilustronjë qartësisht tensionet e përfshira në çështjet e sigurimit: pandemia HIV/AIDS, si dhe *sigurizimi* e migracionit.

Në lidhje me HIV/AIDS, një mbledhje e nivelit të lartë të Këshillit të Sigurisë së OKB-së në janar 2000 (e drejtuar nga

zëvendës presidenti i atëhershëm i SHBA-së Al Gore) ekzaminoi impaktin e HIV/AIDS mbi paqen dhe sigurinë në Afrikë dhe deklaroi në korrik 2000 se “pandemia HIV/AIDS, nëse nuk kontrollohet, mund të përbëjë një rrezik për stabilitetin dhe sigurinë”. Por çfarë do të thotë kjo në praktikë? A ndikon mbizotërimi dhe përhapja e HIV/AIDS në “uljen e sigurisë duke minuar kushtet sociale dhe ekonomike, gjë e cila rrjedhimisht rrit paqëndrueshmërinë, krimin, dhunën në familje, protestat dhe luftën civile dhe ndërkombëtare”, apo janë këto thjesht marrëdhënie të mirëqena që nuk kanë një bazë empirike? Çka është më e rëndësishme, a janë përgjigjet tradicionale ndaj kërcënimeve të sigurisë (përrjashtuese, të militarizuara, dhe të lidhura me “masat e emergjencës”) të përshtatshme për sfidat e shëndetit publik?

Literatura për “sigurizimin” e migracionit ilustron një tjetër dimension të këtij tensioni. Parë nga një perspektivë e sigurisë, shtetet e Europës Perëndimore (dhe disa elemente nga elitat e politikave europiane) kanë reaguar shpesh ndaj migracionit sikur ai të përbënte një kërcënim ndaj identitetit dhe vlerave shoqërore. Gjithsesi, nga një perspektivë ekonomike, konsensusi është që Europa duhet të inkurajojë migrimin në mënyrë që të mbështesë të drejtat e mirëqenies (duke përfshirë pensionet), përballë një fuqie punëtore dhe popullate në mplakje. Debati shpesh është polarizuar dhe sigurizimi (securitisation) migracionit nuk ka ndihmuar apo konsoliduar zhvillimin e politikave publike për migruesit, duke ilustruar qartë disa nga pasojat negative të përdorimit të konceptit të fuqishëm të sigurimit në një mënyrë të çlirët, ndoshta dhe politikisht të pakujdesshme.

Duke u zhvendosur në një grup argumentesh, nëse koncepti i sigurisë njerëzore është i fokusuar në “liri nga frika” - nga kërcënimimi ose përdorimi i dhunës - ai mund të lidhet me një axhendë të fuqishme, praktike dhe intelektuale që është ngulitur në një arsytim të veçantë të shtetit perëndimor dhe marrëdhënieve shtet-shoqëri. Çështja e kontrollit të institucioneve të dhunës së organizuar dhe e largimit të forcës nga jeta politike, ekonomike dhe shoqërore, ka qenë një gjë kryesore për të gjithë botëkuptimin modern të politikës dhe

luftës për të vendosur institucione politike legjitime dhe përfaqësuese. Është një pjesë e vizionit të Thomas Hobbes' për politikën vigane - një institucion i krijuar për të na çuar në situata të tilla si "luftë e secilit kundër të gjithëve" në një shtet civil, në të cilin mund të lulëzonte një jetë ekonomike sociale dhe politike. Kjo është pasqyruar në përkufizimin e Max Weber për shtetin si një organizatë që ka monopolin ligjor mbi mjetet e legjitimuara të dhunës. Dhe është e lidhur me luftën e gjatë shekullore për të eliminuar kërcënimin e forcës dhe dhunës nga bashkëveprimet e përditshme të njerëzve. Nga kjo perspektivë, siguria njerëzore fokusohet në përgjegjësinë primare të institucioneve politike për të mbajtur rregullin shoqëror që është një parakusht për sigurinë dhe mirëqenien e individëve dhe komuniteteve.

Ky vizion i sigurisë njerëzore, i vendosur në një kontekst historik (dhe filozofik) më të gjerë, prek dy çështje që janë qendrore për traditën liberale (dhe për kandidatët e saj): të drejtat dhe detyrat reciproke që individët kanë ndaj njëri-tjetrit, si dhe natyra dhe qëllimi i institucioneve sovrane të paracaktuara për t'i ruajtur këto të drejta dhe detyra. Pra shkurt, siguria njerëzore është e pashmangshme dhe e koklavitur për shtetin dhe më specifikisht për marrëdhëniet midis qytetarëve, dhe midis tyre dhe shtetit. Fakti që kjo pikë është lënë jashtë, është pasojë e dëshirës së shumë njerëzve në debatin e sigurisë njerëzore për të shkuar "përtej" koncepteve centrike të shtetit për sigurinë, por duket se nuk ka shpëtim nga shteti si një institucion qendror i jetës politike. Siç është nxjerr në pah "siguria njerëzore përforcon sigurinë e shtetit, por nuk e zëvendëson atë": një shtet që mbron qytetarët e tij dhe respekton të drejtat e tyre është padyshim ai që gëzon legjitimitet dhe mbështetje. Nëse e shohim sigurinë njerëzore në këtë mënyrë - si çështja për natyrën e marrëdhënies midis qytetarëve e shteteve të tyre dhe si një lupë për të marrë në pyetje pushtetin dhe përgjegjësinë e institucioneve dhe shtetit - atëherë ne mbetemi mjaft afër kuptimit të ngushtë të sigurisë njerëzore si "liri nga frika". Ky mbështetet mbi idenë që siguria - politika dhe debati politik, siç e njohim ne - nuk mund të lulëzojnë pa evakuuar fillimisht kërcënimin e forcës dhe

dhunës nga hapësira publike. Kjo është, në mënyrë të diskutueshme, e vërtetë për të gjitha bashkëveprimet politike, sociale dhe ekonomike, që kur kërcënimi i forcës dhe dhunës është i gjithëpranishëm, shoqëria nuk mund të lulëzojë, politika s'mund të jetë demokratike dhe përfaqësuese dhe tregjet s'mund të funksionojnë².

3. The Provision e Sigurisë dhe e Rendit Publik

Dy zhvillime politike - ndarja e brendshme dhe e jashtme e funksioneve të sigurisë së shtetit, dhe varësia e forcave të armatosura nga autoriteti civil - mund të ilustrojnë mënyrën në të cilën koncepti i "lirisë nga frika" u bë absolutisht i ngulitur në kuptimin tonë për shtetin Westphalian ose liberal dhe pse siguria njerëzore rezonon aq fuqishëm në skenën ndërkombëtare.

Në lidhje me të parën, ndarja e funksioneve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së shtetit, si dhe ideja që shteti më shumë garanton siguri dhe është përgjegjës për garantimin e rendit publik nëpërmjet policimit, sesa përfaqëson një burim pasigurie (dhe dhune) për popullin, ishte relativisht e ngadaltë për të hedhur rrënjë në Europën Perëndimore. Me kalimin e kohës, ofrimi i sigurisë qytetarëve dhe komuniteteve u bë një pjesë qendrore e marrëveshjes që siguronte legjitimitet për shtetin e ri dhe justifikonte orientimin e jashtëm të vetë politikave dhe praktikave të tij të sigurisë. Në shekullin XIX, fshatarët francezë kërkonin që t'u ofrohej kjo gjë nga punonjësit e policisë e të taksave sesa të mbroheshin nga institucionet shtetërore. Sidoqoftë, procesi i ndërtimit të shtetit dhe legjitimiteti, së fundi transformuan konceptin e vërtetë të marrëdhënies midis individit dhe shtetit, deri në pikën që ne thjesht prezumojmë që një funksion i shtetit është të garantojë siguri për qytetarët e tij.

² Një element i tretë, që nuk është trajtuar në këtë dokument, do të ishte lufta për të vendosur shtetin e së drejtës - an *état de droit* - në të cilin të gjithë aktorët politikë, socialë dhe ekonomikë janë subjekte të të njëjtit sistem drejtësie dhe të së njëjtës makineri administrative, burokratike dhe politike.

Dy zhvillime ishin të rëndësishme për këtë: monopolizimi (praktik) në rritje i dhunës nga shteti dhe varësia e tij nga kontrolli civil dhe shtimi i mbështetjes për rendin publik. Dhuna fizike personale, ose e përdorur nga një individ ndaj tjetrit ose nga një grup ose klasë ndaj një tjetre, thjesht u bë e paligjshme. Në teori, sigurisht, monopoli i dhunës ishte një gur themeli i shtetit modern. Siç ka përmendur Jean Bodin, “shpallja e luftës apo vendosja e paqes është një nga pikat më të rëndësishme të madhështisë [sovranitetit], meqenëse ajo shpesh detyron shkatërrimin apo ruajtjen e shtetit”. Ky mendim është marrë nga mbretërit: siç shprehet dhe në një urdhëresë të mbretërisë franceze të shek. XVI: Mbreti shprehimisht ndalon gjithë subjektet e tij... të ndërmarrin ose të kenë ndërmarrë një rekrutim ose mbledhje të ushtarëve... me ndonjë pretekst pa një urdhër të qartë të mbretërisë”. Në praktikë, mbajtja dhe përdorimi i forcave ushtarake private nga lordët feudalë u ndalua gradualisht. Në kohën që urdhëresa e cituar më lart u shpall, Franca po shkatërrohej nga një luftë civile. Deri në Revolucionin Francez, nuk ishte e pazakontë që fisnikët rivalë të ngrinin dhe përdornin forca private ushtarake. Në rajone (si Sicilia dhe Korsika), ku klanet dhe lidhjet familjare ishin po aq të rëndësishme sa dhe marrëdhëniet hierarkike të klasave, u desh deri diku (deri në shekullin XIX në disa raste) që autoritetet qendrore të kontrollojnë dhunën e organizuar dhe të ritualizuar (vrasjet për hakmarrje për shembull) që ishin pjesë dhe paketë e kodeve të drejtësisë esencialisht fshatareske. Ushtrimi i dhunës së *legjitimuar* u bë mbrojtja e vetme e shtetit, edhe pse kishte shkelje të rëndësishme dhe të përhapura të këtij principi.

Transformimi më i rëndësishëm, gjithsesi, ndodhi në mbështetjen dhe sigurimin e rendit publik, një gur themeli në ligjshmërinë e shtetit modern. Para se të diskutojmë për ngutjen e institucioneve për garantimin e rendit publik (policia, xhandarët, rojet kombëtarë e kështu me radhë), ia vlen të përmendim se policimi duhet të konsiderohet si një element kyç i çdo konceptimi të sigurisë njerëzore, për të paktën dy arsye. Së pari, policia përfaqëson institucionin e sigurisë që shumica e njerëzve ndodh të përballen drejtpërsëdrejti gjatë

jetës së tyre. Së dyti, ofrimi i sigurisë së individëve dhe komuniteteve ishte pjesa qendrore e marrëveshjes që i jepte ligjshmëri shtetit modern, dhe justifikonte orientimin e paligjshëm të politikave dhe praktikave të saj të sigurisë.

Një studim i policimit ka qenë tradicionalisht i përjashtuar nga trajtimet e sigurisë, për arsye që janë të qarta dhe të dukshme. Policimi bashkëkohor është fokusuar tradicionalisht në sigurinë e brendshme, dhe në një shtet liberal demokratik është ngritur një dallim i qartë midis institucioneve, praktikave dhe qeverisjes së ligjit në rendin e brendshëm dhe ndërkombëtar. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, Akti për Grupet e Armatosura 1878 ndalonte përdorimin e Ushtrisë së SHBA-së për forcimin e ligjit civil, duke ilustruar kështu me shembull principin e ndarjes së autoritetit civil dhe ushtarak. Por në vend të pranimit të dallimit midis sigurisë së brendshme dhe ndërkombëtare si aksiomatike, është më e qartë të ekzaminosh evolucionin të institucioneve publike të sigurisë në mënyrë që të kuptohet se si është shfaqur kjo ndarje natyrale në dukje dhe se si ajo përforcon një nocion të veçantë të rolit të institucioneve të shtetit në garantimin e sigurisë njerëzore.

Trajektorja e duhur e ndërmarrë në zhvillimin e policimit modern ka variuar gjerësisht në kohë dhe vende, dhe nuk ka një model uniform. Në Francë, për shembull, një strukturë policimi permanente e centralizuar ishte në vend nga fundi i shekullit XVII, megjithëse duhet pranuar se në 1714 kishte ndoshta vetëm 1.000 veta që policonin në gjithë Francën rurale. Si kontrast, policia britanike u krijua vetëm ndërmjet 1829 dhe 1888, dhe edhe pse u rrit në mënyrë të shpejtë - rreth 1855 ka pasur 15.000 policë në Angli dhe Uells, mbeti e decentralizuar. Në Itali, një xhandarmëri formale u fut nga Napoleoni, duke zëvendësuar institucionin autokton të *sbirri*, “banditë të armatosur që përforconin disa funksione policimi [të lidhura me zhvatjen] në shumicën e shteteve italiane të shekullit XVII e XVIII”.

Pavarësisht nga prirja e zakonshme (veçanërisht në shek. XX) drejt një ndarje të ndryshme midis forcave ushtarake dhe policore, në shumë vende nuk kishte në fillim një dallim të

qartë midis mjeteve që përdornin shtetet për të garantuar siguri të jashtme ose të brendshme. Në Francë, për shembull, xhandarmëria është modeluar si ushtri me disiplinë ushtarake, pajisje dhe organizim. Siç tregon Clive Emsley, “xhandarët ishin ushtarë/policë profesionistë në kohën që ushtritë e Europës kontinentale po transformoheshin nga mercenarë profesionalë në një bazë rekrutimi”. Ata, gjithashtu, përfaqësonin “një manifestim të rëndësishëm të pushtetit shtetëror” dhe ishin një instrument i kapacitetit të zgjeruar burokratik të mbikëqyrjes së shtetit”. Në landet gjermane, policia *hatschiere* dhe hussars (trupa të lehta) shpesh shndërroheshin në ushtarë, që mund të thirreshin për të shërbyer në kohë lufte. Në Angli, në fillim të viteve 1700, kontrolli shtetëror ushtrohej pjesërisht nga ushtria, milicia dhe policia e thjeshtë. Të tre institucionet ishin të dobët dhe të pabesuar: policia ishte e prekshme nga bandat kriminale të organizuara, milicia rekrutohej lokalist, pra ishte “një suport i pasigurt për rendin ligjor” dhe ushtria ishte një organizatë e “shpresës së fundit”, megjithëse “shpresa e fundit” nuk ishte një rezultat i rrallë.

Sigurimi i rendit publik ishte, gjithashtu, një thikë me dy presa, që nxirrte në pah tensionet në marrëdhëniet midis shteteve dhe qytetarëve të tyre. Mjetet që përdorehin për të mbrojtur njerëzit shpesh përdorehin edhe për të mbrojtur regjimin (ose elitat) nga njerëzit, meqenëse shtypja e dhunës nga grupe të tjera të organizuara nuk eliminonte dhunën e paorganizuar në shkallë të gjerë nga shpërthimi periodik, drejtuar kjo kundër shtetit dhe zyrtarëve të tij. Shumë shpesh, këto shpërthime të dhunës janë katalizuar nga ryshfetmarrja ose korrupsioni i zyrtarëve të shtetit, ose nga përdorimi a represioni i urdhrave sociale të orientuara drejt ndasive. Në shumë raste, ushtria u përdor kur mendohej e nevojshme për të shtypur ankthin, pranë institucioneve më pak të fuqishme dhe më shumë tradicionale. Një shembull interesant i Italisë post-napoleoniane ishte xhandarmëria, fillimisht e konsideruar si një institucion i imponuar armiqësor ndaj elitave tradicionale italiane, u bë një vegël e konsolidimit të shtetit, e përdorur për të forcuar besnikërinë ndaj shtetit dhe për të shtypur

dhunën popullore. Shtrirja e ndikimit të shtetit në zonat rurale, si pjesë e formimit të shtetit, u kuptua nga shumica e elitës drejtuese. Në Spanjë, siç ka paraqitur gjenerali i shek. XIX, “shpërndarja e Rojeve Civile, në mbi 1.000 njësi të ndara, bënë një pushtim të plotë ushtarak në të gjithë territorin kombëtar”.

Si shumë të ndryshme që ishin këto zhvillime, çështja kryesore ishte që ato përfshinin një centralizim të strukturave të sigurisë (policimit) brenda shtetit, një zgjerim të pushtetit shtetëror dhe të mbikëqyrjes në një territor të caktuar, dhe një dallim në rritje midis institucioneve të sigurisë së brendshme dhe atyre përgjegjëse për sigurinë e jashtme. Ndërsa konsolidimi i brendshëm i strukturave të policimit nuk përfshiu një centralizim uniform nëpër shtet, ai shfaqti lëvizje të përbashkëta drejt racionalizimit dhe burokratizimit, dhe një largim nga praktikat informale, lokale përkatëse, që dominonin më parë policimin e jetës shoqërore. Diferencat midis institucioneve të sigurisë së brendshme dhe atyre të orientuara në fushën e jashtme vazhduan. David Bayley e ka karakterizuar këtë dallim: “Një ushtri është publikisht e krijuar për të përdorur forcën, ashtu si dhe policia, por juridiksioni i saj është i jashtëm për kolektivin. Një ushtri e përdor forcën për të mbrojtur komunitetin nga kërcënimet e jashtme për ta; forca policore mbron nga kërcënimet e brendshme”.

Por vetëm kur nocioni i komunitetit kombëtar u ngulit më thellë me përhapjen e nacionalizmit modern në shek. XIX, atëherë arritën të përputheshin kufijtë e brendshëm me ato të jashtëm me kufijtë formal ligjor. Dhe vetëm kur u puqën arritjet praktike dhe ligjore të shtetit, u shfaqën qartë dallimet midis institucioneve për garantimin e sigurisë së brendshme dhe të jashtme. Sapo u kalua një prag i caktuar, përdorimi i brendshëm i institucioneve të dhunës së organizuar i krijuar për sigurinë e jashtme - përdorimi i ushtrisë për të shpërndarë grevat - u konsiderua si i justifikueshëm vetëm si në *momentet e vdekjes*. Siguria njerëzore - e kuptuar këtu si liri nga dhuna e përditshme - u sigurua nga institucione që ishin politikisht të kontrolluara, dhe gjerësisht (por jo universalisht) të legjitimuara.

Kështu pra, arritja e këtij aspekti të sigurisë njerëzore në Europë përfshiu një centralizim të strukturave të sigurisë

(policimi) brenda për brenda shtetit, një zgjerim të pushtetit shtetëror dhe të mbikëqyrjes nëpër një territor të caktuar, dhe një dallim në rritje midis institucioneve të sigurisë së brendshme dhe ato të përgjegjshme për sigurinë e jashtme. Ndonëse deklarimi është paksa i madh, autori beson se mund të bëhet një lidhje e qartë midis idesë që institucionet shtetërore ishin llogaridhënëse kundrejt qytetarëve dhe që vetë shteti kishte një përgjegjësi për të siguruar rendin publik dhe sigurinë, me rritjen e legjitimitetit të institucioneve politike dhe përhapjen e rregullave demokratike dhe përfaqësuese.

4. Varësia e Forcave të Armatosura nga Autoriteti Civil

Paralel, dhe e lidhur me këtë, ishte varësia e ngadaltë e instrumenteve të jashtëm të sigurisë - Forcave të Armatosura - nga Autoriteti Civil. Ky proces kalon nëpër shumë etiketa: kontrolli demokratik i forcave të armatosura, marrëdhëniet civil-ushtarake, ose si pjesë përbërëse reformës së sektorit të sigurisë. Pavarësisht nga fraza, lufta për të shfaqur kontrollin demokratik dhe civil mbi institucionet e jashtme të dhunës së organizuar ishte një proces i ngadaltë që u shpalos me shpejtësi të ndryshme në shtete të ndryshme, dhe kishte ndërlikime të rëndësishme se si konceptohej siguria e individëve dhe komunitetit. Në fillim, ushtria shërbente si vegël e princit dhe ushtarët ishin thjesht mercenarë që i shërbenin interesave të ngushta politike ose strategjike të shtetndërtuesve të hershëm.

Siç argumenton Charles Tilly, shtetet e hershme moderne të Europës kanë lindur si makina luftëbërëse, dhe fokusi i tyre për të krijuar fonde për zgjerimin dhe konsolidimin e territorit nënkuptonte se marrëdhëniet e elitave me popullsinë e tyre kufizoheshin në nxjerrjen, taksimin dhe grabitjen - jo dhe shumë cilësisht të ndryshme nga politikat bashkëkohore të luftës të dëshmuara kohët e fundit në vende si Somalia, Liberia, ose Afganistani. Forca të armatosura të tilla grabitqare, sigurisht që nuk promovonin siguri njerëzore.

Marrëdhënia midis qytetarëve dhe ushtrisë filloi të ndryshonte në shek. XVIII, veçanërisht me mobilizimin masiv

që karakterizonte luftërat e Napoleonit. Megjithëse këto ushtri masive ishin si grupe shtegtuese, që shkaktonin shkatërrim kudo që kalonin, krijimi i tyre kishte një pasojë të pamenduar. Rezultati, siç ka treguar Carl von Clausewitz, ishte që shtetet dhe elitarët shtetërorë që dëshironin të mobilizonin masat, duhet të bënin kështu jo vetëm në emër të *raison d'état*, por në emër të kombit - *la patrie*. Kjo lëvizje shënoi hapin e parë në rrugën e gjatë të kontrollit demokratik të forcave të armatosura. Rëndësia e këtij zhvillimi për sigurinë njerëzore në shtetet perëndimore - Westphaliane - nuk mund të nënvlerësohet pa mbikëqyrjen civile, besimi (dhe eksperiencia) ishte se forcat e armatosura, siç do instrument tjetër i dhunës së organizuar, përfaqësonin një rezervuar potent pushteti që mund të përdorej për interesa të ngushta fanatike, për të shtypur ankthin, ose edhe thjesht për të nënshtruar popullsinë. Gjithashtu, dhe jo aksidentalisht, kjo konsumonte një pjesë të madhe të burimeve shtetërore, burime që ishin rritur së tepërmi nga format e taksave, që preknin direkt popullsinë dhe shpesh impononin një barrë të rëndë.

Hapat e ndryshme në vendosjen e kontrollit civil mbi institucionet e dhunës së organizuar nuk janë ndjekur në mënyrë kronologjike, por dy çështje të hershme përfshijnë rishikimin parlamentar të buxhetit ushtarak, që nuk u arrit në shumë vende të Europës së shek. XIX, dhe lufta kundër tradicionalisht të quajturit “militarizëm”. Fokusi mbi militarizmin u shfaq, në një lloj paralajmërimi të “debatit paqësor demokratik”, ndërkohë që demokratizimi i mëtejshëm i jetës politike ngriti shqetësime që një influencë e fortë e institucioneve ushtarake në policinë kombëtare në lidhje me luftën dhe paqen do të çonte në rezultate të dëmshme. Këto rezultate përfshinin një tendencë për të keqësuar arsyetimin rastësor, mbivlerësimin e kërcënimeve potenciale, ekzagjerimin për burimet e nevojitura për të përballur me këto kërcënime, dhe një dëshirë shumë të madhe në drejtim të përdorimit të forcës për të arritur rezultate politike. Të gjitha këto çështje u ngritën në një debat historiko-gjeografik rreth “shina drejt luftës” në verë të 1914-ës, si dhe influencës të së ashtuquajturës model “Prusian” i marrëdhënieve civil-ushtarake.

Lidhja midis militarizmit dhe sigurisë njerëzore është relativisht e thjeshtë për t'u kapur në politikat bashkëkohore dhe formoi një pikë kryesore në formulimin e UNDP-së më 1994, siç u tha dhe më lart. Për sa lufta dhe përgatitjet për luftë mund të minonin rendin publik dhe të pezullonin “rregullat politike të lojës” - ndonjëherë përkohësisht, ndonjëherë për periudha më të gjata - siguria njerëzore u ndikua negativisht.

Sigurisht, nuk kemi pse shkojmë shumë mbrapa në historinë e Europës - duke konsideruar Spanjën nën gjeneralin Franko, ose regjimin kolonial të Greqisë (1967-1974), ose diktaturën e Salazar në Portugali - për të parë se si çështja e marrëdhënieve civil-ushtarake është e lidhur me çështjen e sigurisë njerëzore dhe demokracisë. Në gjysmën e dytë të shek. XX, gjithsesi, debati mori një kthesë më demokratike, kur Ministritë e Luftës u bënë Departamente të Mbrojtjes, kur kontrolli parlamentar u zgjerua përtej çështjeve të buxhetit për të përfshirë mbikëqyrjen e politikës, prokurimeve dhe rekrutimit dhe çështje të tjera të rëndësishme. Edhe vetë biznesi i strategjisë - veçanërisht strategjia nukleare - po shikohej si tepër e rëndësishme për t'iu lënë gjeneralëve. Historikisht, ky është një zhvillim shumë i mrekullueshëm: ideja që njerëzit me një eksperiencë jo direkte për një fenomen të veçantë, lufta në këtë rast, ishin më të mirët për të planifikuar strategji të tilla, si përmbajtja nukleare, që implikonte rrisje të dhunës së niveleve të paimagjinueshme.

Gjithsesi, në lidhje me sigurinë njerëzore, pavarësisht nga rrugë të ndryshme, dimensione dhe kronologji, lëvizja për të rritur mbikëqyrjen civile mbi institucionet e dhunës së organizuar në të gjitha rastet hodhi idenë që rreziku i luftës ose incidenteve të përdorimit të forcës, ose shuma e burimeve financiare të kushtuara forcave të armatosura mund të zvogëlohej nëpërmjet mbikëqyrjes civile dhe kontrollit, si dhe që këto përfitime mund të shtonin sigurinë e njerëzve dhe të komuniteteve.

5. Dinamika midis Sigurisë Njerëzore dhe Shtetërore

Si mund të shkojmë ne nga kjo skicë e shkurtër historike për të kuptuar forcën bashkëkohore dhe rezonancën e konceptit të *sigurisë njerëzore* të fokusuar në “lirinë nga frika” e dhunës së organizuar? Hapi i parë është të zgjidhim një paradoks të dukshëm në politikat e sigurisë: pavarësisht dëshirës për t’i “vënë njerëzit në fillim” ose për të adaptuar qasje të sigurisë të llojit “njerëzit - në qendër”, shumica e masave praktike politike mbi axhendën e sigurisë njerëzore, faktikisht, përfshijnë forcimin e rolit dhe burimeve të shtetit. Programet për të rritur qeverisjen e sektorit të sigurisë, ose për të ulur dhunën e armatosur duke ndaluar shtimin dhe keqpërdorimin e armëve të lehta, ose për të përmirësuar sistemin e drejtësisë kriminale, fokusohen në nivel kombëtar dhe përfshijnë forcimin e institucioneve të shtetit dhe punën me autoritetet shtetërore. Ky paradoks zhduket, gjithsesi, ndërsa ne njohim që qëllimi i sigurisë njerëzore - i kuptuar siç është skicuar më lart - është të përhapë normat që përforcojnë shtetin liberal perëndimor, dhe ku është e nevojshme të riformoj marrëdhëniet midis shteteve dhe qytetarëve të tyre. Në një kuptim, promovimi i sigurisë njerëzore është bërja e shteteve dhe udhëheqësve të tyre të mbajnë anën e tyre të kontratës bazë sociale: shtetet janë krijuar (ndërmjet gjërash të tjera) të promovojnë siguri - në mënyrë që individët të mund të vazhdojnë jetën e tyre në paqe. Shtetet kanë përgjegjësi jo vetëm të sigurojnë mirëqenie, ose përfaqësim, por - së pari dhe përpara - të garantojnë sigurinë e qytetarëve. Kjo është pa diskutim marrëveshja ose kontrata kryesore që e drejtoi njerëzimin jashtë anarkisë së Hobbes. Shkurt, promovimi i versionit të fortë të sigurisë njerëzore tenton për ta bërë ligjshmërinë e perceptuar të shtetit (dhe potencialisht edhe sovranitetin) të kushtëzuar nga mënyra si ata i trajtojnë qytetarët e tyre.

Kjo çon, gjithashtu, në shpjegimin e kundërshtimit të shumë shteteve të jugut për atë çka ata e shohin si logjikë intervencioniste të sigurisë njerëzore; pavarësisht nga fakti që në një afat të shkurtër vetë këto shtete do të përfitonin direkt,

për shembull, nga eliminimi i fshikullimit të minave tokësore antinjeri, ose zvogëlimi i dhunës së organizuar. Shumë shtete, veçanërisht në jug, e kanë konsideruar konceptin e *sigurisë njerëzore* si një justifikim të hollë të një forme ndërhyrjeje, si një mënyrë për të kundërvënë njerëzit kundër shteteve të tyre. Në këtë rast, siguria njerëzore është pjesë e një prirjeje më të gjerë e shumë avokatëve dhe analistëve, kundër sfondit të luftës në Kosovë (1999), gjenocidit në Ruanda (1994) dhe kolapsit të autoritetit të shtetit në vende si Somalia, për të debatuar se komuniteti ndërkombëtar nuk mund të tolerojë abuzime të drejtave të njeriut në një shkallë masive, thjesht duke bërë parë se si mijëra jetë vireshin në rrezik në emër të principeve abstrakte të sovranitetit dhe mosndërhyrjes.

Brenda sistemit të OKB-së, kjo u demonstrua nga përkufizimi i zgjeruar i “kërcënimeve të paqes ndërkombëtare dhe sigurisë”, që u shfaqën në mesin e 1990-ës, si një përgjigje për situatën në Somali (dhe gjetkë). Ishte shumë e parëndësishme nëse kjo logjikë e ndërhyrjes mori apo jo formën më të fortë të përdorimit të forcave të armatosura për të përmbysur një qeveri ose për të detyruar atë për të ndryshuar politikën ose sjelljen, ose u shpreh nëpërmjet formave më të lehta të kushtëzimit dhe presionit për t’u përshtatur me kuptime të veçanta të qeverisjes së mirë në fushën politike, ekonomike dhe sociale. Perceptimi ishte që një vizion i tipit “njerëzit - në qendër” i politikave botërore vë përballë individët me shtetet e tyre dhe u duk se i dha të huajve *droit de regard* mbi marrëdhënien midis shteteve dhe qytetarëve të tyre, duke zgjeruar rrethanat në të cilat komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërhyjë në çështje që deri tani janë konsideruar se i përkasin kufijve të brendshëm të juridiksionit të shtetit.

Ka, gjithsesi, diçka të vërtetë për pikëpamjen e idesë së sigurisë njerëzore të promovuar, me qëllim ose jo, një axhendë që mund t’i japë shtysë një të drejte apo ndërhyrje të çliruar, të paktën në kuptimin që gjuha e sigurisë njerëzore është përdorur për të luftuar kulturën e mosndëshkimit dhe për të forcuar institucionet e shoqërisë civile dhe OJQ-të. Është, gjithashtu, e qartë që ka pasur një lidhje midis promovimit kanadez të sigurisë njerëzore (nga i atëhershmi Ministër i

Jashtëm Lloyd Axworthy) dhe krijimit të Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetit Shtetëror (ICISS) i sponsorizuar nga Kanadaja, që publikoi raportin e tij mbresëlënës *Përgjegjësia për të Mbrojtur* më 2001. Ky raport ishte një përpjekje për të rimenduar idenë për ndërhyrje humanitare brendapërbrenda strukturës së sigurisë njerëzore. Ai miratoi së fundi një qasje të kujdesshme për rrethanat në të cilat ndërhyrja për qëllime humanitare mund të konsiderohej dhe vendosi qartësisht: “Autorizimi i Këshillit të Sigurimit duhet të nxirret në të gjitha rastet para se të zbatohet çdo lloj veprimi ndërhyrës ushtarak”. Ai shkoi, gjithashtu, më tepër se një fokus ekskluziv mbi këtë Këshill për të përcaktuar se kur Këshilli i Sigurimit nuk mundet ose nuk dëshiron të veprojë, duhet të merren në konsideratë mjete alternative të përmbushjes së përgjegjësisë për të mbrojtur, duke përfshirë veprime nën autoritetin e Asamblesë së Përgjithshme ose organizatave rajonale. I qëndrueshëm në fokusin e tij mbi sigurinë njerëzore, ICISS shpalli:

Nëse Këshilli i sigurisë dështon në shkarkimin e përgjegjësisë së tij në situatë shokuese që kërkon veprime, atëherë është jorealiste për të pritur që shtetet e shqetësuara do të përjashtojnë mjete të tjera dhe forma të veprimit për t'u ndeshur me rëndesën dhe urgjencën e këtyre situatave. Nëse organizata të përbashkëta nuk do të autorizojnë ndërhyrje të përbashkëta kundër regjimeve, që përçmuan normat më elementare të sjelljeve qeverisëse të legjitimuara, atëherë presioni për ndërhyrje nga koalicionet ad-hoc ose shtete individuale me siguri do të intensifikohet.

Çfarë është e rëndësishme për t'u nënvizuar është që ky aksion duhet të justifikohet publikisht, meqenëse ka ndjekur rregullat bazë dhe principet, dhe që ky justifikim duhet të pranohet nga një konsensus i fuqishëm i shteteve. Një pjesë e rëndësishme e këtij justifikimi është një princip paraprak i “qëllimit të drejtë”, që demonstroi: “Synimi kryesor i ndërhyrjes... duhet të jetë për të ndaluar ose për të shmangur vuajtjen njerëzore. Qëllimi i drejtë sigurohet më mirë me operacione shumëpalëshe, të mbështetura qartësisht nga opinioni rajonal dhe viktimat përkatëse”.

Një pikë deri diku më e fortë është që njerëzit nuk duhet të impresionohen shumë nga çfarë elitat shtetërore thonë për

sigurinë njerëzore, sepse një nga burimet më të mëdha të kërcënimit për sigurinë e njerëzve vjen nga shteti - nga gjyqtarë dhe policë të korruptuar, nga banda të dhunshme dhe të padisiplinuara të ish-luftarakëve, nga udhëheqës grabitqarë që injorojnë të drejtat themelore dhe shtetin e së drejtës. Siç parashtron dhe ICISS, komuniteti ndërkombëtar mund të mos ketë të drejtë për të ndërhyrë, por duhet të ketë një përgjegjësi për të mbrojtur anëtarët e pafuqishëm të çdo komuniteti, veçanërisht nga kërcënimet e dhunës gjerësisht të përhapur dhe gjenocidit. Përsëri e parë në një perspektivë më të gjatë historike, kjo përfaqëson një projektim të jashtëm ose globalizim të logjikës (dhe etikës) mbrapa luftërave shekullore të gjata, që rezultuan të ishin emergjente për shtetet liberale në shek. XIX dhe XX.

6. Një axhendë konkrete për Veprim Politik

Çfarë ka mbetur është të ilustrojmë se si axhenda politike e sigurisë njerëzore është zgjeruar në mënyra që implikojnë, gjithashtu, ribërjen e marrëdhënieve midis shteteve dhe qytetarëve të tyre, nën imazhin e shtetit liberal Westphalian. Kjo është themelore, meqenëse influenca e një ideje të tillë nuk mund të matet vetëm nga diskutimi, por nga fakti nëse ajo informon, ose është e lidhur me një grup konkret praktikash që janë ose të reja ose që përfaqësojnë një nisje të rëndësishme nga praktikat e mëparshme. Në rastin e sigurisë njerëzore, kishte të paktën një paketë specifike të iniciativave politike, që u shfaqën në fundin e 1990-ës, dhe që përfaqësonin një nisje të njëanshme nga mënyrat ekzistuese e të praktikuarit të diplomacisë për një sërë shtetesh. Ky ishte krijimi i Rrjetit të Sigurisë Njerëzore. U themelua më 1999-ën, si një grupim shtetesh të drejtuara nga Kanadaja, Norvegjia dhe Zvicra, dhe duke përfshirë Kilin, Jordaninë, Austrinë, Irlandën, Malin, Greqinë, Sllovakinë, Tailandën, Afrikën Jugore (si një vëzhguese), si dhe Holanda, që kishin si qëllim të ndiqnin politika të përbashkëta mbi sigurinë njerëzore në një sërë institucionesh ndërkombëtare dhe rajonale. Ata takohen për

vit në nivelin e Ministrive të Jashtme, dhe gjatë vitit ndjekin iniciativat e tyre në një varietete mënyrash formale dhe informale, si një forum për koordinimin dhe formimin e axhendës ndërkombëtare të sigurisë. Si rezultat, shumë nga anëtarët e shteteve, veçanërisht të tre shteteve drejtuese, kanë dhënë, gjithashtu, burime të rëndësishme financiare për promovimin e iniciativave të sigurisë, shpesh përkrah me organizatat joqeveritare ose me anëtarët e shteteve të tjera të Rrjetit.

Në nivelin praktik, aktivitetet e HSN-së ngritën një axhendë konkrete për veprim politik për një sërë çështjesh, si: eliminimin e fshikullimit të minave tokësore antinjeri, ndalimin e përdorimit të ushtarëve fëmijë, promovimin e respektit për ligjin ndërkombëtar humanitar (IHL) dhe punën e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, luftimin e riprodhimit dhe keqpërdorimit të armëve të lehta, rritjen e përpjekjeve për të mbrojtur civilët në konflikt, puna drejt reformave të forcave të armatosura, policisë dhe sistemit të drejtësisë kriminale (reformë në sektorin e sigurisë). Është e pamundur të përmbledhësh të gjitha iniciativat individuale, që janë ndjekur nën axhendën e gjerë dhe ambicioze. Tre shembuj mund të ofrohen, gjithsesi, për të treguar se si axhenda e sigurisë njerëzore evoluoi nga përqendrimi i mëparshëm në çështje relativisht të ngushta dhe të rezervuara, drejt marrjes përsipër të disa politikave dhe programeve që janë përfshirë në një axhendë më të thellë të shtet-ribërjes së sigurisë njerëzore.

E para është evolucioni i çështjes së minave tokësore antinjeri. Përpjekje të hershme në mesin e 1990-ës u fokusuan në negocimin e një ndalimi brenda kontekstit të kontrollit të armëve dhe instrumenteve të çarmatimit ekzistues. Nga 1996, kur këto përpjekje dolën të padobishme, një koalicion shtetesh dhe OJQ-sh të të njëjtit mendim morën përsipër të negocionin një ndalim total në një forum *ad-hoc*, rezultati ishte Traktati i Ottawes, 1997 (që hyri në fuqi më 1999). Fokusi parësor ishte ndalimi i përdorimit (duke përfshirë zhvillimin, prodhimin, transferimin dhe kursimin) të minave tokësore antinjeri. Për një kohë të shkurtër, gjithsesi, vëmendja u fokusua më së shumti në asistencën për viktimat e minave tokësore dhe në

periudhën më të vonshme, në eksplorimin e sinergjisë midis veprimeve të minave (zakonisht nënkupton çminimin praktik) dhe çështjet e zhvillimit social dhe ekonomik. Ajo që filloi si një çështje e “kontrollit të armëve” evoluoi në një çështje humanitare ose të sigurisë njerëzore dhe pastaj vazhdoi si një shqetësim për kapacitetin e shteteve dhe nevojave të zhvillimit të komuniteteve të prekura. Ky progresion logjik nuk ishte parashikuar realisht nga ndonjëri, por reflektonte një proces të të mësuarit, nga i cili shtetet e shqetësuara e thelluan angazhimin e tyre me një çështje të sigurisë.

Në një mënyrë të ngjashme, dikush mund të demonstrojë që një shqetësim i hershëm i shteteve të HSN-së me një çështje të profilit të lartë të fëmijëve ushtarë u shtjellua në një axhendë gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve (dhe grupeve të tjera të dobëta) në konfliktet e armatosura. Në fillim, qëllimi ishte thjesht të ndalohej rekrutimi i fëmijëve poshtë një moshe të caktuar (zakonisht 18) në forcat e armatosura, si të rregullta si të parregullta. Por siç parashtruan avokatët dhe studiuesit, kjo kapte vetëm një përqindje të vogël - dhe jo më të rëndësishmen - të fëmijëve thellësisht të prekur nga konflikti i armatosur. Vëmendja u kthye pastaj, nëpërmjet një seri rezolutash të Këshillit të Sigurimit (Rezoluta 1460 dhe 1539), në një çështje më të gjerë, atë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut (veçanërisht femrave) në situatat e konfliktit, dhe të përbaljes me këto fenomene, si një përdorim të rrëmbimit të paramenduar, si një strategji e luftës, ose trajtimi i dhunës seksuale si një krim lufte.

Ndoshta arena politike në të cilën kjo lidhje është më e dukshme është ajo e armëve të vogla e të lehta, e cila filloi si fushatë për të ndaluar minat tokësore antinjeri, me një fokus në kontrollin tradicional të armëve apo masave, për sa i përket furnizimit. Kjo përfshinte gjëra të tilla si përpjekja për të rritur rregullimin e tregut ndërkombëtar të armëve, vendosjen e një mekanizmi gjurmimi ndërkombëtar të armëve të paligjshme, shqetësimin për sigurinë e stokeve të armëve dhe kodet e drejtimit të transferimit të armëve të lehta. Brenda disa viteve, gjithsesi, axhenda u zgjerua, duke u fokusuar në çarmatimin post-konfliktit, në përpjekjet çmobilizuese dhe riintergruese

(DDR), në integrimin e mekanizmit të armëve të lehta në strategji zhvilluese të gjera, dhe në futjen e mekanizmit të armëve të lehta në strategjitë për parandalimin dhe uljen (duke përfshirë uljen e kërkesës) e dhunës së armatosur. Kjo ishte e lidhur me një pranim në rritje të faktit që burimet e shumicës së armëve në zonat e konfliktit ose e krimit të lartë ishin lokale, dhe se ulja e disponueshmërisë ose e shpërdorimit të armëve vareshin shumë nëse individët ose komunitetet ndienin që nevojat e tyre të sigurisë do të plotësoheshin nga mjetet e tjera - nga institucionet e shtetit. Lidhja midis armëve të lehta dhe uljes së dhunës dhe reformave në sektorin e sigurisë po shfaqet në mënyrë të ngadaltë në axhendën ndërkombëtare.

7. Përfundime

Megjithëse këto vëzhgime skematike dhe shembuj nuk nxjerrin tamam një rast gjithëpërfshirës që shpjegon rezonancën dhe rëndësinë e konceptit të *sigurisë njerëzore*, ato gjithsesi tregojnë se si shtetet, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, duke iu përgjigjur në një mënyrë pragmatike dhe praktike sfidave të politikës të periudhës së post-Luftës së Ftohtë, hapën derën për një axhendë më të gjerë, që në fakt përfshinë një konsiderim të gjerë të kuptimit të sigurisë - për kë, kundër kujt dhe me çfarë mjetesh. Zhvillimi i axhendës për “çlirimin nga frika” ishte *ad-hoc* dhe i bazuar në eksperiencën e shteteve me fuqi mesatare, duke punuar së bashku (dhe me raste në partneritet me OJQ-të), veçanërisht në fushatën ndërkombëtare për të ndaluar minat tokësore antinjeri. Megjithëse shtetet që arritën tek axhenda e sigurisë njerëzore e bënë këtë në shumë raste me bagazhet e politikave të tyre, që ata donin të promovonin, dhe megjithëse sipërmarrjet politike nga shtetet, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare kishin një veçori thelbësore që kërkonte zhvillimin e shpejt të praktikave të sigurisë njerëzore. Do të ishte një gabim të konsideronim se kristalizimi i konceptit të sigurisë njerëzore ishte një lloj rishqyrtimi, apo që përdorimi i tij si një etiketë për të përshkruar politikat që shtetet ishin

duke ndjekur, e bënte vetë konceptin të papërshtatshëm. Në fakt, konceptet më të rëndësishme në politikat ndërkombëtare (të tilla si sovraniteti, diplomacia, e drejta ndërkombëtare) u shfaqën si një *pasojë* e ndryshimeve në praktikën shtetërore, dhe pranimi që lidhjet e ndryshme të politikës dhe praktikës krijuan një lloj të ri të fushës politike, ose një formë të re të praktikës politike, që kërkon një etiketë të re.

Kështu, pyetja kryesore për t'iu përgjigjur është: se si ajo që shtetet po bëjnë sot ndahet nga kuptimi tradicional i axhendës së sigurisë ndërkombëtare të dhjetë apo njëzet viteve më parë? E parë në këtë aspekt, çështjet që përfshihen në konceptin e sigurisë njerëzore pothuajse mungonin tërësisht nga skena ndërkombëtare njëzet vjet më parë. Përdorimi i konceptit të *sigurisë njerëzore* për të bashkuar këto paralele të ndryshme të mendimit të zhvillimeve post-1945, atëherë kur koncepti i *sigurisë kombëtare* u kristalizua vetë në diskutimet dhe praktikën ndërkombëtare dhe “në momente të caktuara, frazat jo familjare papritur u bënë artikuj të zakonshëm të diskutimit politik dhe konceptet që ato përfaqësonin u bënë kaq të ngulitura në vetëdijen kombëtare sa që dukeshin se gjithmonë kishin qenë të pranishme”.

Koncepti i *sigurisë njerëzore* po futet në diskutimin politik në të njëjtën mënyrë. Si të gjitha konceptet e sigurisë, kuptimi i tij është krijuar nëpërmjet përpjekjeve të shumta të institucioneve dhe individëve dhe në botën e sotme është një koncept i fuqishëm rreth të cilit zhvillohen dhe promovohen politikat praktike dhe iniciativat konkrete.

Megjithëse siguria njerëzore mund të jetë një ide, të cilës i ka ardhur koha, kjo nuk e bën me imunitet ndaj vështrimit kritik. Këtu mund të ngrihen tri çështje kryesore. Së pari, siç u përmend dhe më lart, ka një paradoks të fuqishëm në promovimin e politikave që mund të çojnë në forcimin e shtetit në të njëjtën kohë kur shteti diagnostikohet si burim i një mase të madhe pasigurie njerëzore. Çarmatosja e të dobët pa kontrolluar të fortin, për shembull, nuk do ta çojë sigurinë njerëzore larg. Inkurajimi i qeverisjes së mirë me shpenzime ushtarake të ulëta mund, në disa raste, ta lërë shtetin pre të shkeljes së ligjit dhe anarkisë. Sigurisht, qëllimi është të kontribuosh për ndërtimin e shteteve të forta dhe legjitime,

por dilemat e fuqishme ose pasojat e paparashikuara që politikat e sigurisë njerëzore mund të shkrehin duhet të pranohen. Së dyti, fakti që shumë prej konceptimit të sigurisë njerëzore si dhe përpunimit të iniciativave politike konkrete është shfaqur më shumë nga shtetet, se sa nga shoqëria civile, përbën një problem. Shtetet, në mënyrë të paevitueshme, përballen me presione sistemike dhe konkurruese, që i çon ato të rikthehen në pozita tradicionale të politikave të jashtme dhe të sigurisë kur ato perceptohen se po paraprihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Brenda çdo burokracie të politikës së jashtme ka mbështetës të tradicionales, njëherazi me sipërmarrësit e politikave dhe balancat ndryshojnë midis të dyve, varësisht nga avantazhet apo disavantazhet e perceptuara që qasja e secilit i jep shtetit (ose ministrit të tij të Punëve të Jashtme). Kjo lloj ngarkese dhe tërheqje nuk është e surprizueshme, por mund të minoj angazhimin për promovimin e shqetësimeve reale të sigurisë njerëzore. Me siguri në Kanada dhe Norvegji, dy nga pararendësit e Rrjetit të Sigurisë Njerëzore, tradicionalistët kanë imponuar në momente të caktuara peshën e tyre specifike ndaj entuziastëve të sigurisë njerëzore.

Problemi i tretë lidhet me rolin e shoqërisë civile dhe aktorët jo shtetërorë në promovimin e sigurisë njerëzore. Në mënyrë që të arrihet liria nga frika, individët duhet të jenë të autorizuar për të zotëruar kontrollin e mjedisit të tyre dhe për t'u bërë aksionar në proceset politike, ekonomike dhe sociale që i afektojnë ata. Duke lidhur një numër dijetarësh të spikatur perëndimorë ose OJQ me idenë e sigurisë njerëzore dhe duke kërkuar imputin e tyre për një sërë çështjesh politike, kjo gjë ne vetvete nuk do të çojë përpara këtë proces nga poshtë-lartë të ndryshimit shoqëror. Me sa duket, një dialog më përfshirës midis shteteve dhe shoqërisë civile është i dëshirueshëm, por në fushën e sigurisë njerëzore, ashtu si edhe në shumë fusha, “multilateralizmi i ri” nuk shkon shumë larg, as nuk është i nevojshëm rasti që organizatat joqeveritare të jenë kontribuuese të barabarta ose partnere.

Por është, sidoqoftë, rasti që njerëzit për të cilët u intereson “çlirimi nga frika” janë kryesisht subjekte pasive në diskutimet mbi sigurinë njerëzore.

Gjithsesi, së fundmi, promovimi i një axhende të sigurisë njerëzore - promovimi i çlirimit nga frika drejton vëmendjen tonë drejt një numri sfidash esenciale kudo nëpër botë. Ajo shkon përtej parandalimit të konflikteve tradicionale ose axhendave të tjera për zgjidhjen e konflikteve dhe na çon ne të bëjmë disa pyetje të rëndësishme rreth faktit se si t'i bëjmë njerëzit të sigurtë në jetën e tyre te përditshme - në shtëpitë e tyre dhe në rrugë, brenda komunitetit të tyre, dhe në rajonin e tyre. Ajo hedh dritë, gjithashtu, në lidhjet midis dhunës e pasigurisë; zhvillimit të pamjaftueshëm dhe varfërisë dhe ndoshta mund të sjellë një drejtim ose energji të reja për disa segmente të komuniteteve zhvilluese. Për aktorët politikë dhe aktivistët, siguria njerëzore është një slogan i mrekullueshëm mobilizues. Ai i jep koherencë një sërë çështjeve politike që duhet të adresohen në mënyrë urgjente, duke përfshirë problemet e riintegritimit post-konfliktual, situatës së grupeve vulnerable në konflikt, rolin e armëve të lehta në të dyja situatat e luftës dhe jo luftës, dhe operacionit efektiv dhe legjitim që ne kemi ndërtuar për të krijuar siguri në shtetin modern. Më shumë se kaq, ai krijon një themel intelektualisht të fortë për iniciativat politike të fokusuara dhe të reja.

Promovimi bashkëkohor i sigurisë njerëzore është kulminacioni i projektit liberal për ndërtimin e institucioneve politike të forta, legjitime dhe përfaqësuese. Kjo e ka burimin në idetë sqaruese për rëndësinë e të drejtave individuale dhe liritë personale. Dhe nëse shekulli XX mund të karakterizohet si shekulli i “shtetit të sigurisë kombëtare”, ndoshta shekulli XXI do të shpaloset nën shenjën e sigurisë njerëzore.

Keith Krause është profesor i Politikave Ndërkombëtare në Institutin Graduate të Studimeve Ndërkombëtare, Gjenevë, Drejtor i Programit të tij për Studime të Sigurisë Ndërkombëtare dhe të Strategjisë (PSIS), si dhe Drejtor Programi i Studimit për Armët e Lehta. Interesi i tij kërkimor përqendrohet në tri fusha: çështjet e transportimit të armëve dhe çështjet bashkëkohore të kontrollit të armëve, ndryshimi i nocioneve të sigurisë dhe Sistemi i Kombeve të Bashkuara. Ai është në bordet editoriale të Qeverisjes Globale dhe Gazetës Europiane të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe ka shërbyer, së fundmi, në Bordin e Drejtorëve të Këshillit Akademik në Sistemin e Kombeve të Bashkuara.

Intervistë

Pjesë nga Seminari i Partneritetit për Paqen

MBROJTJA E INFRASTRUKTURËS KRITIKE (MIK) DHE PLANIFIKIMI I EMERGJENCËS CIVILE (PEC)

17-18 Nëntor 2003

Stokholm, Suedi

“Koordinimi ndërkuftar është më i rëndësishëm se kurrë. Nuk mund të mbështetemi më te zgjidhjet kombëtare për përballimin e kërcënimeve dhe dobësive, të cilat janë europiane ose botërore si natyrë. Në këtë gjendje të ndërlikuar të ndërvarësisë së dobët, mbrojtja e infrastrukturës sonë kritike është një pikë sa e fortë aq dhe e dobët. Dhe ne nuk kemi më zgjidhje. Ruajtja e sigurisë funksionale të shoqërisë sonë duhet të jetë një ndërmarrje e përbashkët; ajo kërkon një angazhim të përbashkët nga qeveritë, industria, organizatat dhe bota akademike”.

*Ann-Louise Eksborg, Drejtore e Përgjithshme
Agjencia Suedeze e Menaxhimit të Emergjencës*

Pyetje: *Si organizatore të seminarit, cila qe mbresa më e rëndësishme nga ai?*

Ann-Louise Eksborg: Në këtë “fshat global” ku jetojmë, ka pak tendenca kombëtare unike. Privatizimi dhe ndërkombëtarizimi i Infrastrukturës Kritike dhe rritja e përdorimit të sistemeve elektronike të kontrollit, konvergjenca e pjesëve të ndryshme të infrastrukturës teknologjike dhe skenarët e kërcënimit transnacional që ndeshim, na prek të gjithëve njësoj. Seminari që një konfirmim i pamohueshëm i faktit se sa i pamatur do të ishte të provohen dhe formulohen përgjigje e zgjidhje ndaj këtyre problemeve të përbashkëta pa u mbështetur e ndihmuar njëri-tjetrin.

James Harlick, *ish-Ndihmës Zv/Ministër, Zyra e Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike dhe Përgatitjes së Emergjencës, Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare, Kanada*: U impresionova nga interesi i madh për MIK-un siç u manifestua nga numri i pjesëmarrësve dhe vendeve të përfaqësuara. Kishte një dëshirë e interes të madh për të mësuar më shumë e për të ndarë informacionin.

Pyetje: *Shumë prezantime theksuan rëndësinë e ngritjes së besimit mes sektorëve dhe kufijve kombëtarë me qëllim ndarjen më mirë të njohurive e përvojës sonë mbi kërcënimet, rreziqet dhe pikat e dobëta. Si ndikoi seminari te kjo?*

Harlick: Seminari jo vetëm theksoi këtë rëndësi, por dhe sugjeroi që shtetet duhet të vënë në jetë elementet e bashkëpunimit duke ndarë analizën e rrezikut dhe atë parandaluese e duke zbatuar trajnimin e ushtrimit. Një dokument udhëzues do të plotësojë seminarin.

Eksborg: Ndërtimi i besimit merr kohë. Një seminar si ky mund të jetë një hap i parë. Pjesëmarrësit mësojnë kuadrot e referencës, njohin njëri-tjetrin dhe njihen me mënyrën e punës dhe mendimit të vendeve të tjera. Këto formojnë bazën e bashkëpunimit të ardhshëm. Partneriteti e bashkëpunimi mes shteteve merr forma të ndryshme. Në formën e tyre më të avancuar, përfshihet shkëmbimi i informacionit shumë të ndjeshëm. Gjetja e modeleve të përshtatshme të partneritetit mes sektorëve publikë e privatë është një çështje e rëndësishme në Suedi. Diskutimet treguan se edhe vende të tjera përballen me këtë sfidë. Shpresoj në vijimin e dialogut me vendet e tjera partnere.

Pyetje: *Së fundi, si do të donit të përdorej ky dokumentacion?*

Harlick: Shpërndarja e këtij raporti nuk duhet bërë vetëm te pjesëmarrësit, por dhe në libraritë e institucionet e arsimit të lartë. Di që kolegët e stafit të NATO-s synojnë futjen e MIK-ut në kurrikulat e tyre të arsimit dhe ndërgjegjësimit e nuk ka vend më të mirë për ta bërë këtë.

Eksborg: Shpresoj sinqerisht që materiali të lexohet gjerësisht, pasi përmban shumë ide të mira.

MBI MIK-UN, PEC-IN DHE ROLIN E NATO-S

Çështja e MIK-ut është komplekse pasi kalon mes kufijve tradicionalë të shërbimeve e funksioneve në një shoqëri moderne. Për ta trajtuar atë siç duhet, kërkohet miratimi i një qasjeje shumëdisiplinore për të lejuar përdorimin e ekspertizës nga shumë zona.

Pyetje: Si do t'i përshkruanit lidhjet mes MIK-ut dhe PEC-it?

Tom Hardie-Forsyth, Grupi Ad-Hoc i NATO-s për MIK-un: Infrastruktura kritike shihet tradicionalisht si një viktimitë potenciale dhe deri vonë nuk i është kushtuar kujdes si një element i mbrojtjes së emergjencës civile. Mund të parashikohet një situatë ku ndërtohen shumë gardhe rreth infrastrukturës kritike pasi ajo nuk mund t'i përgjigjet më me efektivitet emergjencave. Kjo marrëdhënie mes MIK-ut dhe PEC-it na lejon ta shohim infrastrukturën kritike në dritën e mbrojtjes civile. Nëse ne obsesohemi me sigurinë, mund t'i bëjmë sistemet tona aq të sigurta sa të mos t'i përdorim dot dhe kjo ndodh.

Pyetje: Ku qëndron përgjegjësia për MIK-un dhe PEC-in?

Forsyth: Nuk duhet t'i heqim përgjegjësinë kombeve të veçantë. Por duhet të kujtojmë se disa asete janë transnacionale. Nëse mendoni se një shtet mund të mbrojë i vetëm asetet e tij, kjo është të ëndërrosh. Duhet të intensifikojmë bashkëpunimin tonë transnacional e të fillojmë të punojmë së bashku, me partnerët, në kuadër dy a shumëpalëshe. Shumë nga çështjet përfshihen dhe në politikat kombëtare. Kështu, duhet të bëjmë objektiv dhe politikëbërësit.

Pyetje: Mund të përshkruani rolin e NATO-s në lidhje me MIK-un?

Stephen Orosz, Zv/Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm për PEC-in dhe Ushtrimet, Shtabi i NATO-s: NATO-ja ka një qasje të gjerë të sigurisë, siç shpjegohet në Konceptin Strategjik që prej 1999. Kërcënimet e sotme janë asimetrike dhe mjedisi i sigurisë është i paparashikueshëm. Një aspekt i mbrojtjes nga terrorizmi është mbrojtja e popullsisë civile çka

përfshin MIK-un. PEC-i ka një rol kyç në lidhje me këtë. Një punë e rëndësishme shpjeguese është bërë dhe një numër i madh veprimesh afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë janë duke u kryer.

Pyetje: *Pse mendoni se NATO-ja duhet të fokusohet mbi MIK-un?*

Orosz: Infrastruktura civile dhe pasojat e dështimit të saj nuk njohin kufij. Ndërvarësitë janë një shqetësim ndërkombëtar për të cilin NATO-ja vijon të jetë një forum i mirë diskutimi se si mund t'i përballojmë këto sfida.

Pyetje: *Cilat janë çështjet më të rëndësishme për NATO-n në të ardhmen në lidhje me MIK-un?*

Orosz: Janë disa. Rritja e shkëmbimit të informacionit brenda MIK-ut është një, një ekzaminim kritik se si kërkimi dhe zhvillimi mund të japin zgjidhje është një tjetër. Ne duhet gjithashtu të shohim si identifikohet infrastruktura kritike. Dhe përmes NATO-s, kombet duhet të ushtrojnë skenarë për zhvillimin e një reagimi ndaj çarjes apo shkatërrimit të infrastrukturës kritike.

Ndërtimi i partneriteteve, mobilizimi i kërkimit dhe teknologjisë

“Si mund të mobilizojmë tani njohurinë e duhur për të ndikuar politikëbërjen dhe për të zgjidhur këto patate të nxehta? Ka një diskutim masiv të infrastrukturës kritike, por më e rëndësishmja është infrastruktura sociale e individuale që ndërtojnë këtë njohuri. Fjala “nyje” është shumë e rëndësishme dhe ju duhet të ndërtoni këto rrjete përmes infrastrukturës dhe të gërmoni thellë në disa zona; për t'i pasur këto nyje apo organizata lidhëse në mbarë Europën dhe Atlantikun”.

Profesor Bengt Sundelius, Drejtues i Kërkimit dhe Trajnimit të Menaxhimit të Krizave, Kolegji Suedez i Mbrojtjes Kombëtare

Pyetje: *Çfarë nënkupton seminari për punën e ardhshme të MIK-ut?*

Sundelius: Ishte shume e vlefshme që takimet përfshinë aktorët strategjikë nga të dyja anët e Atlantikut. Europa nuk

mund të bëjë përpara në këto çështje pa partneritetin transatlantik.

Pauline Neville-Jones, Guvernatore Ndërkombëtare e BBC-së: Ai tërhoqi njerëz nga jashtë komunitetit teknologjik dhe i dha një profil politik temës në një nivel drejtuesish. Përgjithësisht kjo duhet: një vizion i përbashkët i arsyes së rëndësishme të MIK-ut. Njerëzit nuk mund të motivohen të veprojnë pa kuptuar arsyen pse duhet bërë.

***Pyetje:** Si e shihni marrëdhënien mes sektorëve publikë e privatë në lidhje me MIK-un?*

Neville-Jones: Është thelbësore që sektori shtetëror, sidomos qeveria të marrë drejtimin e të japë një shembull. Sektori privat duhet të punojë ngushtë me të, por mesazhi duhet t'u shkojë ndërmarrjeve të vogla e të mesme për të qenë, gjithashtu, të sigurt në një botë të ndërlidhur. Ata shpesh besojnë se kjo çështje nuk u përket dhe u sjell kosto ekstra të padëshirueshme.

***Pyetje:** Ç'tip bashkëpunimi kërkimi e teknologjie kërkohet për arritjen e rezultateve të vlefshme të kërkimit të MIK-ut?*

Sundelius: Duhet ngritur ura përmes interesave publike e përfitimeve private, përmes disiplinave e qasjeve të ndryshme dhe përmes sferave të njohurive dhe veprimtimit të besueshëm. Puna mbi dobësitë strukturore duhet kombinuar me analizën e kërcënimeve antagonistike për arritjen e një qasjeje më të mirë të asaj çfarë mund të sigurohet e çfarë jo.

***Pyetje:** Ku do të bëhet studimi tjetër i MIK-ut?*

Sundelius: Institucionet e kërkimit me financime publike e private duhet të angazhohen dhe ata priren nga logjika të ndryshme. Konkurrenca e shëndetshme mes instituteve të ndryshme të kërkimit mund të japë një efekt pozitiv.

***Pyetje:** A ka një vullnet politik dhe mirëkuptim të duhur?*

Sundelius: Ka një rrezik që axhendat politike dhe të medias të ikin nga kjo fushë e rëndësishme e të lëvizin drejt një fokusi të prirur nga ngjarja si sulmet terroriste në SHBA apo

Madrid. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim disa pista njëherësh jo të ecim mes ngjarjeve spektakulare jo gjithnjë të rëndësisë së madhe.

Pyetje: *Cilat janë sfidat e mëdha për zhvillimin e njohurisë në MIK?*

Sundelius: Ruajtja e ritmit të punës që ekzistonte para sulmeve terroriste dhe luftës së Irakut.

“Infrastrukturë kritike do të thotë pajisje, shërbime e sisteme informacioni që janë kaq vitale për kombet sa paaftësia apo shkatërrimi i tyre do të kishte një ndikim dobësues mbi sigurinë kombëtare, ekonominë kombëtare, shëndetin publik, sigurinë dhe funksionimin efektiv të qeverisë. Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike (MIK) përfshin programet, veprimtaritë dhe ndërveprimet e qeverive, pronarëve, operatorëve dhe aksionarëve për të mbrojtur infrastrukturën e tyre kritike”.

Partneriteti për paqe është një iniciativë e NATO-s që synon rritjen e besimit dhe koordinimin e përpjekjeve të forcimit të sigurisë. Ajo angazhon NATO-n dhe vendet e saj partnere pjesëmarrëse në aktivitete praktike bashkëpunimi me synim arritjen e këtyre objektivave. Ajo i ofron shteteve pjesëmarrëse mundësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të tyre me NATO-n në përputhje me interesat dhe mundësitë e tyre individuale. Gjithë anëtarët e kësaj iniciative janë gjithashtu anëtarë të Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik, i cili siguron kuadrin e përgjithshëm për bashkëpunimin mes NATO-s dhe vendeve të saj partnere.

Qendra për Studime të Sigurisë (QSS)
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN)

DREJT NJË QASJE TË RE
NË PARANDALIMIN E KRIMIT

Hyrje

Parandalimi i krimit përbën një nga çështjet dhe detyrimet më të rëndësishme për një shoqëri të civilizuar. Në themel të filozofisë dhe arsyes së krijimit dhe ekzistencës së institucioneve të specializuara të ngritura enkas për të siguruar rend dhe qetësi publike, qëndron pikërisht detyrimi për të parandaluar krimin. Mjafton të përmendet se për kontrollin e krimit shpenzohen përqindje gjithnjë në rritje të buxheteve të shteteve (rreth 5% të GDP-së në vendet e zhvilluara dhe rreth 14% në vendet në zhvillim¹ për të parë nevojën në rritje për të fokusuar vëmendjen në këtë drejtim. Tashmë është e qartë se strategjitë e mirëplanifikuara të parandalimit të krimit nuk kanë vetëm rol parandalues, por rrisin sigurinë e komunitetit, sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të vendit e rrisin cilësinë e jetës. Po, kështu edhe kostot financiare e sociale ulen².

Në Shqipëri, në vitet '90, demokratizimi i vendit u shoqërua nga liberalizimi i çdo sfare të jetës, çka pavarësisht efekteve të pritshme për sa i përket lirive e të drejtave të njeriut, solli paevitueshmërisht dukuri e fenomene që e kanë dëmtuar seriozisht besimin e shoqërisë në autoritetin e shtetit dhe në perspektivën e saj. Kështu, korrupsioni, lëvizja kaotike demografike, mungesa dhe mosrespektimi i rregullave e ligjeve

¹ Press Kit Backgrounder No. 2 - Published by the United Nations Department of Public Information - DPI/2088/CC.

² United Nations Economic and Social Council, Commission on Crime Prevention and Criminal Justice - Guidelines for the Prevention of Crime - Report on the eleventh session, Official Records 2002, Supplement No. 10, 16-25 April 2002, New York, United States of America.

etj., solli krijimin e informalitetit në shoqëri (ekonomi, demografi etj.), e mandej rritjen në përmasa të konsiderueshme të kriminalitetit. Krahas kësaj, zhvillimi jo i barabartë midis zonave urbane solli krijimin e disniveleve sociale dhe blloqeve a lagjeve të pasura, mesatare e atyre të varfra apo me probleme të mprehta sociale e infrastrukturore. Kjo ndarje e re, por sidomos situata demografike e kulturore karakterizohet dhe nga tipa të ndryshëm popullsie banuese e tipa të ndryshëm kriminaliteti. Niveli ekonomik e kulturor ndikon ndjeshëm në përqindjen e kriminalitetit në komunitete apo mosha të caktuara, çka nënkupton se ky nivel dhe kjo natyrë kriminaliteti bëhen më të theksuara sot në raport me synimet strategjike të integritimit të vendit.

Parandalimi i krimit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm dhe që nuk kërkon vetëm masa konkrete të karakterit teknik që ndikojnë direkt në uljen e kriminalitetit, pra të karakterit thjesht penal. Rëndësi të dorës së parë merr gjetja e shkaqeve dhe burimeve të kriminalitetit, forcimi i rolit drejtues së institucioneve të larta shtetërore në këtë proces dhe mandej hartimi i strategjive parandaluese gjithëpërfshirëse dhe bërja e tyre pjesë e politikave kombëtare të zhvillimit, nxitja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të përpjekjeve të të gjitha hallkave të shtetit dhe shoqërisë.

I. Parandalimi i krimit në Shqipëri: Mënyra e reagimit të institucioneve dhe efica e tyre

Legjislacioni në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve në Shqipëri, jo gjithmonë parashikon detyrimin ligjor për punë parandaluese si një nga më të rëndësishmet dhe me efekte më të qëndrueshme në kohë. Kështu, për shembull, në ligjin themelor, atë të për Policinë e Shtetit Nr. 9749, datë 4.6.2007, vetëm në Nenin 4 përmendet termi “parandalim” si një nga shumë përgjegjësitë e Policisë; ndërsa Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë N. 8737, datë 12.02.2001 e pikërisht Neni 5 i tij i dedikohet tërësisht “Veprimtarive parandaluese” së

prokurorisë, duke u shprehur se “Prokuroria organizon dhe/ose bashkëpunon me institucione shtetërore, si dhe me subjekte të tjera publike apo private për veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit”. Ndërsa, në Ligjin për Policinë veçse përmendet përgjegjësia për parandalim, në Ligjin e sipërpërmendur të prokurorisë ka një konceptim më të qartë se çfarë kuptohet me veprimtari parandaluese. Gjithsesi, përvoja kombëtare e IDN-së në këtë drejtim, dëshmon mungesë pothuajse totale të angazhimit të këtij institucioni për zbatimin e detyrimeve ligjore, në raste jo të rralla edhe mosnjohje të dispozitave ligjore.

Strategjia Kombëtare e Sigurisë e miratuar me ligjin Nr. 9322, datë 25.11.2004 parashikon në pikat 11, 46 e 48 një përgjigje të organizuar ndaj krimit, ndërtimin e funksionimit e organizmave ndërministrorë dhe sigurimin e shkëmbimit e nevojshëm të informacionit me qëllim parandalimin e krimit. Por, megjithëse në këtë strategji përcaktohen disa më qartë edhe institucionet përgjegjëse, gjatë periudhës së saj të implementimit shumë pak është konsultuar ky dokument për të udhëhequr një proces zbatimi konkret në realitetin e vendit.

Një trajtim më i plotë dhe i konceptuar më drejtë në lidhje me detyrimet institucionale për parandalimin e krimit është bërë në strategjinë 7-vjeçare të policisë (2007-2013), ku përcaktohet se policia nuk është institucioni i vetëm përgjegjës për parandalimin e krimit. E reja që ofron ky dokument strategjik për vitet e ardhshme qëndron më shumë në filozofinë, qasjen dhe metodologjinë e policimit që i shkon për shtat një praktike parandaluese të policimit. Kështu, për shembull, kapituj të tillë të këtij dokumenti strategjik - “Ndërtimi i Partneritetit”, “Përmirësimi i cilësisë së shërbimit kundrejt publikut”, apo “Reduktimi i mëtejshëm i krimit dhe sjelljes antishoqërore” - që përcaktojnë disa nga prioritetet e policimit (por jo vetëm në këto kapituj), përafrojnë praktika parandaluese, por nuk çojnë drejtpërsëdrejti në bashkëpunime ndërinstitutionale për hartimin e politikave apo koordinimin e plan-veprimeve si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor për parandalimin e krimit.

Mangësitë e një këndvështrimi qendror apo nga lart në lidhje me nevojat dhe shkaqet vendore për parandalimin e krimit, apo edhe kufizimet në konceptimin e kapitujve të mësipërm të Strategjisë 7-vjeçare të Policisë së Shtetit duken më qartë në Planin e Veprimit, që shoqëron këtë dokument të rëndësishëm.

Kështu, krijimi i partneriteteve, krijimi i grupeve të përbashkëta në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal (3.1.2) për parandalimin e krimit ka si përgjegjës dhe realizues vetëm departamente të caktuara të Policisë së Shtetit, qoftë në nivel vendor, qoftë në nivel kombëtar. Gjithashtu, i mëshohet edhe inicimit të aktiviteteve për parandalimin e krimit (6.4.3), por që gjithsesi nuk përmendet asnjë nga partnerët apo aktorët e tjerë jashtë institucioneve të parashikuara në këtë sipërmarrje.

Po në kuadër të parandalimit apo luftës kundër dukurive të tilla si “dhunës ndaj fëmijëve”, “dhunës në familje”, luftës ndaj “gjakmarrjes dhe hakmarrjes”, “ndaj sjelljes antishoqërore”, ky Dokument Strategjik i Policisë i trajton të ndara në nënkapituj (si dukuri që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën), ndërkohë që mekanizmat, apo aktivitetet, qoftë edhe partnerët jashtë-institucional për realizimin e aktiviteteve parandaluese ndaj dukurive të sipërpërmendura janë pothuajse të njëjtë. Për më tepër, që zhvillimet bashkëkohore për punën në terren diktojnë tendencën që edhe oficeri apo punonjësi i policisë qoftë edhe në rolin bazë është duke u shndërruar në një kapacitet shumëfunksional, që nuk do të përjashtohet nga detyrime edhe për luftën ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar. Pra, me fjalë të tjera ky dokument ka tendencën të pranojë rëndësinë e bashkëpunimeve ndër-institucionale për parandalimin e krimit, apo bashkëpunimin me komunitetin dhe qytetarët, por nuk shkon më tej. Në fakt, Strategjia i hap rrugën legjislacionit të ri për parandalimin në mënyrë kombëtare dhe vendore parandalimit të krimit, ndonëse nuk e përmend atë.

Nga ana tjetër, Strategjia vazhdon ta shohë luftën për parandalimin e figurave të ndryshme të krimit veçmas kur ngarkon Departamentin për Hetimin e Krimeve dhe Drejtorinë e Standardeve Profesionale për hartimin brenda

2008 të projektligjit për “Marrjen e përgjegjësive të të zgjedhurve për luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes” (Plani i Veprimit, pika 6.3.1). Pa paragjykuar këtë projektligj, të gjithë bien dakord se lufta kundër fenomenit të gjakmarrjes nuk mund të jetë detyrim vetëm i të zgjedhurve, për më tepër që nga kjo nuk mund të përjashtohen institucione mirëfilli të zbatimit të ligjit si policia, apo ato të gjyqësorit si prokuroria dhe gjykatat, e as ato të edukimit e të ndihmës dhe përkrahjes sociale. Duke shkuar më thellë në arsyetim, një ligj i tillë nuk mund të jetë njëkohësisht, edhe kombëtar në natyrë, edhe i kufizuar në zona të ndryshme të vendit, ku ka një predominancë të kësaj figure krimi. Akoma më pak e arsyetuar mund të shfaqet nevoja për një projektligj të tillë, kur vetë Policia e Shtetit në raportin e saj të analizës për 2007 ka deklaruar se “Gjatë vitit 2007 nuk ka pasur asnjë vrasje me motiv gjakmarrjen”.³ Por, a mund të mendohet nevoja për një nismë të tillë. Siç shpjegohet edhe më poshtë, ajo mund të jetë veçse pjesë e një sipërmarrjeje ligjore për parandalimin e krimit në përgjithësi, ku hakmarrja apo gjakmarrja mund të jetë një nga dukuritë sipas evidencave vendore të kriminalitetit.

Nëse Strategjia 7-vjeçare e Policisë së Shtetit është parë thjesht në këndvështrimin institucional të Policisë së Shtetit, atëherë del nevoja e ligjshme për krijimin e strukturave koordinuese në nivel vendor apo kombëtar për politika dhe plane veprimi që do t'i hapin rrugë bashkëpunimeve ndërinstytucionale për përballjen me burimet e kriminalitetit që mund të kenë natyrë qoftë ekonomike e sociale, apo kulturore e arsimore e të tjera.

Mungesa e një kuadri të plotë ligjor e nënligjor dhe strukturave përkatëse për parandalimin e krimit ndikon jo vetëm në mosangazhimin dhe preokupimin e përbashkët të të gjitha institucioneve shtetërore të zgjedhura apo të emëruara, por drejtpërdrejt në suksesin e përpjekjeve dhe kohëzgjatjen e situatës aktuale. Vlerësimi se parandalimi është detyrë vetëm e policisë është jo vetëm joprofesionale, por dhe joproduktive,

³ Analiza vjetore e veprimtarisë së Policisë së Shtetit - 13 janar 2008. Prezantuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit z. Ahmet Premçi.

sepse përballja me këto dukuri janë përgjegjësi e gjithë shtetit dhe shoqërisë.

Qëndrimet e deritanishme të qeverive mund të quhen situacionale, ndërsa masat e marra kanë qenë masa të natyrës emergjente, apo në ndonjë rast të diktuar nga axhenda ndërkombëtare. Iniciativat e ndryshme ligjore të qeverive në vite kanë çuar në ngritjen e një numri të madh komitetesh (dhe siç është parashikuar në Strategjinë e lartpërmendur do të vazhdojnë të ngrihen) për krime dhe dukuri të ndryshme - si trafikëve të paligjshme⁴, mbjellje e bimëve narkotike⁵, pastrimit të parave⁶, të sigurisë rrugore⁷ - thjesht si reagim ndaj fenomeneve të mprehta kriminale. Por kjo është bërë vetëm pasi këto dukuri apo shkalla e përhapjes së tyre janë bërë shqetësuese për shtetin e shoqërinë. Ngritja e funksionimi i komiteteve kombëtare shoqërohet edhe me ngritjen e atyre vendore pranë prefektëve të qarqeve, të cilat duhet të funksionojnë dhe të trajtojnë problematika edhe në ato rajone ku figura konkrete e krimit për të cilën është ngritur komiteti, është shumë pak e pranishme, për të mos thënë inekzistent. Dukshëm ekzistenca e tyre jo vetëm që e rëndon aktivitetin normal të institucioneve vendore, por dhe krijon premisa për shmangien e vëmendjes nga problemet më të mprehta dhe kthimin e tyre në autoritete formale që nuk gëzojnë besimin e institucioneve dhe as atë të qytetarëve.

Ajo çka konstatohet sot qartësisht, është mungesa e rezultateve që shprehet në një mungesë të theksuar mbledhjeje informacioni, analizë profesionale e ekspertize dhe mungesë të rekomandimeve e iniciativave konkrete ligjore për parandalimin real të krimit. Këto struktura shtetërore si dhe politikat e masat e pakoordinuara nuk rezultojnë të efektshme, përkundrazi ngarkojnë dhe ndoshta

⁴ Vendimi nr. 8, datë 5.1.2002, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore" i ndryshuar. Shih, gjithashtu, edhe Strategjinë Kombëtare kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore 2005-2007.

⁵ Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës. Shih, gjithashtu, edhe Strategjinë Kombëtare të Parandalimit të Drogës.

⁶ Komitetit Shtetëror të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

⁷ Komitetit Ndërmintor të Sigurisë Rrugore.

pengojnë realizimin e një strukture e një strategjie të unifikuar shtetërore në drejtim të parandalimit të krimit me përfshirjen e gjithë figurave të tij.

Krijimi i strukturave të posaçme për parandalimin e krimit janë mbi të gjitha detyrim i një shoqërie të civilizuar dhe demokratike për të rritur përgjegjshmërinë e çdo institucioni dhe për të vendosur partneritete në drejtim të investimit mbarëshoqëror dhe institucional për parandalimin e krimit. Gjithashtu, procesi i stabilizim-asocimit dhe integrimi i mëtejshëm i vendit në bashkësinë europiane, kërkon heqjen dorë nga politikat dhe praktikrat e emergjencës apo të formalitetit, duke përqafuar praktika efektive europiane në përputhje me standardet e *acquis*.

III. Praktika ndërkombëtare

Praktika botërore sugjeron se përpjekjet për parandalimin e kriminalitetit kanë gjithnjë e më shumë peshë në politikat e strategjitë kombëtare të sigurisë së vendeve të ndryshme. Vlen të përmendet përvoja amerikane më një numër të madh organizatash apo rrjetesh për parandalimin e krimit në nivel shteti e federal dhe për të gjitha figurat e krimit; përvoja europiane, ajo australiane (ku financohen një numër i madh projektesh të një game të gjerë aktiviteteve me qëllim parandalimin) etj., ku jo vetëm investimet dhe financimet buxhetore, por dhe orientimi i strukturave të autoriteteve të zbatimit të ligjit bëhet në mbështetje të prioritetit që i jepet parandalimit dhe luftës kundër krimit.

III.1. Bashkimi European:

Ajo çka bie menjëherë në sy në praktikën europiane është serioziteti dhe rëndësia që institucionet e Bashkimit European i kushtojnë parandalimit të krimit. Duke parë tendencën në rritje të kriminalitetit si dhe nevojën për parandalim, ato kanë ndërmarrë një sërë masash e iniciativash në këtë drejtim. Kështu:

- Parlamenti European miratoi më 16 dhjetor 1993 “Rezolutën për krimin ordiner në zonat urbane dhe lidhjet e tij me

krimin e organizuar”⁸ dhe më 17 nëntor 1998 “Rezolutën për direktivat dhe masat për parandalimin e krimit të organizuar në lidhje me ngritjen e një strategjie gjithëpërfshirëse për ta luftuar atë”⁹.

- Neni 29 i Traktatit të Bashkimit Europian në paragrafin e dytë të tij sanksionon se objektivi i Bashkimit në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale duhet të arrihet duke parandaluar dhe luftuar krimin, e organizuar apo tjetër.
- Plani i Veprimit të Vjenës (1998) kërkonte hartimin e masave për parandalimin e krimit për 5 vitet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.
- Këshilli Europian i Tamperit i 15 e 16 Tetorit 1999 konkludoi mbi nevojën për të zhvilluar masa të parandalimit të krimit, për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të forcuar rrjetin e autoriteteve kombëtare për parandalimin e krimit si dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave kombëtare të specializuara në këtë fushë, duke specifikuar që ky bashkëpunim mund të ketë si prioritet të parë krimin e moshave të reja, atë urban dhe atë të lidhur me drogën. Për këtë qëllim u kërkua bërja e një studimi mbi mundësinë e një programi të financuar nga Komuniteti.
- Strategjia e Bashkimit Europian për fillimin e një mijëvjeçari të ri mbi parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar në Rekomandimin 6 i kërkon Këshillit të asistohet nga ekspertë të kualifikuar në parandalimin e krimit, si pikat kombëtare të kontaktit apo duke ngritur një rrjet ekspertësh nga organizatat kombëtare të parandalimit të krimit.
- Seminare dhe konferenca të shumta mbi parandalimin e krimit si ato të Stokholmit në 1996, të Noordwijkut në 1997-ën, të Londrës në 1998-ën e të Algavrës në 2000-shin kanë kërkuar ngritjen e një rrjeti mes Bashkimit Europian

⁸ European Parliament Resolution on small-scale crime in urban areas and its links with organized crime. Date 16 December 1993 (OJ C 20, 24.1.1994, p. 188).

⁹European Parliament Resolution on guidelines and measures for the prevention of organized crime with reference to the establishment of a comprehensive strategy for combating it. Date 17 November 1998 (OJ C379, 7.12.1998, p. 44).

për të zhvilluar bashkëpunimin mbi parandalimin e krimit. Konferenca e Nivelit të Lartë në Algavre (2000) theksoi, gjithashtu, nevojën për një qasje të përbashkët shumëplanëshe për parandalimin e krimit. Konferenca në Saragozë në 1996 ndërkohë kish nënvizuar këtë nevojë duke theksuar lidhjet e forta që ka krimi i organizuar me krimin në përgjithësi.

- Komisioni Europian miratoi në mars 2004 një “Komunikim mbi parandalimin e krimit në BE”. Duke pasur parasysh se krimi jo i organizuar kryhet në nivel lokal, Komunikimi rikërkoi zbatimin e politikave efektive me mbështetje kombëtare. Për shkak se disa Shtete Anëtare nuk kanë zhvilluar ende politika të parandalimit të krimit jo të organizuar, Komisioni u ka kërkuar angazhim në miratimin e tyre.
- Së fundmi, më 12 shkurt 2007 Këshilli i BE-së miratoi një program të veçantë “Parandalimi dhe lufta kundër krimit” për periudhën 2007-2013 me një buxhet të përgjithshëm prej 600 milion •.

Duke kuptuar dhe çmuar maksimalisht rolin dhe nevojën e parandalimit të krimit por dhe të bashkimit të përpjekjeve të shteteve e shoqërive të ndryshme për t’i bërë ballë kriminalitetit, Këshilli i Bashkimit Evropian pas iniciativës së Francës dhe Suedisë, dhe duke u bazuar në nenet e Traktatit të BE-së, me Vendimin e 28 majit 2001 sanksionoi ngritjen e një rrjeti evropian për parandalimin e krimit. Ky rrjet pikash kombëtare kontakti do të kontribuojë në zhvillimin e aspekteve të ndryshme të parandalimit të krimit në BE dhe do të mbështesë aktivitetet e parandalimit në nivel lokal e rajonal duke mbuluar të gjithë tipet e kriminalitetit.¹⁰

III.2. Organizata e Kombeve të Bashkuara

Strategjitë e parandalimit të krimit kanë qenë ndër prioritetet e para të axhendës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e sidomos pas Kongresit të 10-të të Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të shkelësve të ligjit, që u

¹⁰ 2001/427/JHA: Council Decision of 28 May 2001 setting up a European crime prevention network - Official Journal (L153, 08/06/2001 P. 0001 – 0003).

mbajt në Vjenë, në prill 2000. Ato fokusohen në drejtim të parandalimit social dhe atij situacional, duke synuar konkretisht të ulin dëshirën apo prirjen kriminale e luftën ndaj krimit të organizuar. Veprimtaria e parandalimit social në eliminimin e problemeve (si mungesë e kujdesit të duhur prindëror, shëndeti i rëndë mendor e fizik, mosarsimim i duhur) lidhet me ngritjen e marrëdhënieve komunitet - polici lokale, edukimin e të rinjve me ligjin, banesë për të pastrehët dhe programe për viktimat e drogës etj. Kjo ka pasur rezultate shumë të kënaqshme.

Parandalimi situacional i krimit përdor teknologjinë e fundit si nga autoritetet e zbatimit të ligjit ashtu edhe nga sektori privat i sigurisë. Disa qeveri kanë miratuar e financuar projekte situacionale për planëzimin e qyteteve dhe arkitekturën për të parandaluar vjedhjet e banesave, bankave etj. Të tjera janë përqendruar në “pikat e nxehta” të krimit në zonat urbane apo në ndihmën ndaj viktimave, veçanërisht atyre të dhunës në familje etj. Strategjia ka qenë mjaft e suksesshme në parandalimin e një numri të madh krimesh dhe është tashmë pjesë e politikës zyrtare të kontrollit të krimit në shumë vende të Europës si Mbretëri e Bashkuar, Holandë e Francë. Rast për t’u shënuar është viti 1998 kur qeveria britanike bazuar në rezultatet e programeve të suksesshme të parandalimit të krimit, miratoi një akt, i cili bashkoi autoritetet dhe policinë lokale me agjencitë e tjera, përfshirë edhe shërbimet sociale, arsimin dhe autoritetet e drejtësisë në ndërtimin e strategjive të sigurisë së komunitetit.¹¹ Për t’u përmendur janë dhe ngritja e funksionimi i Qendrës për Parandalimin Ndërkombëtar të Krimit dhe rrjetit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale dhe nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara e aderimit në organizma ndërkombëtare¹².

¹¹ Press Kit Backgrounder No. 2 - Published by the United Nations Department of Public Information - DPI/2088/CC February 2000 - Tenth United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders.

¹² United Nations Economic and Social Council, Commission on Crime Prevention and Criminal Justice - Guidelines for the Prevention of Crime - Report on the eleventh session, Official Records 2002, Supplement No. 10 16-25 April 2002, New York, United States of America.

IV. Parandalimi - mision i (pa)mundur?

Sipas studimeve të OKB-së dhe përvojës së vendeve europiane, politikat, strategjitë dhe masat konkrete për parandalimin e krimit kanë qenë shumë të efektshme. Kjo ka nxitur orientimin e këtyre shteteve drejt ndërthurjes së parandalimit si masë kryesore, me luftën ndaj fenomeneve kriminale. Shembull tipik është Mbretëria e Bashkuar, e cila pas suksesit të dukshëm të arritur, miratoi Aktin për Krimin e Trazirat që bashkoi autoritetet lokale, policinë, shërbimet sociale, institucionet arsimore e ato të drejtësisë me qëllim hartimin e strategjive të sigurisë së komunitetit dhe i akordoi masave e politikave parandaluese për një periudhë 3-vjeçare rreth 450 milion dollarë. Po kështu, edhe Franca e Holanda kanë pasur mjaft sukses në zbatimin e strategjive parandaluese të bazuara në teknologjinë moderne.¹³

Në Shqipëri përpjekjet në këtë drejtim mund të thuhet se janë në një fazë sensibilizuese. Baza ligjore për bashkëpunime ndërinstucionale, ndonëse nuk orienton qartazi institucionet e në mënyrë të veçantë ato të zbatimit të ligjit drejt filozofisë dhe praktikës së parandalimit, nuk përbën pengesën kryesore për investime mbarë shoqërore drejt parandalimit të krimit.

Gjatë vitit 2006, me nxitjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në rang kombëtar u realizua thirrja e Komiteteve Vendore të Parandalimit të Krimit nën koordinimin e Prefektëve të Qarqeve në të gjithë vendin. Përpos të tjerave, këto takime me pjesëmarrjen e institucioneve të tilla si drejtues vendor të policisë, drejtuesit e njësisve të qeverisjes vendore, prokurorisë, gjykatave, institucioneve të arsimit dhe agjencive të tjera të ndihmës dhe mbështetjes sociale, përfaqësues të biznesit dhe shoqërisë civile, *mbështetën aktivisht domosdoshmërinë për një nismë legislative për institucionalizimin e tyre si në nivel kombëtar ashtu edhe atë*

¹³ Press Kit - Backgrounder No. 2 - Published by the United Nations Department of Public Information - DPI/2088/CC February 2000 - Tenth United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders.

vendor. Në dallim me çdo nismë tjetër në këtë fushë, komitetet për parandalimin e krimit synojnë të bashkojnë në një strukturë të vetme të gjitha nismat apo komitetet e ndryshme të ngritura apo jo për krime apo çështje të veçanta. Në këtë mënyrë, strukturat vendore apo komiteti kombëtar do të sigurojnë elasticitetin e duhur, duke u përshtatur nevojave dhe problematikave specifike për territore apo periudha të ndryshme kohore.

Parandalimi i krimit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm dhe që kërkon jo vetëm masa konkrete të karakterit teknik që ndikojnë direkt në uljen e kriminalitetit por, ç'është më e rëndësishme, strategji dhe politika parandaluese gjithëpërfshirëse për hartimin dhe zbatimin e të cilave lipset një bashkëpunim dhe bashkërendim i përpjekjeve të të gjitha hallkave të shtetit dhe shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë i policisë dhe strukturave të tjera të mbrojtjes së ligjit, me organet dhe institucionet e ndryshme shtetërore dhe civile.

Nisma ligjore në këtë drejtim ka nisur qysh prej vitit 2003, e në fillimet e saj ka pasur mbështetjen edhe të aktorëve ndërkombëtarë në këtë fushë.¹⁴ Projektligji iu nënshtrua gjatë vitit 2005 edhe procedurave të miratimit për t'iu paraqitur qeverisë. Ky projektligj plotëson legjislacionin shqiptar në këtë drejtim dhe synon rritjen e efektshmërisë dhe rezultate konkrete e afatgjata të punës dhe përpjekjeve parandaluese. Për më tepër, Shqipëria duke hyrë në një fazë të re të stabilizimit social të shoqërisë dhe të integritimit, duhet të heqë dorë gradualisht nga struktura të natyrave emergjente në përballjen me krimin, duke u investuar si shoqëri në qasje sa më pranë nevojave të vendeve të tjera Europaine dhe standardeve integruese. Duke kapërcyer fazën apo nevojat për të luftuar në mënyrë reaguese ndaj krimeve të ndryshme pasi ato ndodhin, institucionet duhet të investohen (ashtu siç diktojnë edhe përvojat ndërkombëtare) drejt parandalimit të krimit të çfarëdo lloji që mund të shfaqet, sot apo në të ardhmen - p.sh., kundër drogës, kundër kultivimit të bimëve narkotike, kundër trafikeve përfshi ato të qenieve njerëzore apo pastrimit të parave të pista, kundër gjakmarrjes apo

¹⁴ Për më shumë informacion mbi disa ide e koncepte të kësaj nisme shih Shtojcën.

hakmarrjes, kundër dhunës ndaj fëmijëve, dhunës ndaj gruas, krimin në familje, vjedhës së banesave apo pronës, vetëvrasjeve apo çdo figure tjetër krimi.

Përvoja e viteve të fundit ku në shumë prej aktiviteteve publike kombëtare për parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike, krahas Ministrit të Brendshëm apo Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë janë shfaqur edhe Ministri i Arsimit, i Bujqësisë dhe Ushqimit, i Ekonomisë apo i Turizmit, i Financës apo i Punës dhe Çështjeve Sociale janë vetëm një tregues i rëndësishëm për politika dhe strategji ndërsektoriale edhe në këtë fushë. Po kështu, dhuna ndaj grave apo trafikimi i fëmijëve kërkojnë jo vetëm bashkërendimin e institucioneve, por edhe të shoqërisë - edukimin, plotësimin e nevojave materiale e jo vetëm - sikundër zhvillimin e strategjive dhe alternativave për zhvillim dhe mirëqenie.

V. Rekomandime

Nga një analizë objektive e situatës aktuale të kriminalitetit në vend dhe e reagimit institucional ndaj tij del i rëndësishëm dhe i ngutshëm rikonceptimi dhe ridimensionimi i përpjekjeve shtetërore e më gjerë për luftën ndaj krimin. Përpjekjet e një shoqërie për parandalimin e krimin asnjëherë nuk janë të mjaftueshme dhe aq më pak të tepërta. Iniciativat për dhënien prioritet parandalimit të fenomenit kriminal në përputhje edhe me politikat e ngjashme europiane e botërore, duhen shoqëruar me ndryshime ligjore pas një konsultimi të gjerë e profesional. Kjo nënkupton njëherësh edhe një ndryshim rrënjësor në qasjen ndaj parandalimit të krimin dhe në vetë dokumentet strategjike dhe politikat që adresojnë (ndër të tjera) këtë fenomen, në përputhje me praktikën e suksesshme botërore dhe udhëzimet e institucioneve të Bashkimit Europian në këtë fushë.

Iniciativa e sipërpërmendur ligjore për parandalimin e krimin dhe krijimi i strukturave të sugjeruara nga kjo iniciativë përbëjnë një domosdoshmëri dhe një investim të rëndësishëm për një të ardhme të sigurt e të qetë të shoqërisë, si edhe për integrimin e vendit në familjen e demokracive perëndimore. Në këtë

kontekst, është thelbësore ndërmarrja e disa hapave të cilët krijojnë premisa të qëndrueshme për suksesin e përpjekjeve shtetërore dhe shoqërore për parandalimin e krimit:

- Zhvillimi i një qasje gjithëpërfshirëse në fushën e parandalimit të krimit që mundëson zgjidhje të qëndrueshme në përputhje me eksperiencat e suksesshme botërore dhe rekomandimet e BE-së.
- Ndërgjegjësimi i autoriteteve shtetërore dhe aktorëve të tjerë të interesuar për domosdoshmërinë e ndryshimit të politikave të parandalimit të krimit dhe të krijimit të një strategjie e strukture unike përgjegjëse.
- Rifreskimi dhe përmirësimi i dokumenteve strategjike (sektorialë e ndërsektorialë) në funksion të ndërlidhjes sa më efikase të tyre me objektivat, strukturat dhe instrumentet e një strategjie të re në parandalimin e krimit.
- Ndërgjegjësimi dhe përfshirja aktive e institucioneve të ndryshme dhe përfaqësuesve të sektorëve të tjerë (privat/civil) të shoqërisë në procesin e hartimit të politikave të parandalimit, të instrumenteve ligjore/nënligjore të implementimit të tyre dhe në vetë zbatimin e masave që synojnë parandalimin e krimit

Në kuadër të këtyre masave, është i rëndësishëm vijimi i konsultimeve gjithëpërfshirëse të draftit të nismës së sipërpërmendur ligjore, përmirësimi eventual në përputhje me aktet e BE-së dhe konkludimi i procedurave parlamentare për miratimin e saj, si edhe të akteve të tjera nënligjore që burojnë nga këto ndryshime në legjislacion. Përfshirja e institucioneve të specializuara dhe me ekspertizën e përvojën e duhur në këtë fushë do të lehtësonte vetë procesin e zbatimit të kësaj qasje të re në parandalimin e krimit, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të rezultateve dhe ndikimit të tyre në jetën sociale të komunitetit.

Shtojcë - Ide mbi nismën ligjore për parandalim

Nisma ligjore për parandalimin e krimit e nisur në vitin 2003 vazhdon të mbetet një iniciativë e cila do të plotësonte në mënyrë më efikase legjislacionin shqiptar dhe përpjekjet për të arritur rezultate konkrete e të qëndrueshme në planin

parandalues. Ky draft-ligj tejkalon kufijtë e masave aktuale të shoqërisë, të cilat në mungesë të një vizioni dhe qasje të strukturuar gjithëpërfshirëse ende vuajnë limitet e emergjencës dhe përkohshmërisë. Disa prej risive dhe koncepteve më thelbësore të kësaj nisme ligjore përfshijnë:¹⁵

- **Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit** - Kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror. Në këtë forum mund të ftohen sipas problematikës edhe Avokati i Popullit, qarqe akademike apo edhe përfaqësues të tjerë publikë apo privatë sipas tematikës në diskutim.
- Kryesimin e **Komiteteve Vendore** nga Prefekti dhe pjesëmarrjen e drejtuesve dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor, drejtues të strukturave vendore të policisë, prokurorisë dhe Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), funksionarë të administratës dhe agjencive vendore, agjenci të zhvillimit ekonomik si dhe ekspertë e përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile etj.
- **Përshtatja** e punës së komiteteve në rang vendor me dinamikën dhe specifikën e kriminalitetit që është e veçantë për secilën zonë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive dhe detyrimeve konkrete të komiteteve bazuar edhe në fenomenet kriminale më të përhapura dhe më problematike për shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Komitetet përshtatin strategji si dhe përcaktojnë objektiva në fushën e parandalimit të krimit edhe në kuadër të angazhimeve të qeverisë për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare.¹⁶

¹⁵ Për një kopje të plotë të projektligjit për parandalimin e krimit si edhe komentet e bëra nga Drejtoria e Kodifikimit mund të kontaktoni pranë zyrave të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

¹⁶ Një pjesë e mprehtë e problematikës, objekt edhe i strategjive që do të hartohen nga Komitetet, janë gjakmarrja, krimi në familje, droga - mbjellja dhe trafikimi, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore e figura të tjera të krimit të organizuar etj.

Caroline Holmqvist

KOMPANITË PRIVATE TË SIGURISË RASTI PËR RREGULLIM

1. HYRJE

Në mars 2003, u vlerësua se 15.000-20.000 kontraktorë privatë të sigurisë punonin në Irak dhe se konflikti u quajt “lufta e parë e privatizuar”. Që atëherë numri dhe shfaqja e personelit të kontraktuar u rrit, çka nxiti një debat të gjerë mbi rolin e kompanive private që ofrojnë shërbime ushtarake e sigurie për shtetet, korporatat dhe OJQ-të. Megjithatë, fenomeni nuk është as i ri dhe as ekskluziv në konfliktin e Irakut. Në dekadën e kaluar u pa ngritja dhe konsolidimi i një industrie globale për shërbimet private të sigurisë me mbi 100 kompani që vepronin në po aq vende në mbarë botën.

Shërbimet private ushtarake e të sigurisë sfiduan pretendimet konvencionale rreth rolit të shtetit si protagonist kryesor në çështjet ushtarake dhe si garantues i sigurisë fizike të shtetasve të tij. Në mungesë të strukturave efektive ligjore apo rregullatore, këto aktivitete ngritën problemet e ligjshmërisë, legjitimitetit dhe përgjegjësisë në fushën e politikës së sigurisë. Ky studim vlerëson ndikimin e “privatizimit të sigurisë” në kontekste të ndryshme të sigurisë dhe ekzaminon disa nga mënyrat e përgjigjes së komunitetit ndërkombëtar ndaj këtij zhvillimi.

Shfaqja e kompanive private të sigurisë

Sipas sociologut Max Weber një karakteristikë përcaktuese e shtetit modern është monopoli mbi mjetet legjitime të dhunës, përfshirë sanksionimin, kontrollin dhe përdorimin e forcës. Megjithëse kjo pikëpamje vazhdon të përforcojë debatin mbi sigurinë ndërkombëtare, ekskluziviteti i shtetit në fushën

ushtarake ka përbërë historikisht një përjashtim. Përdorimi i shërbimeve ushtarake të aktorëve privatë është po aq i vjetër sa dhe lufta vetë.

Ushtritë e lashta që nga ato kineze, greke e romake, shtetet italiane të periudhës së Rilindjes, si dhe shumica e trupave europiane gjatë luftës 30-vjeçare 1618-1648 vareshin gjerësisht nga forcat e kontraktuara. Ngjashmërisht, aktorët privatë kanë luajtur rol gjatë gjithë historisë ushtarake të SHBA-së.

Ngritja e industrisë bashkëkohore private të sigurisë dhe ushtarake filloi në vitet '90 me shfaqjen e kompanive private të sigurisë (KPS) me struktura të qarta korporate. Larmia e kërkesë-ofertës u shoqërua me ngritjen e sferës aktuale të sigurisë, megjithëse tre janë faktorët që përmenden më shpesh: a) dominanca e modeleve të shteteve të tregut të lirë të pas Luftës së Ftohtë, që nxiti daljen jashtë funksioneve tradicionale të qeverisë; b) zvogëlimi global i ushtrive kombëtare, çka i mundësoi ish-personelit të trajnuar ushtarak të rekrutohej nga kompanitë private; c) tërheqja graduale e Fuqive të Mëdha nga pjesa më e madhe e botës në zhvillim.

Ndërkaq, shpjegimet për rritjen e industrisë variojnë sipas konteksteve specifike të sigurisë. Në shtete të dobëta apo në dështim, “privatizimi” është një term i gabuar, pasi konsumatorët i janë drejtuar sektorit privat si pasojë e mungesës së funksionimit të institucioneve publike të sigurisë. Kjo dallon nga situata në shtete të fortë apo eficientë, ku aktorët privatë përdoren si plotësues apo shtesë të funksionimit të institucioneve të shtetit.

Diversiteti i firmave, aktiviteteve dhe klientëve

Mercenarizmi është i paligjshëm sipas Konventës Ndërkombëtare të 1989 kundër Rekrutimit, Përdorimit, Financimit dhe Trajnimit të Mercenarëve dhe Konventës së 1977 të Bashkimit Afrikan (BA) për Eliminimin e Mercenarizmit në Afrikë. Megjithatë, asnjë prej këtyre instrumenteve ligjorë ndërkombëtarë nuk zbatohet për aktivitetet e KPS-ve. Përkufizimet e tyre për mercenarizmin lënë të paqarta parametrat ligjorë për shërbimet private të sigurisë, çka ka penguar analizën e privatizimit të sigurisë dhe

zhvillimin e strukturave të reja ndërkombëtare ligjore e rregullatore.

Shumica e KPS-ve janë me struktura korporate e veprojnë si persona juridikë. Shumë janë pjesë të konglomerateve të mëdha industriale e disa prej tyre nga më të pasurat e botës. Ato bazohen në sistemet e rregullt të financimit dhe zhvendosen lehtësisht në arenën ndërkombëtare. Shërbimet variojnë: mbështetje operationale në luftime, këshillim ushtarak e trajnim, sigurim armatimi, mirëmbajtje e mbështetje logjistike, strehim, komunikim, siguri, mbledhje informacioni e parandalim krimi.

Përpyekjet për kategorizimin më preciz të aktorëve privatë të sektorit të sigurisë kanë qenë shumë të debatueshme. Një dallim ekziston mes kompanive private ushtarake (KPU) dhe atyre të sigurisë (KPS). KPU-të përkufizohen si kompani private që ofrojnë shërbime ofensive, me impakt ushtarak, ndërsa KPS-të shërbime mbrojtëse, me qëllim ruajtjen e personave dhe pronës. Ky dallim është problematik për dy arsye. Së pari, ajo çka quhet “mbrojtëse” në rrethana të caktuara mund të kthehet në “ofensive” në rrethana të tjera. Së dyti, kërkesat situacionale afatshkurtra si dhe mundësitë imediate a afatmesme të biznesit kanë bërë që kompanitë të përvetësojnë funksione e detyra të reja me shpejtësi e lehtësi relative, duke i bërë dallimet ofensive-mbrojtëse apo aktive-pasive të pavenda për të mos thënë çorientues. Ky dokument politikash e shmang dallimin mes “ushtarake” dhe “sigurie” dhe përdor termin “kompani private e sigurisë-KPS” për të paraqitur të gjitha kompanitë brenda industrisë.

Shumë KPS përdorin një fuqi fleksibël punëtore duke mbajtur arkiva të plotë për ish-personelin ushtarak apo të sigurisë, që barazon apo tejkalon numrin e stafit të përhershëm. Rekrutimi i tyre ul kostot pasi nevoja për trajnim paraqitet rrallë. Për çdo mision apo kontratë ato zgjedhin shpejt individë të mjaftueshëm me përvojën e trajnimit e duhur. Arkivat ndonjëherë ndahen mes KPS-ve dhe më shumë se një firmë mund të punësojë të njëjtin individ. KPS-të i ofrojnë klientit avantazhin e fshehtësisë së të dhënave dhe depolitizimin. Ato kontraktohen jo vetëm qeveritë, por dhe organizatat

ndërkombëtare, OJQ-të, agjencitë humanitare, media ndërkombëtare dhe korporatat shumëkombëshe. Larmia e klientëve, që përdorin KPS-të, e komplikon kategorizimin e qartë të industrisë private të sigurisë dhe vlerësimin e efekteve të saj.

Edhe mungesa e informacionit të besueshëm pengon analizimin e privatizimit të shërbimeve të sigurisë. Megjithëse KPS-të veprojnë në një treg të hapur, kërkojnë legjitimitet dhe reklamohen si ndërmarrje profesionale e të besueshme, bota e KPS-ve mbulohet nga një atmosferë sekreti. Duke analizuar madhësinë e kontratave, shpenzimeve buxhetore dhe intervistave me investitorët, vlerësohet se numri i KPS-ve që veprojnë në mbarë botën është disa qindra dhe të ardhurat botërore rreth 100 bilion \$ e që parashikohet të arrijnë në 202 bilion në 2010-ën. Janë pikërisht qëllimi dhe përmasa e industrisë private të sigurisë ato çka e bëjnë atë një forcë të fuqishme në çështjet botërore. Konfuzioni mbi atë se cilat shërbime a kompani përbëjnë industrinë botërore private të sigurisë, sekreti që rrethon këtë punë dhe rritja dhe konsolidimi i industrisë shpjegojnë arsyen pse qarqet akademike e politike kanë qenë të ngadaltë për të njohur dhe për t'iu përgjigjur zhvillimit të saj.

Shërbimet private të sigurisë dhe mjedisi i ri i sigurisë: problem apo mundësi?

Shqetësimet e shpeshta për legjitimitetin e operacioneve të KPS-ve tregojnë ngurrimin për të hequr dorë nga roli i shtetit si ofrues i sigurisë. Ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan është shprehur se “bota mund të mos jetë gati për të privatizuar paqen”. Megjithatë, rrënjët e këtij skepticizmi nuk mund të reduktohen thjesht në mbrojtjen reflektive të fuqisë së shtetit dhe sovranitetit. Shqetësimi rreth një industrie botërore të shërbimeve të sigurisë lidhet në parim me dy probleme legjitimiteti:

Së pari, dominanca e shtetit në marrëdhëniet e sigurisë është sfiduar nga një larmi aktorësh privatë, çka ka ngritur disa çështje të reja. Shteteve iu është dashur të njohin e pranojnë që nuk janë të vetmit aktorë që merren me kërcënimet ndërkombëtare

të sigurisë, si dhe që ndoshta nuk është e frytshme të ruajnë monopolin në këtë fushë. Përballimi i krimit ndërkombëtar, rreziqeve mjedisore apo lulëzimit të armëve të shkatërrimit në masë, kërkon që shtetet të bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare e rajonale dhe me OJQ-të brenda një strukture më të gjerë të menaxhimit të sigurisë. Kjo ka ndodhur pa një ripërkufizim themelor të kapacitetit të shteteve: ata ende gëzojnë rolin drejtues në sistemin ndërkombëtar dhe shihen si i vetmi burim i rregullimit shtrëngues ligjor ndërkombëtar. Sigurisht, në fushën ushtarake shtetet ende ruajnë prerogativën e krijimit dhe gjyqimit të legjitimitetit politik pasi nëse ata marginalizohen në lidhje me këtë, mund të destabilizohet një nga shtyllat tradicionale të menaxhimit të sigurisë dhe kontrolli i përgjithshëm i përdorimit të forcës, çka ndikon jo vetëm tek aktori shtet, por dhe te sistemi ndërkombëtar. Përdorimi i KPS-ve duhet të bëhet brenda strukturave e proceseve të miratuara për të garantuar legjitimitetin dhe përgjegjësinë në çështjet ushtarake. Aktualisht këto struktura mungojnë.

Së dyti, shërbimi privat për funksionet e sektorit të sigurisë qëndron në themel të debatit për reformën e këtij sektori. Në përpjekjen për të mbështetur rolin e shtetit si garantues i sigurisë, çështja se ç'loj shteti do të përkrahet është thelbësore. Funksionimi i institucioneve të sigurisë (ushtarake, policore e informative) quhet shpesh kërkesa minimum për stabilitetin shtetëror. Por kur objektivi zgjerohet për të siguruar shpërndarje të barabartë të sigurisë, kredencialet demokratike të institucioneve të sigurisë, janë themelore. Pranimi se siguria nuk është thjesht të mbrosh shtetin, por gjithashtu të mbrosh shtetasit e tij, është baza për reformën e sektorit të sigurisë. Në këtë kuptim, përdorimi KPS-ve paraqet një sfidë të veçantë. KPS-të janë të depolitizuara dhe më përgjegjëse ndaj aksionarëve se ndaj votuesve e kontributi i tyre në ngritjen e institucioneve demokratike dhe të përgjegjshme të sigurisë është veçanërisht e vështirë.

Shpesh thuhet se përdorimi i KPS-ve është i vetmi opsion i mundshëm. Çdo vlerësim i pasojave të privatizimit duhet të krahasojë alternativat private me standardet e vëna që nuk janë thjesht një vijë ndarëse analitike, por tregojnë dhe pikëpamjen

normative. Përshtatja e KPS-ve me format e reja të menaxhimit ndërkombëtar të sigurisë do të varet nga mundësia e shtrirjes së kapaciteteve të tyre drejt një qëllimi më të lartë afatgjatë që përcaktohet më tepër nga politika sesa nga ekonomia. Kapaciteti i sektorit privat të sigurisë për të qenë një aktor legjitim në skenën ndërkombëtare lidhet me aftësinë e shteteve në menaxhimin e KPS-ve dhe në përshtatjen e tyre me qeverisjen e mirë. Mundësia për shtetet e dobëta dhe jo stabël për shfrytëzimin e aktiviteteve të sektorit privat është i kufizuar, por edhe në shtetet e forta, përdorimi efektiv i KPS-ve mbetet pjesërisht i bllokuar për sa kohë kjo sfidë është e pazgjidhur.

Pasojat e shërbimeve të KPS-ve janë globale dhe përfshijnë një riformulim të premisave bazë të politikave ndërkombëtare të sigurisë. Në këtë kuadër, analiza e bazuar në perspektivën e shteteve të dobët dhe atyre eficientë, pavarësisht dimensioneve të ndryshme të shërbimeve private të sigurisë në to, mund të ndihmojë për t'i dhënë kuptim kësaj çështjeje komplekse.

2. SIGURIA PRIVATE NË SHTETIN E DOBËT

Siguria private si një simptomë e dobësisë së shtetit

KPS-të shoqërohen menjëherë me kontekstin e shteteve të dobëta apo në konflikt, veçanërisht të shteteve afrikane. Edhe pse nuk ka shumë informacion të besueshëm për madhësinë e aktivitetit, KPS-të janë përfshirë drejtpërdrejt në konflikte të ndryshme, pa përmendur dhe një numër tepër të madh KPS-sh që operojnë në mbrojtje të pronës e personave në shtete relativisht të paqta. Përfshirja e tyre në Afrikë, është një shembull i qartë i dobësisë së shtetit dhe dështimit të tij për t'u ofruar siguri fizike shtetasve përmes krijimit të institucioneve të zbatimit të ligjit. Po kështu, dhe milicitë lokale karakterizohen si përgjigje e lirë popullore ndaj pasigurisë. Megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e historisë. Po aq i rëndësishëm për shpjegimin e lulëzimit të KPS-ve është dhe ngritja e strukturave paralele apo “hije” të pushtetit dhe autoriteteve. Klientelizmi politik dhe korrupsioni i policisë e ushtrisë shpesh lidhen dhe përforcohen me struktura

ekonomike shfrytëzimi dhe dominim elitash, duke bërë një shpërndarje të pabarabartë burimesh. Sektori privat i sigurisë ka ruajtur statukuonë e shpërndarjes së pabarabartë të sigurisë në shtetet e dobëta, kjo jo vetëm në Afrikë. Kolumbia, Çeçenia (Rusi) dhe Taxhikistani janë shembuj të tjerë, ku interesi ekonomik në një mjedis të pasigurt përkthehet në rritje të sektorit privat të sigurisë.

Besimi i tepruar te siguria private rrezikon t'i dobësojë edhe më shtetet e dobëta në tri mënyra: a) krijon një imazh fals të sigurisë në një periudhë afatshkurtër; b) çon në një shpërndarje jo të drejtë të sigurisë mes popullsisë; c) mbingarkon krijimin e legjitimitetit dhe institucionet funksionuese të shtetit. Çdo problem trajtohet në vijim.

KPS-të në konflikt: pasojat afatshkurtra - Operacionet e KPS-ve (sidomos në Afrikë) shpesh shpjegohen me shpejtësinë e zhvendosjes dhe të operacioneve që ato ofrojnë. Megjithëse ato krijojnë një iluzion stabiliteti, lënë pas të pazgjidhura problemet themelore. Gjithashtu, shtetet e dobëta dobësohen dhe më shumë kur grupet rebele apo aktorë të tjerë jo shtetërorë pajtojnë KPS-të gjatë konflikteve.

Shkalla në të cilën ndërhyrja afatshkurtër e KPS-ve përmes rritjes së kapaciteteve ushtarake apo përmes pjesëmarrjes direkt në luftime, mund të ketë pasoja mbi zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, është e diskutueshme. Pjesëmarrja në luftime është e rrallë dhe mund të parandalohet me forcimin e ligjeve antimercenarizëm. Megjithatë, një gamë e gjerë shërbimesh sigurie nuk mbulohen nga rregulloret aktuale dhe analiza e pasojave të tyre në konflikte a situata të tjera, është shumë më e komplikuar.

Lokalizimi i sigurisë - Aktivitetet private të sigurisë rrezikojnë të keqësojnë stabilitetin e shteteve të dobëta, duke kontribuar në shpërndarje të lokalizuar dhe jo të drejtë të sigurisë. Në kundërshtim me konceptin e sigurisë si një e mirë publike, e drejtë e të gjithë shtetasve, siguria që vjen nga sulmi dhe abuzimi fizik bëhet e varur nga burimet financiare dhe partnerët privatë. Ngritja e ndërtesave të mbrojtura private nga kompanitë, çon në krijimin e enklavave jonatyrale të sigurisë brenda një ambienti jo stabil. Gjithashtu, dhënia e

sigurisë për segmente e caktuara të shtetit, i jep KPS-ve fuqi të tepruara në shtetet e dobëta.

Mundësia e këtyre shteteve për të përdorur aktorë privatë për të përmirësuar menaxhimin e sigurisë në vend është e kufizuar nga mungesa e ndikimit mbi subjektet që kontraktajnë shërbime private. Krijimi i zonave të sigurta të pavarura në shtete jo stabil dhe prania e KPS-ve keqëson mosmarrëveshjet dhe çon në konflikte. Gjithashtu, përdorimi i KPS-ve nga aktorë të jashtëm mund të përbëjë një demonstrim publik të paaftësisë së shtetit për të ofruar siguri për popullatën e tij.

Mbingarkesa e institucioneve shtetërore - KPS-të ndërkombëtare janë një alternativë ndaj shërbimit publik të sigurisë. Qeveritë mund të tundojnë nga zgjidhjet e shpejta që sjell ndërhyrja e sektorit privat sesa rendimi i buxhetit për ristrukturimin tërësor të ushtrisë e policisë, për luftën e korrupsionit dhe sigurimin e efikasitetit të tyre. KPS-të kanë “avantazhin” e ofrimit vetëm të shërbimit të kërkuar, kurse forcat publike duhet të paguhet edhe kur nuk janë të nevojshme. Gjithashtu, shihet si përfitim kalimi i kostos së sigurisë nga sektori publik tek ai privat. Besimi afatshkurtër te sektori privat mund të ndihmojë arritjen e objektivave imediate të qeverisë, por besimi i tepruar afatgjatë dobëson autoritetin e shtetit. Pa mohuar kapacitetin e KPS-ve për forca të rregullta, duhet treguar kujdes i madh për të mosdëmtuar kontrollin demokratik dhe transparencën e sektorit të sigurisë. Gjithashtu, edhe shqetësimi për përfshirjen e njohurive cilësore të të drejtave të njeriut në trajnimet e forcave të sigurisë është i bazuar.

Premisa e sigurisë private në shtetet e dobëta?

KPS-të që mbështesin operacionet e paqes - Alternativa e KPS-ve ndaj trupave kombëtare në OKB ende qarkullon në disa qarqe. Megjithëse ky zëvendësim është i pamundur e i padëshirueshëm, përdorimi i KPS-ve në mbështetje të operacioneve meriton vëmendje. Në mjedise konfliktit apo pas tij, siguria përftohet nëpërmjet misioneve të mandatuara të paqes për çmobilizimin, çarmatimin dhe riintegrimin e ish-luftëtarëve, si dhe për reformat e sigurisë. Në këtë kontekst,

skepticizmi rreth përdorimit të KPS-ve për detyra të ndërtimit të shtetit mund të zbutet nga shkalla e legjitimitetit politik nëse ato veprojnë me mandatin e OKB-së. Megjithatë, OKB-ja dhe organizatat e tjera nuk kanë struktura të duhura për sigurimin e standardeve të larta të veprimit të KPS-ve e mbi të gjitha të qëndrueshmërisë së operacioneve të tyre afatgjata.

Siguria private dhe agjencitë e ndihmës - KPS-të mund të kontraktohen edhe për mbrojtjen fizike gjatë shpërndarjes së ndihmës humanitare administrimi i të cilës dhe punonjësit e agjencive përkatëse kërcënohen seriozisht, por edhe për këshillim, trajnim, analizë risku etj. Nga ana tjetër, prania e KPS-ve e bën më të “militarizuar” hapësirën humanitare dhe rrit mundësinë e sulmeve ndaj punonjësve humanitarë, të cilët duke ndjekur parimin e paanësisë, ndodhen, gjithashtu, nën presionin e konsiderimit si ndihmës së palëve në konflikt. Megjithatë, problemet kryesore lidhen me vetë elementët e veprimit të KPS-ve: respektimi i standardeve etike, profesionale, politike etj.

Shteti në qendër

Suksesi dhe rreziku i veprimit të KPS-ve në një shtet të dobët lidhet me mungesën e aparatit funksionues të sigurisë publike dhe të institucioneve demokratike e të përgjegjshme të ligjit. Rreziku kur vetë shteti kontraktonte KPS-të, është se ai e bën këtë për një siguri afatshkurtër. Ndërsa kur KPS-të futen në veprim nga një aktor i jashtëm, shteti marginalizohet pasi legjitimiteti kalon në duar të huaja dhe kjo largon shtetin nga sistemi normal i qeverisjes kombëtare e ndërkombëtare. Kur KPS-të veprojnë në territorin e një shteti, ky i fundit duhet të ketë mjete të duhura për të ruajtur ndikimin në operacionet e tyre dhe prania e KPS-ve duhet të ndihmojë në forcimin e tij dhe të shoqërohet me veprime parandaluese e kundërvepruese.

3. SIGURIA PRIVATE DHE SHTETI “EFICENT”

Në shtetet eficiente, ndarja e funksioneve të kujdesit shëndetësor, transportit etj., shtroi rrugën për privatizimin e atyre të sektorit të mbrojtjes, gjë që nisi në Europë. Sot, kjo

është më e dukshme në SHBA, ku që prej vitit '91 në Luftën e Gjirit, ku raporti i trupave amerikane me ato të KPS-ve ishte 50:1 deri në luftën e Irakut 2003, ku ky raport ishte 1:10. Megjithëse kontraktimi i KPS-ve has probleme të shumta edhe në shtete të tilla, duhet pranuar se ai bëhet në një mënyrë më të rregulluar se në shtetet e dobëta.

Sfidat në ndarjen e zbatimit të politikave

Detyrat e KPS-ve (kryesisht amerikane e britanike) në Irak përfshijnë që nga ushqimi e strehimi i trupave, mbrojtja e rafinerive të naftës, objekteve energjetike, të zyrtarëve të lartë e deri te mirëmbajtja e sistemeve të armatimit e rekrutimi e trajnimi i trupave irakiane të sigurisë. Gjithashtu, gjatë luftës doli dhe nevoja e shërbimeve të përkthimit dhe marrjes në pyetje.

Vlerësimi i përdorimit të KPS-ve mund të bëhet sipas kriterëve të aplikuara për ndarjen e funksioneve të tjera të qeverisë. Po në ç'cilësi janë këto shërbime në raport me ato të ofruara nga shteti? Cili është raporti kosto/efektivitet? Cilat janë masat e kontrollit të operacioneve? Këto pyetje duhet të ngrihen sa herë ekzaminohen pasojat e shërbimeve private. Problem është dhe se çështjet janë ndarë apo trajtuar veç nga ajo më kryesorja se si ndikon përdorimi i aktorëve privatë të legjitimiteti politik.

Më poshtë trajtohen katër probleme të përdorimit të KPS-ve në shtetet eficente: a) përcaktimi i mandateve të qarta; b) mungesa e përgjegjësisë së KPS-ve; c) mbikëqyrja dhe kontrolli në një treg të shtrembëruar; d) koordinimi bazë dhe praktik i përpjekjeve mes KPS-ve dhe midis KPS-ve dhe forcave të rregullta.

Rregullat e paqarta të angazhimit dhe mandatet - KPS-të moderne përshtaten dhe i përgjigjen shpejt misionëve e kërkesave të reja me njoftimin më të parë. Por kjo mund të rrisë mungesën e kontrollit mbi natyrën e operacioneve të KPS-ve. Megjithëse dispozitat bazë ekzistojnë, mandatet fillestare për KPS-të nuk detajohen mjaftueshëm apo nuk rifreskohen. Për më tepër, rregullat e angazhimit dhe mandatet e KPS-ve mjugullohet nga interpretimi subjektiv. Pasojat janë

devijimet apo tejkalimet e misioneve private të sigurisë, të cilat janë raportuar shpesh. Megjithatë, në raste të veprimit në zona me pasiguri të madhe, mundet që KPS-të të kenë lirinë për të vendosur vetë ç'aksion të ndërmarrin për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale; fajësimi i tyre për tejkalim mandati mund të quhej i tepruar.

Një angazhim i ndjeshëm i KPS-ve nga shtetet efiçente duhet natyrisht të fillojë me qartësi dhe marrëveshje mbi mandatin dhe qëllimin e tyre të aksionit. Kufijtë e përcaktuar qartë mbi metodat që janë të pranueshme apo jo, përbëjnë premisën bazë për përgjegjësinë e KPS-ve.

Përgjegjësia ligjore - Bërja përgjegjëse sipas ligjit të KPS-ve për veprimet e tyre në situatën e sotme është problematike edhe në shtetet efiçente. Kjo detyrë bie mbi qeverinë e shtetit, ku KPS-ja është regjistruar dhe të atij ku ajo vepron. Në Irak, KPS-të kanë imunitet nga procedimi lokal. Edhe pse teorikisht shteti amë merr përsipër të vejë para përgjegjësisë ligjore KPS-të, deri tani kjo ka qenë hipotetike - madje as në SHBA ku ka pasur shumë kritika për mos realizimin e këtij detyrimi, megjithëse rregullimi i KPS-ve është më i zhvilluar se në shumë shtete të tjera.

Boshllëqet ligjore në kontrollin e aktivitetit të sektorit privat të sigurisë duhet të mbyllen në nivelin ndërkombëtar. Si hap i parë, duhen forcuar ligjet aktuale që normojnë veprimtarinë e kontraktuar mbi bazën e instrumenteve rregullatorë e juridiksioneve të përcaktuar, të punonjësve të KPS-ve jashtë shteteve të tyre.

Përgjegjësia kontraktuale - Vështirësia për bërjen përgjegjëse të firmave të kontraktuara përqendrohet mbi faktin që ato nuk janë aktorë të motivuar nga politika apo tregtia. Si për çdo kontraktim shërbimi, duhet krijuar një nivel i caktuar besimi për përmbushjen e kontratës.

Dështimi i KPS-ve në përmbushjen e kontratës vjen si rezultat i të metave të kompanisë ose të punonjësve të saj. Në rastin e parë, ndryshimi i kushteve për të vepruar (të sigurisë apo financës) mund të ndryshojë mundësinë apo vullnetin e kompanisë për zbatimin e misionit për të cilin është kontraktuar. Me gjithë kujdesin e KPS-ve të mëdha për

reputacionin e tyre, nuk ka asnjë garanci për përmbushje kontrate. Kësaj i shtohet dhe rreziku i moskryerjes së misionit nga punonjësit e tyre, pasi shpesh ata gjenden në situata apo vende ku rrezikshmëria apo rrethanat i tejkalojnë kushtet e kontratës, duke i detyruar të tërhiqen e duke sjellë vështirësi të paparashikueshme. Pra, shqetësimet për rritjen e përdorimit të KPS-ve mes ushtrive të rregullta përqendrohen mbi rrezikun e llojit të situatës që paraqitet.

Gjithashtu, përgjegjësia e KPS-ve komprometohet seriozisht nga cilësia e personelit. P.sh. KPS-të në Irak i kanë mbushur kërkesat për personel me vendas dhe me shtetas të vendeve të treta. Kjo ul përgjegjësinë e tyre në dy aspekte: a) stafi me shtetësi nga vende të treta komplikon procedurat e procedimit në rast përgjegjësie; b) tregu i sigurisë private në Irak tërheq individë me të kaluar të mjegullt për sa i përket të drejtave të njeriut. Dhe shqetësimet për cilësinë e rekrutimit ngrihen jo vetëm nga vëzhguesit e jashtëm, por dhe nga brenda industrisë.

Problemet e transparencës dhe mbikëqyrjes së një terreni të vështirë - Një nga argumentet më të shpeshtë në favor të shërbimeve private të sigurisë e ushtarake është se ato janë gjithnjë opsioni më i lirë. Megjithatë, në këtë industri vihet në pikëpyetje efektiviteti i mbajtjes ulët të kostove, për të cilën nevojitet konkurrencë. Ky treg vuan nga shumë pengesa për kushte perfekte tregu dhe i tillë i ngjan më shumë një tregu të shtrembëruar apo “një terreni të vështirë”. Një pengesë gjendet në natyrën tepër të personalizuar të marrëdhënieve brenda industrisë. Drejtuesit e KPS-ve, shpesh me një përvojë të madhe në ushtritë kombëtare, janë shpesh të lidhur me qeveritë dhe mes tyre. Për më tepër, donacione të mëdha të fushatave politike apo loliste rezultojnë të kenë lidhje me fitimin e kontratave. P.sh. në SHBA vetëm 40% e kontratave të Departamentit të Mbrojtjes 1998-2003 janë bërë me tender të hapur.

Konkurrenca mes KPS-ve e bën transparencën në industri të vështirë për t’u arritur si në procesin e tenderimit ashtu edhe në lidhje me mbikëqyrjen pas lidhjes së kontratës. Industria karakterizohet nga një klimë konfidencialiteti dhe

firmat shpesh i mbajnë sekret kontratat. Për ta komplikuar më tej, ka një prirje të përgjithshme për drejt lidhjes së kontratave të quajtura “furnizim-infinit, cilësi-infinit” apo “kontrata çadër”, ku fiksohet paraprakisht një çmim për të mbuluar një numër e natyrë të papërcaktuar shërbimesh për një periudhë të caktuar, çka mund të sjellë abuzime dhe uljen e nivelit të transparencës në kontraktimin e KPS-ve.

Mbikëqyrja e procesit të kontraktimit komplikohet edhe më tej nga nënkontraktimi mes KPS-ve. Sipas një vlerësimi, SHBA-ja ka lidhur rreth 2.800 kontrata në Irak për më shumë se 11.7 bilion \$, por ka shumë pak ndikim mbi procesin nënkontraktues. Nënkontraktimi çon në një shpërndarje të mëtejshme të autoritetit në zbatimin e politikave dhe e lë “klientin” fillestar me mjete të kufizuara mbikëqyrjeje.

Si përfundim, problemet e mbikëqyrjes në kushtet e një tregu të shtrembëruar mund të shfaqen dhe në shterjen e burimeve të shtetit. Meqë shteti nuk ndikon në rrogat a kushtet e tjera të punësimit në sektorin privat, ai nuk ka leva mbi mundësinë e këtij sektori për të tërhequr individë shumë të trajnuar nga shërbimi shtetëror, sidomos në forcat e operacioneve speciale. Ky shqetësim shihet dhe në SHBA e Britani, ku niveli i këtij “eksodi” i ka detyruar drejtuesit ushtarakë të riformulojnë stimujt financiarë e edukativë për të mbajtur personelin.

Mungesa e koordinimit dhe pengesat praktike - Mbikëqyrja e operacioneve të KPS-ve ndërlikohet më tej nga pengesa praktike të partneritetit efektiv publik-privat. Integrimi i burimeve të ndryshme dhe interesat në një planifikim strategjik afatgjatë janë problem i përgjithshëm edhe për forcat e rregullta. Megjithatë, koordinimi mes forcave të rregullta dhe KPS-ve që veprojnë bashkë ndërlikohet nga ndryshimi i kulturës organizative e madje nga mosbesimi reciprok.

Një pengesë për koordinimin praktik vjen nga identifikimi. Shumë roje sigurie udhëtojnë me makina të zakonshme dhe me rroba civile. Mungesa e rregullave të përcaktuar për identifikimin në terren ngre probleme të mëdha sidomos kur kontraktorët janë të kombësive të ndryshme dhe nuk dallohet, p.sh. nëse janë aleate apo kundërshtarë, çka mund të çojë dhe

incidente të armatosura. Për më tepër, KPS-të ndonjëherë veprojnë të pajisura keq; shpesh u mungojnë hartat, radiot, çka pengon komunikimin e mandej operacionet. Del qartë nevoja e zhvillimit të procedurave formale e të përcaktuara për ndërveprimin praktik mes forcave publike e private si dhe aktorëve të tjerë në terren, sidomos me situatat post-konfliktuale. Këto procedura duhet të konsiderohen me kujdes dhe do të jenë akte të balancimit mes interesave dhe filozofive të ndryshme të punës.

Kush e paguan çmimin e dështimeve të sigurisë private në shtetet eficente?

Kur shteti dështon në zbatimin e politikave të tij, çmimi për besim të tepruar te sektori privat është shumë i lartë në terma praktikë e politikë. Ky çmim rritet kur politikat e tij shtrihen në një vend tjetër. Në këto raste nuk preket thjesht qeveria si palë kontraktuese, por dhe konsumatori i shërbimeve të KPS-ve: popullsia lokale.

Misionet në Afganistan dhe Irak mund të shihen si përpjekje për rivendosjen e kontratave themelore sociale, duke përdorur gjerësisht mjete private. Duke parë shkallën e paprecedent të aktivitetit të KPS-ve, efektet afatgjata mbi zakonet e popullsisë lokale vetëm mund të imagjinohen. Megjithatë, shkalla e suksesit të koalicionit në menaxhimin e partnerëve privatë në këto vende do të jetë një bazë për leksionet që do nxirren e diskutohen në të ardhmen.

Sipas analistëve, ndarja e kaq shumë përgjegjësi rrezikon të shihet si “një përpjekje për krijimin e një distance mes veprimeve të koalicionit dhe pasojave të këtyre veprimeve, mes pushtimit fizik dhe shtrirjes politike të pushtimit”. Megjithëse sjellja e KPS-ve varion, ka rrezik që një punë e lënë përgjysmë të shkaktojë reagim të madh te popullsia.

Ardhja e dhjetëra mijë punonjësve të huaj në Irak do të ketë pasoja në tregun e punës. Meqë KPS-të ndërkombëtare kanë punësuar gjithnjë e më shumë staf lokal për shkak të njohjes së vendit dhe pagave të ulëta, ka një fryrje të punësimit të irakianëve e vështirësi në mbajtjen e të huajve për arsye të koston financiare. Dallohet ndarja në dy nivele e punonjësve

të huaj të mirëpaguar dhe ata të paguar pak nga popullsia lokale, që edhe pse fitojnë shumë më shumë se të punësuarit në shërbimet shtetërore të sigurisë, nuk janë bashkëpunues.

Së fundmi, prania e KPS-ve tërheq inputin lokal nga drejtimi i ndërtimit të institucioneve; p.sh. në Afganistan e Irak rekrutimi i personelit kompetent në polici e ushtri është i vështirë, pasi ata preferojnë të punësohen nga KPS-të e huaja. KPS-të duhet të kenë përgjegjësi ligjore e kontraktuale. Dështimi në këtë pikë do të kishte pasoja të mëdha në zbatimin e politikave duke i dhënë shprehjes “dështim misioni” një kuptim krejt të ri.

4. LUFTA BOTËRORE NDAJ TERRORIZMIT DHE PRIVATIZIMI I SIGURISË

Strategjia antiterrorizëm e SHBA-së dhe tërheqja e sektorit privat të sigurisë

Megjithëse pranohet se lufta botërore antiterror (LBA) ka rritur përdorimin e KPS-ve, natyra specifike e këtyre detyrave dhe efektet e tyre janë analizuar pak. Ndërsa ekspertët nuk bien dakord mbi faktin që terrorizmi i shekullit XX është i ri në mënyrë cilësore e sasiore, është e qartë se problemi është në krye të axhendës ndërkombëtare për të ardhmen. Në vijim do të trajtohet serish përvoja e SHBA-së, por rezultatet kanë vlerë për të gjithë shtetet eficiente.

Dokumenti kryesor që përfshin SHBA-në në LBA - Rishikimi Katërvjeçar i Mbrojtjes së 30 shtatorit 2001 rendit shtatë parime strategjike për arritjen e synimeve politike të mbrojtjes, tre prej të cilave lidhen direkt me rolin e sektorit privat në LBA:

a) Fokusi mbi menaxhimin e riskut - menaxhimi merr parasysh që sfidat ndryshojnë në mënyrë konstante. Kjo përbën një tension themelor mes përgatitjes për rreziqet e të ardhmes dhe trajtimit të kërcënimeve aktuale. Njohja e faktit se disa rreziqe nuk kuptohen është themelore për qasjen e menaxhimit të riskut të politikave të sigurisë dhe e veçon dukshëm atë nga qasjet e mëparshme të bazuara mbi

kërcënimet, çka ngrihej mbi informacionin mbi një kundërshtar të veçantë e të identifikuar. Menaxhimi i riskut vlen për përdorimin e sektorit privat, pasi ai kërkon përgjigjen ndaj rreziqeve me njoftimin më të parë e më pak përgatitje institucionale.

b) Zhvillimi i një qasjeje të bazuar mbi kapacitetet - përforcon tërheqjen e shërbimeve private të sigurisë. Forcimi i kësaj qasjeje është i domosdoshëm, pasi SHBA-ja nuk mund të dijë me siguri se cili aktor (shtet apo jo) do të përbëjë kërcënim për interesat vitale. Kështu, fokusi shkon më shumë mbi mënyrën se si një kundërshtar mund të luftojë, se sa mbi identitetin e kundërshtarit apo vendin e konfrontimit. Kjo qasje mbështetet te “lufta surprizë dhe asimetrike” përballë një kundërshtari të panjohur dhe kërkon rifokusimin e misionit të forcave të armatosura. Nëse sektori privat merr përsipër jo vetëm shumë detyra bazë operacionale, por dhe mbështet një pjesë të madhe të kostove për zhvillimin e teknologjive të reja, atëherë çlirohen burimet për një sektor më të efektshëm të mbrojtjes.

c) Transformimi i ushtrisë amerikane dhe i institucioneve të mbrojtjes - parashikohet “eksperimentimi me qasje të reja të luftës”, koncepte e kapacitete operacionale dhe përtëritje organizative në proceset e Departamentit të Mbrojtjes (DM). Parimi se “vetëm ato funksione që duhet të përmbushen nga DM duhen mbajtur nga ajo”, ka çuar në rritjen e madhe të ndarjes së funksioneve dhe do të vazhdojë dhe në të ardhmen.

Këto tre parime tregojnë arsyet e privatizimit në rritje në kontekstin e LBA-së. Ndërsa perceptimi i ri i kërcënimit hapi dhe theksoi rolet e shumta për sektorin privat dhe për ndërveprimin publik-privat, si p.sh. në kontrollin e financimeve dhe lëvizjeve terroriste, përhapja e teknologjisë dhe mbrojtja e infrastrukturës së rëndësishme. Ky diskutim fokusohet mbi rolin e veçantë të shërbimeve private të inteligjencës në mbështetje të politikës antiterror.

Siguria private dhe mbledhja e informacionit - Strategjitë parandaluese antiterror vënë theksin mbi funksionet e inteligjencës. Pranimi i dështimit të inteligjencës në sulmet e

11 Shtatorit dhe në çuarjen drejt luftës në Irak rinisi debatin për nevojat dhe organizimin e saj. Megjithëse rëndësia e shërbimeve inteligjente në kontekstin e LBA-së pasqyrohet në shumë dokumente të qeverisë së SHBA-së dhe në analiza të pavarura, mënyrat për të gjeneruar shërbime të tilla të duhura, të afta e të besueshme janë kundërshtuar gjerësisht. Shpesh argumentohet se forma tradicionale e agjencive të inteligjencës duhet të zëvendësohet me rrjete fleksibël të decentralizuar të shërbimeve, analistëve dhe përdoruesve publikë e privatë. Kjo tendencë pasqyrohet në aktivitetin më të specializuar informativ të KPS-ve.

Lidhjet e shpeshta të KPS-ve me kompanitë e teknologjisë së informacionit dhe sistemeve elektronike i vendosin aktorët privatë në vendin e duhur për aspektet teknologjike të mbledhjes së informacionit. Realisht, shumë nga shërbimet e rëndësishme private të inteligjencës/sigurisë e kanë nisur fillimisht aktivitetin si kompani telekomunikacioni.

KPS-të përdoren sot për mbledhje informacioni nga satelitët apo sendorët e sofistikuar, përkthimin dhe analizën e rezultateve dhe shpërndarjen e informacionit mes strukturave përkatëse qeveritare. Ato përdoren dhe në fushën e informacionit njerëzor duke përdorur ish-agjentë informativë dhe të terrorizmit elektronik (cyber), duke monitoruar faqet e internetit.

Lulëzimi vitet e fundit i sektorit privat të inteligjencës ka tërhequr dhe vëmendjen e Departamentit Amerikan të Punëve të Brendshme e Sigurisë, i cili ka njoftuar mundësinë e kontraktimit të këtij sektori për kërkime informative dhe specialistë operacionesh për Agjencinë e Emigracionit dhe Doganave.

Legjitimiteti politik në luftën botërore antiterror

Reaksionet e forta emocionale pas sulmeve të 11 Shtatorit nxitën debate të gjera për përcaktimin e synimeve strategjike të LBA-së. SHBA-ja ka treguar angazhimin për t'u marrë me rrënjët e terrorizmit, duke identifikuar veçanërisht problemin e shteteve të dështuara e marrjen e iniciativave të ndryshme. Në nivelin strategjik, politika antiterrorizëm s'mund të

reduktohet në veprimin reagues apo në ndalimin e aksionit terrorist. Mënyra e zbatimit të politikës përmban një peshë të madhe politike.

Përdorimi i sektorit privat e të sigurisë mund të fokusohet vetëm në masa afatshkurtra e afatmesme antiterror. Mbipërqendrimi në këtë aspekt afatshkurtër të problemit mund të përkojë me besimin e tepruar te sektori tregtar për të përçuar një imazh mosangazhimi dhe mosinteresimi në trajtimin e shkaqeve rrënjësore të terrorizmit. Analizat shprehen mbi rrezikun që synimi i strategjisë të mos identifikojë rezultatin më të mirë të mundshëm dhe të mos gjejë për ta arritur atë, por të ruajë sa më shumë opsione të hapura për të rritur fleksibilitetin taktik. Nëse LBA-ja shihet në kontekstin e menaxhimit botëror të sigurisë ku aktorët shtet e privat veprojnë bashkë, përdorimi i KPS-ve duhet përfshirë më qartë në strategjinë politike, duke përdorur kapacitetin e tyre në mënyrë krijuese e brenda një kuadri të fortë normativ.

Më shumë aktorë, më shumë probleme? - Komunikimi jo i duhur ndërinstytucional është vërejtur mes shërbimeve informative britanike dhe amerikane. Lulëzimi i aktorëve privatë në botën informative e vështirëson pamjen dhe mbërritja e informacionit të saktë te palët e duhura dhe përdorimi i duhur i tij bëhet gjithnjë e më i vështirë. Problemet klasike të mbledhjes së informacionit dhe përkthimit duhen rikonsideruar në lidhje me përdorimin e KPS-ve. P.sh. punësimi i shtetasve të huaj nga KPS-të që është problematik, si dhe fakti i predispozitës së të punësuarve për misione informative ndaj axhendave më të gjera të klientëve.

Një memorandum i vitit 2000 i zyrtarëve amerikanë të mbrojtjes argumenton se në nivelin operacional, strategjik e taktik, funksionet informative duhet të përjashtohen nga shërbimet private, pasi rrezikohet siguria kombëtare. Por ato mund të përdoren nga shtete apo konsumatorë të huaj. KPS-të shpesh veprojnë në shumë shtete, u shërbejnë disa klientëve njëherësh me shtetësi e interesa të ndryshme. Përdorimi i tyre në sektorin e inteligjencës nënkupton hyrjen e një “protagonisti” të ri në politikën e sigurisë. Të gjithë aspektet e mbledhjes së informacionit kërkojnë përkthim dhe kur kjo

kryhet nga aktorë që nuk kanë përgjegjësi para votuesve apo institucioneve demokratike, por para aksionarëve, ka arsye për t'u shqetësuar.

Humbja e kompetencës? - Humbja e kompetencës në fushën e mbledhjes së informacionit dëmton potencialisht varësinë e sektorit privat. Nga perspektiva e vetë firmave, shprehet qartë tundimi për të rekrutuar direkt nga agjencitë qeveritare persona tërësisht të trajnuar, që njohin funksionimin e shërbimeve informative publike dhe kanë informacionin e duhur.

Megjithatë, sektori privat në këtë fushë jep mundësi pozitive në kuadrin e menaxhimit të riskut. Me burime të pakta e mungesë kompetence në gjuhët e huaja, bota informative duhet të gjejë shpejt mënyrat e rritjes së kapacitetit. Aktorët privatë (jo vetëm KPS-të) që veprojnë në zona jo stabilë dhe të ndjeshme politike, kanë shumë informacion mbi situatën dhe ngjarjet në terren, çka mund të jetë shumë e vlefshme për qeveritë. Duket se sektori privat informativ vepron në një vakum, me rreziqet e shpërdorimit të informacionit dhe të mos dhënies së tij palëve të duhura. Një strukturë e re për ndërveprimin publik-privat në këtë fushë duhet të shfrytëzojë këtë potencial, duke shmangur problemet e mësipërme.

Nëse informacioni nuk integrohet siç duhet apo bie në duar të gabuara, pasojat do ta dëmtojnë shumë sigurinë. Tërheqja e KPS-vë në një strukturë më të qartë e më të fortë të menaxhimit të sigurisë kërkon që përdorimi i tyre të bëhet në mënyrë të hapur, transparente dhe me përgjegjësitë përkatëse. Çdo vendim për ndarje funksionesh duhet të balancojë vlerat potenciale pozitive me ato negative që vijnë nga përdorimi i KPS-ve. Analistët përdorin shprehjen “të kesh mundësinë për të privatizuar nuk do të thotë se kjo duhet bërë”.

5. REAGIMI NDËRKOMBËTAR, RAJONAL DHE KOMBËTAR

Kritikët e shërbimeve të KPS-ve argumentojnë se rregullimi i industrisë do t'i jepte legjitimitet të tepërt. Ata mbrojnë idenë e ndalimit tërësor të KPS-ve dhe rishtetëzimin e shërbimeve

të sigurisë e ushtarake. Por kërkesë-oferta e shërbimeve të KPS-ve në botë tregon se ky ndalim është jorealit: kjo do të që e pamundur dhe madje mund t'i kundërviejë qëllimit për transparencë dhe përgjegjësi më të madhe të sektorit. Dhe për më tepër, do të që dhe e padëshirueshme. Kjo industri është një fakt dhe shmangia nga përfshirja e saj do të që humbja e një burimi të vlefshëm.

Analistë të tjerë argumentojnë se dora e padukshme e tregut do të sigurojë një ndërsim informal për sjelljen “e keqe” të sigurisë private, çka e bën rregullimin të panevojshëm. Por kjo është e pabazuar pasi tregu deri tani nuk ka mjaftuar për të dekurajuar sjelljen mashtruese të firmave, por dhe po ta bënte, ai nuk do të mund të trajtonte çështjet e mëdha të përgjegjësisë. Reagimet realiste ndaj rritjes së kësaj industrie duhen gjetur në nivele të ndërmjetme dhe lufta e Irakut përshpejtoi nxitjen për rregullim.

Problemet, interesat dhe opsionet

Pasojat e besimit të ky sektor varen nga natyra e shtetit që kontraktin KPS-të dhe mjedisi strategjik ku ato përdoren. Tre probleme kryesore shtrohen: a) përgjegjësia - pa përgjegjësi penale të kontraktorëve, përdorimi i KPS-ve do vazhdojë të shihet me dyshim; b) legjitimiteti - nëse KPS-të marrin pjesë aktive në ndërtimin e menaxhimit të sigurisë, ato duhen parë si aktorë legjitimë nga aktorët e tjerë shtetërorë e joshtetërorë, si dhe nga popullsia. Legjitimiteti varet dhe nga nivelet e duhura të transparencës dhe standardeve demokratike në lidhje me operacionet, financat dhe sjelljen e kompanive; c) duhen trajtuar pengesat praktike ndaj veprimeve efektive të KPS-ve dhe duhen zhvilluar sistemet për ndërveprimin publik-privat në nivel ndërkombëtar. Kjo kërkon që KPS-të të mos i shpenzojnë shtetet, por të punojnë me ta, si dhe me organizatat ndërkombëtare e rajonale, OJQ-të dhe aktorët e tjerë joshtetërorë.

Duhet balancuar një larmi interesash në mënyrë që përdorimi i sigurisë private të jetë efektiv dhe i drejtë. Fillimisht, interesat kryesore, ata të shteteve pritëse (ku vepron KPS-ja) dhe të popullsisë së tij duhen marrë parasysh. Kjo

veçanërisht në shtete të dobëta. Së dyti, shteti amë (i origjinës së KPS-së) duhet të ketë ndikim mbi vendin e mënyrën e veprimit të KPS-së dhe kontraktorin e saj. Së treti, vetë KPS-të duhet të kuptojnë rëndësinë e masave rregullatore e ligjore që shpërblejnë sjelljen e mirë e ndëshkojnë abuziven. Rregullimi mund të ketë efekt praktik e normativ vetëm duke marrë parasysh interesat e të gjitha palëve.

Konceptohen dy tipa reagimi ndaj privatizimit: ligjore e rregullatore që do vepronin në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar. Kuadrot ligjore kanë përparësi për shkak të mundësisë për ndëshkim dhe që kanë qenë me efekt ndalues. Ndërsa kuadrot rregullatore nuk kanë qenë shtrëngues dhe janë kryesisht parandalues me qasje gjithëpërfshirëse të industrisë dhe inkurajues të praktikës së mirë. Në formulimin e reagimeve ndaj aktivitetit të KPS-ve, duhet t'i jepet rëndësi raportit të ligjeve të “butë” dhe të “fortë” dhe zhvillimi i normave e kodeve në lidhje me korporatat shumëkombëshe. Masat e ndryshme të reagimit do të shenjestrojnë privatizimin e sigurisë nga drejtime të ndryshme - nga shenjestrimi i vetë kompanive a punonjësve të tyre tek e ardhmja e klientëve aktualë të KPS-ve. Këto dy anë janë komplementare: KPS-të duhet të veprojnë sipas disa standardeve, por i duhet dhënë rëndësi dhe rrethanave e kushteve të kontraktimit të tyre. Natyra e copëzuar e industrisë dhe larmia e klientëve e bëjnë të pamundur kapjen e gjithë aktiviteteve të sigurisë private nga një instrument i vetëm. Kombinimi i mekanizmave nxitëse mund të sigurojë një rrjet strukturash rregulluese që mundet të kapin një pjesë të madhe të shërbimeve private të sigurisë e ushtrisë.

Papërshtatshmëria e instrumenteve ndërkombëtare ligjore

Bazuar në natyrën ndërkombëtare të KPS-ve, fushat e veprimit dhe efektet e privatizimit të sigurisë, rezultojnë se trajtimi i këtij privatizimi në nivel ndërkombëtar ka përfitime të dukshme. Dokumentet më të cituar në këtë fushë janë konventat e OKB-së dhe BA-së mbi aktivitetin mercenar. Asnjë prej konventave nuk është i zbatueshëm për KPS-të moderne e as kur ato kontraktohen për luftime në konflikte

të armatosura. Kjo, pasi p.sh. Konventa e OKB-së mori 12 vjet deri në ratifikimin nga minimumi i kërkuar prej 22 shtetesh e hyrjen në fuqi dhe asnjë nga fuqitë perëndimore nuk e ka firmosur.

Ripërkufizimi i “mercenarëve” në këto konventa për të përfshirë dhe kontraktohet privatë nuk mund të jetë efektive në lehtësimin e pasojave të mëdha të shërbimeve të KPS-ve. Së pari, ka probleme të qenësishme përkufizimi. Dallimi mes detyrave “luftarake” e “jo luftarake” është i papërfillshëm dhe ndalimi i aktivitetit të mirëfilltë “mercenar” mund të shihet si kontradiktor dhe hipokrit, pasi nuk do të trajtonte trajnimin, këshillimin strategjik dhe mbështetjen operacionale që janë qendrore në misionet ushtarake dhe në rezultatin e konfliktit. Edhe zëvendësimi i trupave të rregullta nga KPS-të në luftime është i rrallë, prandaj ky ndalim do të trajtonte vetëm një segment shumë të vogël të aktivitetit privat. Së dyti, nga praktika, marrëveshja mes shteteve për ndryshimin e legjislacionit ndërkombëtar ecën ngadalë dhe ky legjislacion është tmerrësisht i vështirë për t’u zbatuar. Shkelja e ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut apo humanitarë nga kontraktorët individualë mund të gjykohej në gjykatat ndërkombëtare (si p.sh. ajo penale), reagimet efektive ndaj KPS-ve duhen drejtuar, gjithashtu, në nivel kompanie.

Dështimi i përcaktimit të saktë të statusit ligjor të KPS-ve në ligjin ndërkombëtar, si dhe shpresat e pakta për ndryshimin dhe zbatimin e frytshëm të tij, e bën ligjin kombëtar një mënyrë më efektive. Megjithatë, duhen marrë në konsideratë në nivel ndërkombëtar dhe instrumentet që janë më shumë rregullatore sesa detyrues e ligjor.

Qasja e OKB-së ndaj KPS-ve dhe e ardhmja për një strukturë ndërkombëtare rregullatore

OKB-ja është aktori parësor përgjegjës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë. Pozicioni i qartë i saj mbi çështjen e KPS-ve do të kishte një peshë të madhe normative edhe pse jo forcë ligjore. Si autoriteti më i lartë botëror, roli i saj si promovues i normave nuk mund të teprohet. Megjithatë, organizata duhet t’i përgjigjet realitetit të ri dhe shtrirjes së sigurisë private

ndërkombëtare. Fillimisht, OKB-ja mund të trajtonte çështjen e përdorimit gjerësisht nga vetë ajo të KPS-ve për mbështetjen e operacioneve të paqes dhe dokumenti ynë tregon se ky përdorim nga një organizatë legjitime ndërkombëtare është një mënyrë e frytshme e përfitimit nga burimet e sektorit privat. Por standardet kanë rëndësi, pasi, meqë OKB-ja i jep legjitimitet aktorëve privatë, mungesa e përgjegjësisë së KPS-ve mund të ndikojë keq te vetë ajo.

OKB-ja duhet të zhvillojë e bëjë publike standardet, që duhet të përmbushin KPS-të për të kontraktuar me të. Mbështetja e tyre për operacionet e paqes duhet të jetë e hapur dhe transparente. Fillimisht, mund të bëhet publike një listë e kompanive të kontraktuara nga ajo me specifikime mbi detyrat, mandatet, rregullat e angazhimit, madhësinë e kontratës dhe zonën e veprimit, çka do të bënte publik shqyrtimin e tyre dhe do të sfidonte parimin e “konfidencialitetit të klientit”, që mbizotëron aktualisht në industri dhe që bllokoi diskutimin mbi sjelljen e KPS-ve dhe operacionin. Standardet e kontraktimit duhen shqyrtuar me kujdes, por minimalisht duhet të pajtohen me ligjin ndërkombëtar humanitar, respektin e pakushtëzuar të të drejtave të njeriut, sigurimin e përgjegjësisë e transparencës, trajnimin e stafit dhe përdorimin e KPS-ve të regjistruara që do t’i binte ato më afër një sistemi të menaxhimit të sigurisë ndërkombëtare.

Rishikimi i KPS-ve nga OKB-ja duhet të jetë dhe një bazë për zhvillimin e rregullimit ndërkombëtar të tyre kur ato kontraktohen nga palë të tjera. Ka sugjerime për krijimin e një strukture rregullatore për kontraktimin ndërkombëtar të KPS-ve nën autoritetin e OKB-së që do të regjistronte ato që përmbushin standardet dhe do t’u jepte një shkallë legjitimiteti, çka do u mundësonte klientëve të tjerë të përzgjidhnin më mirë para kontraktimit. Mundësi tjetër e OKB-së mund të ishte dhe kapaciteti kontrollues nëpërmjet verifikimit të standardeve të sjelljes së KPS-ve apo kontratave. Kjo pavarësisht kostos, do të përballte diferencat në mjedisin ligjor për rregullimin në juridiksione të ndryshme dhe do jepte siguri për veprimin shtetëror në zbatim të ligjit në rast abuzimesh.

Vetërregullimi: industria dhe klientët e saj ndërkombëtarë jo shtetërorë

Mënyrë tjetër e mundshme e rregullimit të industrisë në nivel ndërkombëtar janë dhe marrëveshjet, të cilat nuk do të kenë forcë ligjore, por zbatim vullnetar. Vetërregullimi do të diktojë formulimin e kodeve të sjelljes me standarde për t'u përmbushur nga KPS-të gjatë kontraktimit. Kështu, klientët do të ishin të informuar për sjelljen e KPS-ve përpara zgjedhjes së kompanisë konkrete dhe shërbimeve të tyre.

Vetë KPS-të, të motivuar nga prestigji a reputacioni, mund të hartojnë kode të tilla sjelljeje, si p.sh. iniciativa e Shoqatës së Operacioneve Ndërkombëtare të Paqes (SHONP), që ka anëtarë 12 KPS. Projekt-Parimet e Sjelljes së SHONP-it trajtojnë disa nga çështjet më të rëndësishme të veprimit të KPS-ve, si: standardet e të drejtave të njeriut, transparencën, përgjegjësinë, klientët e pranueshëm, sigurinë, mbrojtjen, shëndetin e cilësinë e punonjësve, rregullat e angazhimit, kontrollin e armëve (me leje). Janë hartuar edhe "standardet e kërkesat minimale të trajnimit për profesionistët e sigurisë private. Megjithëse duan diskutim më të gjerë e përmirësim, këto projekte janë për t'u lavdëruar si një hap i parë drejt vetërregullimit të industrisë. Për të motivuar KPS-të drejt vetërregullimit duhet marrë parasysh pozita normative e skemës. Miratimi i kodeve për sjelljen e kësaj industrie nga aktorë të jashtëm mund të rrisë prestigjin. Kjo është një nga të metat më të mëdha të Parimeve të SHONP-it: mos sanksionimi nga shtetet apo organizatat ndërkombëtare i bën një instrument shumë të dobët. Pak KPS kanë kode sjelljeje e etikë, shpesh të paqartë dhe në nivel kompanie e jo industrie.

Një mënyrë më e plotë qasjeje e vetërregullimit janë modelet me objektiv aktorët e industrisë e detyrues për shtetin. Rregullimi industrisë me pëlqimin e shteteve, duke zbatuar legjislacionin kombëtar do të kishte avantazhin e përfshirjes së më shumë aktorëve dhe rritjes së prestigjit. Hartimi i direktivave të ndryshme ka qenë sidomos i vlefshëm pas takimeve të shumta ndërkombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisë, industrisë, OJQ-ve etj., e pas rishikimeve periodike.

Vetërregullimi mund të bëhet dhe nga klientët ndërkombëtarë të KPS-ve - korporatat e OJQ-të. Shënohet vetëm një përpjekje e tillë: iniciativa e qeverive amerikane, britanike e holandeze për marrëveshjen e 2000-shit mbi Parimet Vullnetare për Sigurinë e të Drejtat e Njeriut mbi menaxhimin e përdorimit të korporatave të KPS-ve në industrinë nxjerrëse e energjetike, që u firmos nga qeveritë, korporatat e OJQ-të e interesuara. Por këto Parime dobësohen nga përcaktimi tolerant i kushteve e rrethanave për përdorimin e KPS-ve dhe nga mungesa e mekanizmave të monitorimit. Përdorimi i paktë në literaturë tregon se ato kanë dhënë një ndikim të dobët dhe natyrë të ndarë të debatit. Megjithatë, nëse Parimet përmirësohen e shqyrtohen nga një audiencë më e madhe, mund të jenë një mënyrë e mirë për të trajtuar përdorimin e KPS-ve nga korporatat dhe duhet parë mundësia që ato të futen si klauzolë në kontratat përkatëse.

Një variant final për vetërregullimin do të qe hartimi i kodeve për ndihmën humanitare në përdorimin e KPS-ve nga OJQ-të. OJQ-të kanë nguruar t'i përdorin KPS-të, por tani shumë aktorë janë zgjuar dhe zhurma e debatit është shuar pjesërisht duke u investuar në përmbushjen e standardeve nga ana e KPS-ve, në ngritjen e arkivave me informacion mbi to apo rrjeteve e forumeve, megjithëse progresi praktik është i vogël.

Kostot dhe përfitimet e vetërregullimit

Mekanizmat për vetërregullim nuk mund të jenë ekskluzive, konfliktuale apo dubluese, por veçse përforcuese, në mënyrë që shtetet të punojnë drejt konsensusit në përdorimin e KPS-ve. Format e rregullimit duhet të synojnë perfeksionimin e industrisë.

Në kushte ideale, vetërregullimi do të thotë dalje nga biznesi i KPS-ve që s'përmbushin normat e miratuara dhe shmangie ndërkombëtare e klientëve që i kontraktajnë ato. Megjithëse vetërregullimi lë jashtë përgjegjësinë ligjore, ai mund të rrisë legjitimitetin e KPS-ve dhe bërjen e tyre publike. Por, fokusimi te KPS-të apo në sjelljen e korporatave dhe OJQ-ve në kontraktimin e KPS-ve mund të shihet si marginalizim i

mëtejshëm i shtetit si aktori kryesor i sigurisë - duke pranuar se aktorët jo shtetërorë ndërkombëtarë duhet të sigurojnë sigurinë e tyre në një mënyrë a një tjetër. Kjo qasje ka kufij dhe duhet të plotësohet nga veprimi i shtetit dhe legjislacioni. Për më tepër, ngre një shqetësim të madh për koston e rregullimit mbi vetë aktorët dhe për faktin se bëhet një alternativë ndaj zhvillimit të instrumenteve detyrues ligjorë.

Legjislacioni ekzistues kombëtar: modele për replika?

Arsyet për trajtimin e rregullimit përmes ligjit kombëtar janë dyfishe: a) perspektiva pohon rolin qendror të shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare të sigurisë. Nëse shtetet eficiente do të eksportojnë siguri, duhet të sigurojnë përgjegjësinë e veprimeve të KPS-ve në nivel po ndërkombëtar. KPS-të shihen si zgjatime të politikës së jashtme të shtetit, prandaj është në interes të shteteve të rregullojnë aktivitetin e firmave të regjistruara në territorin e tyre; b) legjislacioni kombëtar është më i mundshmi për zbatim. Përveç SHBA-së, Afrikës së Jugut e pak të tjerëve që kanë ligje mbi industrinë private të sigurisë, ligjet kombëtare e injorojnë ekzistencën e kësaj industrie.

SHBA-ja - pjesa kyç e legjislacionit bazohet te lidhja mes eksportit të armëve e atij të shërbimeve të KPS-ve pas një procedure të përcaktuar licencimi. Kontrolli pas kontraktimit është i dobët për shkak të minimumit për t'u deklaruar në Kongres (50 milion \$), të copëzimit të kontratës dhe nënkontraktimit. Një normë e re është miratuar nga autoritetet, duke i dhënë komandantëve në luftime të drejtën e dhënies së lejes së armëve KPS-ve dhe personelit të tyre. Me gjithë mangësitë, sistemi amerikan jep një model të përshtatshëm. Mësime duhen nxjerrë nga problemet e kontrollit pas kontraktimit dhe të përgjegjësisë kur një KPS kontraktohet direkt nga një klient i huaj.

Afrika e Jugut - Akti i Ndhmës së Huaj Ushtarake, maj '98, ndalon aktivitetin mercenar dhe rregullon ndihmën ushtarake jashtë shtetit, duke sanksionuar marrjen e lejes nga KPS-të për çdo lloj të saj nga një Komitet Kombëtar para kontraktimit. Megjithëse është modeli më strikt i legjislacionit kombëtar, qeveria synon zgjerimin e tij, çka mund të sjellë

ndalimin e eksportimit të shërbimeve të KPS-ve në zona lufte. Por të dhënat për zbatimin e këtij legjislacioni janë të pakta. Ky ndalim ka probleme me të drejtat kushtetuese dhe mund të jetë i padëshirueshëm. Diskutimet janë të vlefshme pasi pranojnë pandashmërinë e sektorit privat dhe kotësinë e vijave ndarëse mes shërbimeve “ofensive” e “mbrojtëse”.

Sugjerimet britanike dhe opsionet e tjera për kontrollin kombëtar - Britania nuk ka ligj mbi KPS-të. Në 2002 qeveria nxori një Dokument Jeshil me opsione për rregullimin e industrisë, por që nuk ka çuar në ndryshime ligjore. Ai propozon ndalimin e aktivitetit të KPS-ve jashtë shtetit, konsideron vetërregullimin dhe jep tri skema licencimi për eksportin e shërbimeve private: a) aktivitetet dhe kriteret do përcaktohen në ligj si dhe ato të eksportit të armëve - është më efektiv dhe lejon vlerësimin kontratë pas kontrate; b) regjistrimi e njoftimi i qeverisë për kontratat e KPS-ve, çka ul ndërhyrjen e shtetit në industri e mbron interesat britanike e politikën e jashtme; c) një licencë e përgjithshme për një listë të detajuar aktivitetesh. Por gjithë opsionet kanë probleme në lidhje me kontrollin e monitorimin që janë të kushtueshëm dhe duhen trajtuar në nivel kombëtar.

Një vendim i qeverisë britanike mbi çështjen e legjislacionit do të që me ndikim dhe një shembull për shtetet europiane e vetë BE-në. Në analogji të lidhjes mes kontrollit të eksportit të armëve dhe të shërbimeve të KPS-ve, propozohet shtrirja e ligjeve mbi KPS-të që veprojnë brenda vendit dhe tek eksportimi i tyre, çka vlen për rekrutimin e trajnimit e stafit, porse përbën veçse një bazë të pamjaftueshme ligjore kur flitet për sjelljen, pasojat dhe gamën e gjerë të aktiviteteve të KPS-ve ndërkombëtare.

Mangësitë e legjislacionit kombëtar - Legjislacioni për KPS-të në nivel kombëtar është më efektiv dhe më i zbatueshmi, por është i pamjaftueshëm për trajtimin e aktivitetit privat për tri arsye: a) aftësia e KPS-ve për t’iu shmangur ligjit; b) problemi i zbatimit ekstraterritorial; c) mungesa e mekanizmave të duhur për mbikëqyrjen e KPS-ve që veprojnë jashtë shtetit. Natyra transnacionale e KPS-ve nënkupton që ato mund të reregjistrohen në shtete të tjerë me më pak apo

fare pa kontroll. Problem është dhe leverdia e mjaftueshme e këtyre shërbimeve në shtetin ku ato kryhen, çka kërkon njohje dhe ndjeshmëri të lartë ndaj kushteve lokale. Legjislacioni kombëtar duhet të plotësohet me masa të tjera, si vetërregullimi etj., dhe duhet të harmonizohet në nivel rajonal duke krijuar një regjim të sigurisë private që ndan një treg të vetëm për zhvillimin e këtij sektori, për politika e plane të përbashkëta veprimi në fushën e sigurisë së jashtme.

Rregullimi në nivel rajonal

Rregullimi nga organizatat rajonale si BA-ja dhe BE-ja, mund të zgjerojë qëllimin dhe mbështetjen. BA-ja mund të japë një kuadër të vlefshëm reagimi ndaj zhvillimit të industrisë ndërkombëtare të KPS-ve, pasi aktiviteti i tyre i madh në Afrikë është i paneglizhueshëm, me kontraktime nga aktorë të huaj si qeveri e korporata, çka kërkon ndërhyrjen e saj për ruajtjen e interesave të shteteve të dobëta në kuadër të reformës së këtij sektori dhe pasi përdorimi i KPS-ve në operacionet e paqes kërkon një rishikim të aktivitetit të tyre. Një hap i parë mund të ishte përcaktimi i standardeve minimum për KPS-të që do të konsiderohen dhe për kontratat. Mekanizmat rregullatore të miratuara nga shtetet afrikane edhe pse jo me forcë ligjore, do të kenë legjitimitet shtesë e do të japin perspektivën e nevojshme të shteteve të dobëta.

BE-ja ka një kapacitet shumë të fortë institucional dhe trajtimi i rregullimit të KPS-ve në kontekstin e saj është një çështje interesante krahas dhe pranisë së KPS-ve britanike dhe europiane në vendet e BE-së. Rregullimi i sistemeve ekonomike e qeverisë përfshirë dhe sektorin privat, është pjesë e kompetencës themelore të BE-së. Zgjerimi dhe theksimi i politikës së jashtme e menaxhimit të krizave, me mbështetjen e OKB-së dhe partneritetin e grupeve të tjera rajonale, tregojnë se trajtimi i kësaj çështjeje është urgjent. Nëse BE-ja do të zbatonte me sukses një skemë rregullatore për shërbimet e KPS-ve të territorit të saj, kjo do të zgjidhte një pjesë të madhe të problemit të industrisë ndërkombëtare të tyre dhe do të vinte një precedent të vlefshëm për të tjerët. Megjithëse ky treg nuk përmendet shprehimisht në Traktatin e Komunitetit European

të '57-ës, ai trajtohet në mënyra të ndryshme: a) Aktet e BE-së për kontrollin e eksportit të armëve shtrihen dhe rregullojnë dhe shërbimet që përkojnë me ato të KPS-ve. Rregullohet dhe eksporti i mallrave për përdorim ushtarak e civil në mënyrë që tregu civil të mos minojë interesat e sigurisë së shteteve anëtare; b) rregullimi ad-hoc, i përkohshëm dhe specifik sipas shteteve i aktiviteteve të KPS-ve sipas Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë; c) mundësia e trajtimit të KPS-ve nga BE-ja përmes harmonizimit të ligjeve kombëtare për policinë private sipas Tregut të Brendshëm. Si dhe për OKB-në dhe BA-në, BE-ja duhet të qartësojë rrethanat dhe kushtet e kontraktimit të KPS-ve dhe të sigurojë standardet më të larta të përgjegjësisë, transparencës, respektit të të drejtave të njeriut dhe kujdesit për natyrën delikate të marrëdhënieve ndërkombëtare të sigurisë.

BE-ja mund të konsiderojë përdorimin e KPS-ve në shumë raste: mbështetje në menaxhimin e krizave, operacione të ndihmës humanitare dhe mbrojtjen e përfaqësuesve e delegacioneve diplomatike jashtë saj. Çdo perspektivë për legjislacionin e BE-së duhet koordinuar me masat e kontrollit në SHBA si një hap drejt konsensusit ndërkombëtar mbi përdorimin e KPS-ve, duhet diskutuar me BA-në në kontekstin e mbështetjes së proceseve paqeruajtëse e të ndërtimit të sigurisë në Afrikë dhe me proceset e tjera të dialogut kombëtar e rajonal të BE-së. Këto perspektiva nuk kanë pasur vëmendjen e duhur, çka duhet ndryshuar: kapaciteti i shkëlqyer i BE-së dhe roli i saj si promovuese e normave ndërkombëtare e bën të mirëpozicionuar për të nxitur krijimin e një regjimi model rajonal të praktikës së mirë. Rregullimi i KPS-ve në kuadrin e BE-së nënvizon nevojën për dialog dhe koordinim mes Departamentit të Drejtësisë e Punëve të Brendshme të BE-së dhe Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë në përgjithësi.

6. KONKLUZIONE: KUFIJTË E RREGULLIMIT

Fillimi i këtij dokumenti parashtron njohjen e ekzistencës së industrisë dhe nevojën për të. Mbi këtë bazë bëhet thirrje për një mendim më koherent e të orientuar dhe jepen opsione

për rregullimin e saj si një hap tjetër pragmatik.

Probleme të rëndësishme dalin nga përdorimi i KPS-ve e që nuk mund të trajtohen nga rregullimi. Edhe nëse proceset e kontraktimit të KPS-ve do të formalizoheshin (p.sh. tenderët e hapur) dhe nëse do rregullohej se kush dhe ku do t'i kontraktonte e se si KPS-të do ofronin shërbimet (standarde të duhura rekrutimi, të drejtash njerëzore e ndëshkimi të shkeljeve), ende ka humbje të mëdha kur KPS-të i kryejnë këto shërbime në këtë zonë të ndjeshme të politikës. Këto humbje kryesisht të pakuptueshme janë: humbja e njohjes së kushteve lokale nga donatori dhe i marrëdhënieve mes tij dhe përfituesit (si në rastet e trajnimit); humbje e autoritetit dhe prestigjit; dobësim i angazhimit afatgjatë dhe qëndrueshmërisë së marrëdhënieve ushtarake e të sigurisë. Marrëdhëniet e gjata mes donatorit e përfituesit duhet të jenë politike e personale dhe të mos zëvendësohen nga aktorë të panjohur privatë apo të reduktohen në çështje “menaxhimi”. KPS-të mund të kontribuojnë në çuarjen përpara të këtyre lidhjeve nëse ato afrohen në një marrëdhënie të ngushtë e formale me qeveritë, duke i bërë ato një “strukturë gati qeveritare”. Kjo ka pak gjasa të ndodhë në një shkallë të madhe, pasi do të komprometonte pavarësinë dhe fleksibilitetin e KPS-ve dhe pikëpamja reale e përdorimit të sektorit privat do të humbiste.

Këto probleme janë më endemike ndaj stilit të veprimit të aktorëve privatë sesa të atyre publikë në sferën e sigurisë dhe rrezikojnë kontrollin mbi dimensionin politik në marrëdhëniet e sigurisë. Siç u tregua në këtë studim, përfitimet afatshkurtra të përdorimit të KPS-ve duhen balancuar me humbjet e mundshme afatgjata në çdo moment të ndarjes së funksioneve e përgjegjësi. Problemi është se janë marrë vendime të izoluara pa një perspektivë të gjerë mbi efektet e privatizimit të sigurisë.

Shtetet eforcentë kanë një përgjegjësi të veçantë për të mbështetur ndryshimet afatgjata të sistemit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të sigurisë dhe për të drejtuar diskutimet rreth tyre. Shtetet e Amerikës së Veriut dhe ato europiane kanë mundësi të zgjedhin nëse do t'i ndajnë këto shërbime, nëse do t'i ndihmojnë projektet e reformës së sigurisë në shtetet e

dobëta e nëse do të mbështesin përpjekjet për krijimin e ambienteve të sigurta pas ndërhyrjeve ushtarake. Nëse ata e marrin seriozisht këtë përgjegjësi, kontraktimi i KPS-ve nuk do shihej si i diktuar nga nevoja.

Për shtetet e dobëta, mbetet rreziku që privatizimi të çojë në heqjen e të drejtave të shtetit. Çdo përpjekje duhet bërë në radhë të parë për inkurajimin e ngritjes së institucioneve të sigurisë së një shteti demokratik e funksionues. Vetëm duke u larguar nga “tirania afatshkurtër e tregut”, shtetet e dobëta dhe të forta mund të shfrytëzojnë lulëzimin e industrisë ndërkombëtare të sigurisë me qëllimin e përballimit të kërcënimeve dhe të promovimit të menaxhimit të drejtë të sigurisë.

Marrë e përkthyer me shkurtime nga Dokumenti Nr. 9 i politikave të SIPRI-t (Instituti Ndërkombëtar i Stokholmit i Kërkimit për Paqen),
janar 2005.

Caroline Holmqvist (Suedi) është studiuese në Programin e SIPRI-t për Konfliktet e Armatosura dhe Menaxhimin e Konflikeve (MA në Marrëdhënie Ndërkombëtare).

Kol. Zeno Jahaj

11 VJET NË MBËSHTETJE TË PAQES KONTRIBUT DOMETHËNËS I SHQIPËRISË NË OPERACIONIN PAQERUAJTËS NË BOSNJE-HERCEGOVINË

Më 4 dhjetor 2007, pikërisht në një ditë simbolike për Forcat tona të Armatosura – 95-vjetorin e krijimit të tyre - Kontingjenti i 21-të Paqeruajtës Shqiptar dorëzon ruajtjen e Bazës në Rajlovac, në afërsi të kryeqytetit Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë, duke përfunduar me sukses pjesëmarrjen 11-vjeçare të Shqipërisë në Operacionet Paqeruajtëse IFOR, SFOR e ALTHEA.

Në vlerësim të rreziqeve të një konflikti...

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, situata politike dhe ajo e sigurisë në Europë kishte ndryshuar rrënjësisht. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar, shumë vende të ish-bllokut komunist kishin ndërmarrë reforma të thella politike e ekonomike dhe kishin hedhur hapa të mëdha drejt lirisë e demokracisë. Era e monologut, e përjashtimit dhe e konfrontimit me kundërshtarët ia kishte lënë vendin erës së dialogut, përfshirjes dhe bashkëpunimit me ta. Rreziku dhe kërcënimi për një luftë të përgjithshme në Europë ishte fashitur.

Por vetë reformat dhe ndryshimet, trashëgimia e hidhur historike, dobësitë e klasës politike, e të tjera, do të përmbanin në vetvete rreziqe e pasigurira të një natyre tjetër, të cilat buronin nga konfliktet etnike dhe efekti i mundshëm dominant i tyre, me abuzimet mbi të drejtat e popujve, etnive e ato humanitare, me paqëndrueshmërinë politike, me ekonominë e dobët, stoqet e armëve të Luftës së Ftohtë etj.

Ajo çka ndodhi në Bosnje-Hercegovinë, rreth 15 vjet më parë, është sa tragjike për t'u kujtuar, aq edhe një mësim për të mos u harruar. Konflikti ishte pranë, në dyer të Europës, pikërisht aty ku ishte provokuar e shkëndijuar Lufta e Parë me përmasa Botërore. Pikërisht aty, 80 vjet më pas, do të niste një konflikt i përgjakshëm tre-katër-vjeçar, gjatë të cilit, popullit prej 3.8 milionë banorësh, do t'i vriteshin mbi 200.000 njerëz, kurse mbi dy milionë të tjerë do të dëboheshin nga vatrat e tyre për t'u emigruar si refugjatë brenda apo jashtë vendit. Do të kryheshin masakra të përmasave të genocidit kolektiv, si ajo e Srebrenicës - nga më të përgjakshmet në histori. Objekte historike – pasuri kulturore të njerëzimit – do të rrafshoheshin, pikërisht në vendin ku, vetëm 10 vjet më parë, më 1984 ishin zhvilluar Lojërat Olimpike Dimërore të Botës!

Në vitin 1995, misioni “i pamundur” i OKB-së ia la mandatin NATO-s. Në këto kushte, në dhjetor të atij viti Aleanca vendosi të nisë operacionin më të madh ushtarak të ndërmarrë ndonjëherë prej saj, duke dërguar në Bosnje-Hercegovinë një Forcë Implementim (IFOR) me mbi 60.000 trupa nga vendet anëtare e partnere të saj. Misioni, natyra e të cilit nuk kishte asnjë ngjashmëri me veprimet ushtarake të kryera në 50 vjet të Luftës së Ftohtë, ngarkonte Aleancën të merrte të gjitha masat për të detyruar, mbështetur e ruajtur paqen sipas Marrëveshjes së Dejtonit, për të ndaluar konfrontimin e mëtejshëm të palëve ndërluftuese, për të mbikëqyrur transferimin e autoritetit në zonat e pushtuara, për të grumbulluar armatimet e rënda etj.

Brenda një viti, IFOR përmbushi me sukses misionin, porse mjedisi vijoi të mbetej megjithatë jo i stabilizuar, jo i sigurtë. Për këto arsye, në dhjetor 1996 u konkludua se ishte e nevojshme të ruhej një prani ushtarake për të siguruar stabilitetin dhe për të konsoliduar paqen. Për këtë, u krijua Forca e Stabilizimit (SFOR) me rreth 31.000 trupa.

Pikërisht në këtë kuadër, dhe vetëm dy vjet pas nënshkrimit të Dokumentit Kuadër të Partneritetit për Paqe me NATO-n, Qeveria Shqiptare shfaqti vullnetin për t'iu bashkuar koalicionit të gjerë të trupave të 22 vendeve të botës demokratike, anëtarë e jo anëtarë të NATO-s pjesëmarrës në

këtë Operacion, duke ofruar kontributin fillimisht të një kontingjenti paqeruajtës prej 37 trupash, dhe pak vite më vonë, pothuaj dyfishin e tij.

Tetë vjet më vonë, ky Operacion do t'ia linte vendin Operacionit Paqeruajtës të emërtuar ALTHEA, me një Forcë ushtarake të drejtuar nga Bashkimi European (EUFOR) prej rreth 7.000 trupash nga 31 shtete anëtare e jo anëtare të BE-së, në të cilin vendi ynë do të vijonte të jepte kontributin e mëparshëm.

Prania, kontributi dhe investimi i mbarë komunitetit ndërkombëtar përmes organizatave autoritare të botës demokratike si OKB, NATO e BE për më shumë se një dhjetëvjeçar, sollën përmirësim të ndjeshëm të mjedisit të sigurisë në vend. Progresi është i paimagjinueshëm në krahasim me gjendjen e mbi dhjetë viteve më parë, ku vendi u zhyt në një traumë ekonomike që u reflektua me rënien 75% të prodhimit të përgjithshëm (GDP). Sot njerëzit nuk rrojnë më në frikë, janë krijuar e po konsolidohen institucionet shtetërore dhe po respektohen të drejtat e etnive dhe ato humanitare. Ndërsa në vitin 1999 vlera e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ishte 166 milionë Euro, vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 këto investime arritën në 1.242 miliardë (bilion) Euro. Nuk është e rastit që, sot, vendi vizitohet nga mbi 500.000 turistë, që do të thotë afërsisht një turist për 8 banorë! Bosnje-Hercegovina ka përcaktuar dhe ka rritje në aspiratën e qartë për t'iu bashkuar plotësisht si partnere e anëtare e NATO-s e BE-së. Është domethënës fakti që, pikërisht në dhjetor 2007, Bosnje-Hercegovina nënshkroi Marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit me BE-në.

Duke vlerësuar këtë mjedis sigurie të përmirësuar ndjeshëm, në shkurt të vitit 2007 BE-ja vendosi që niveli i EUFOR të ristrukturohet, për të qenë koherent me pakësimin e nivelit të kërcënimit. Thelbi i këtij ndryshimi është pakësimi i numrit të trupave të manovrës, të cilat veprojnë vetëm në teatrin e kufizuar operacional, për të kaluar në krijimin e një pranie më të vogël vëzhguese në tërë territorin shtetëror. Për këtë, në fund të vitit 2007 numri i trupave u pakësua deri në nivelin 2.500. Është domethënës fakti që, ndërsa në kulmin e

konfliktit (1992-1995), rreth 500.000 trupa ushtarake e paraushtarake të të gjitha palëve ishin pleksur keqas, duke kryer deri edhe masakra kolektive, në fund të vitit 2007 u arrit që afro 10.000 trupa ushtarake të Bosnje-Hercegovinës të marrin në dorë hap pas hapi ruajtjen dhe sigurinë e vendit. Pikërisht në këtë kuadër, u mbyll misioni afro 11-vjecar i trupave paqeruajtëse shqiptare, pasi u vlerësua se i përmbushi plotësisht dhe me sukses angazhimet e marra.

Kontribut vlerash vitale...

Sikurse është e njohur, është vlerësuar që Lufta e Ftohtë përbënte një kërcënim për interesat vitale, duke përfshirë deri edhe kërcënimin ndaj mbijetesës kombëtare. Pas Luftës së Ftohtë, vlerësohet që konfliktet përbëjnë më së shumti kërcënime për vlerat vitale, injorimi i të cilave, mund të rrezikojë edhe interesat vitale në vend, në rajon e më gjerë. I tillë ishte edhe konflikti në Bosnje-Hercegovinë dhe, në tërësi, ai në të cilin u përfshi Ballkani i pas Luftës së Ftohtë. Për këtë arsye, trajtimi qysh në etapat e fillimit i këtyre konflikteve, përbën një strategji të NATO-s. Shqipërisë i bën nder që, qysh në hapat e parë të konsolidimit demokratik të vendit, vendosi të përzgjedhë rreshtimin pikërisht në këtë strategji, madje duke qenë ndër vendet e para në këtë rreshtim. Kjo përzgjedhje strategjike u manifestua qartë edhe në rreshtimet me Aleancën apo koalicionet demokratike në mbështetje të paqes në Afganistan, në Irak etj.

Kolapsi violent i ish-Jugosllavisë tentoi të kërcënojë e të minojë shumë nga arritjet paqësore në fund të Luftës së Ftohtë. Sa më gjatë të hezitonte komuniteti ndërkombëtar për të ndërmarrë veprime vendimtare, aq më shumë do të acaroheshin situata e sigurisë në të gjithë Europën. Ky ishte një kërcënim për interesat vitale. Porse ishte edhe një kërcënim tjetër: ai i vlerave dhe i etikës demokratike. Shqipëria u rreshtua pikërisht në anën e këtyre vlerave, pikërisht në anën e vendeve që mishëronin këto vlera. Ishte në nderin dhe detyrimin e vlerave të NATO-s të mos i kthente kurrizin Ballkanit. Ndërkaq, ishte në nderin dhe detyrimin e Shqipërisë demokratike të rreshtohesh me NATO-n. (Është brenda kuadrit dhe në respekt

pikërisht të këtyre vlerave, të evokojmë që Shqipëria ka ditur të mbajë qëndrime e të kryejë veprime të drejtpeshuara kur, në disa nga konfliktet e fundit ballkanike, janë goditur apo rrezikuar e kërcënuar interesa jetësore të popullsisë bashkëkombëse shqiptare).

Duke u bashkuar nën një strategji të përbashkët, Aleanca e përmbysi traditën klienteliste të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë, sipas së cilës, Fuqitë e Mëdha mbështesnin vetëm shtetet kliente të Ballkanit. Përkundrazi, në fund të atij shekulli, të gjitha Fuqitë e Mëdha u bashkuan në të njëjtën anë, këtë herë në anën e paqes. Ky bashkim vijon të jetë i qëndrueshëm, sepse mbarimi i luftës nuk do të thotë automatikisht përfundim i konfliktit. Ajo që e karakterizon këtë bashkim është pikërisht qëndrueshmëria dhe besimi në vlerat e angazhimit afatgjatë, me të gjitha rrjedhimet e sakrificat që kërkon ky angazhim. Shprehja e vullnetit për të kontribuar në Misionin Paqeruajtës në Bosnje-Hercegovinë, si dhe shpallja e mbajtja e angazhimeve deri në plotësimin e tyre, kanë rritur prestigjin e Shqipërisë.

Pjesëmarrja shqiptare në Operacionin Paqeruajtës në Bosnje-Hercegovinë, renditet si misioni i parë jashtë Shqipërisë në mbrojtje të vlerave universale demokratike të krijuara e të konsoliduara tashmë brenda vendit. Shqipërisë i bën nder që u rreshtua në krah të Aleancës në operacionin e parë paqeruajtës të udhëhequr prej saj jashtë kufijve tradicionalë të mbrojtjes kolektive. Ky angazhim i parë i vendit tonë me trupa paqeruajtëse jashtë vendit, përkon pikërisht me testin e parë të NATO-s për të marrë përsipër sigurinë “jashtë zone”, si dhe me testin e parë të BE-së për të marrë përsipër angazhime në fushën e sigurisë.

Vlerësime për paqeruajtësit shqiptarë...

Trupat paqeruajtëse shqiptare të kontingjentit të 21-të u vlerësuan dhe u nderuan me dekorata të akorduara nga zoti Javier Solana, Përfaqësues i Lartë i BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë. Komandanti i kontingjentit u dekorua edhe nga Ministri i Mbrojtjes i Republikës Federale të Gjermanisë.

Zëvendësministri i Mbrojtjes i RSH-së, pjesëmarrës në ceremoninë e dorëzimit të ruajtjes së Bazës në Rajlovac, vuri në dukje kontributet 11-vjeçare të mbi 1.300 ushtarakë shqiptarë, që kanë shërbyer me sukses në këtë Mision, në bashkëpunim të ngushtë me trupat gjermane, franceze, italiane e të vendeve të tjera anëtare e partnere të NATO-s/BE-së. Në emër të Qeverisë Shqiptare u shpreh mirënjohja e thellë për Qeverinë Gjermane, për mbështetjen e rëndësishme që ka dhënë në fushën logjistike, stërvitore etj., për të gjitha kontingjentet tona, qysh prej vitit 1996. Falënderime të ngrohta iu drejtuan Qeverisë së Bosnje-Hercegovinës për besimin dhe mbështetjen ndaj trupave të vendit tonë gjatë kryerjes së detyrës.

Ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës, vlerësoi shërbimet efektive të trupave shqiptare, të cilat, në bashkëpunim me trupat gjermane, franceze, italiane e të tjera, kontribuuan në forcimin e sigurisë në vend.

Në vlerësim të kontributeve dhe aftësive të trupave paqeruajtëse shqiptare, Komandanti i Komandës së Operacioneve të Forcave të Armatosura Gjermane tha: “Me kontributin e çmuar në SFOR dhe në EUFOR, ushtarakët e Forcave të Armatosura Shqiptare, jo vetëm kanë lehtësuar dukshmën trupat franceze e gjermane, por nëpërmjet gatishmërisë gjithmonë të lartë dhe angazhimit të tyre, kanë treguar që integrimi i tyre në një mjedis shumëkombësh është i mundshëm dhe pa probleme”.

Mësimet e nxjerra...

Operacioni Paqeruajtës i NATO-s dhe BE-së në Bosnje-Hercegovinë shënon në përmbajtje pikënisjen e vetë procesit të transformimit të tyre, gjë që shkon krahas edhe me kërkesat për transformimin e Forcave tona të Armatosura. Misioni Paqeruajtës Shqiptar në Bosnje-Hercegovinë ishte mesazhi, shkolla dhe përvoja e parë e trupave tona jashtë vendit. Përmes pjesëmarrjes në këtë Operacion, janë nxjerrë mësimet të vlefshme, përvoja praktike dhe ekspozime të qëndrueshme ndaj vlerave perëndimore.

Ky mision krijoi mundësitë për ta kryer këtë “shkollë” në operacion e sipër. Në 21 kontingjentët që kanë shërbyer në këtë

mision, kanë komanduar e drejtuar mbi 100 oficerë, të cilët, në vijim janë rritur jo vetëm në moshë, porse në përvojë e në karrierë, duke integruar në këtë rritje edhe përvojën aq të çmueshme të përfutur gjatë misionit paqeruajtës në Bosnje-Hercegovinë.

Trupat tona u edukuan me qëndrueshmërinë për të garantuar sigurinë e Bazës në Rajlovac, afër Srajevës, por ato edukuan edhe qëndrueshmërinë për t'i shpëtuar "armikut rutinë", d.m.th., rrezikut të ambientimit me "të zakonshmen" gjatë kryerjes së misioneve të ruajtjes. Edukimi i qëndrueshmërisë, i ndjenjës së kolektivitetit, i korrektesës me trupat bashkëvepruese shumëkombëshe dhe me popullatën e përbërë nga nacionalitete, besime fetare e kultura të ndryshme deri edhe të konfliktuara – përbëjnë përvoja të çmuara që pasurojnë librin e madh të mësimave të nxjerra. Operacioni Paqeruajtës në Bosnje-Hercegovinë mëson se, në këto lloj misionesh, çdo veprim operacional është i rëndësishëm dhe se çdo individ apo njësi ka rol kryesor, pavarësisht nga vendi që zë në rendimin operacional. Përvoja e pjesëmarrjes në Operacionin Paqeruajtës në Bosnje-Hercegovinë, dëshmon edhe një herë për evoluimin e koncepteve klasike të luftës. Në këtë Operacion, ashtu si edhe në operacione të tjera të këtij lloji të zhvilluar në këto 10-15 vitet e fundit, u vërtetua se është "tretur" tashmë diferenca midis forcave "në front", me ato "në prapavijë".

Operacione të tilla janë një shkollë më vete edhe në pikëpamje të zgjidhjes së problemeve e vështirësive të komandimit, drejtimit, komunikimit, logjistikës, shkëmbim informacioni etj., në kushtet e një mjedisi shumëkombësh, të disniveleve në teknologji e pajisje midis tyre. Mësimi i nxjerrë në këtë kuadër është domosdoshmëria e stërvitjeve të vijueshme për të siguruar ndërveprueshmëri efikase të operacioneve të ngjashme në të ardhmen.

Një mësim tjetër kyç është ndërgjegjësimi për rëndësinë e zhvillimit sa më të shpejtë dhe sa më efikas të kapaciteteve lokale. Misioni në Bosnje-Hercegovinë vërtetoi se, pa zhvillimin e përpjekjeve e gjetjen e zgjidhjeve krijuese në këtë drejtim, nuk arrihet gjë tjetër, veçse një qark i mbyllur varësie,

ku misionet e NATO-s apo të BE-së rrezikohen të stërzgjeten pa perspektivë. Ishte një zgjidhje e dobishme iniciativa e EUFOR për të zhvendosur balancën nga veprimet operacionale brenda një teatri relativisht të kufizuar operacional, në monitorimin e situatës në të gjithë territorin e vendit, duke krijuar për këtë qëllim rreth 45 Ekipe Bashkërenduese Vëzhgimi (Liasion Observation Team). Këto ekipe të përbëra prej 8-10 ushtarakësh e përkthyesish që operojnë qysh nga shtëpitë e tregtoret e vogla, deri në komunitet, sigurojnë një bashkëpunim të ngushtë me qytetarët dhe autoritetet lokale. Një prani e tillë siguron të dhëna drejtpërdrejt nga terreni për të njohur në çdo kohë evoluimin për mirë apo për keq të situatës dhe për të vlerësuar efektivitetin e reformave. Kjo prani është gjithashtu një mesazh te qytetarët dhe autoritetet lokale se komuniteti ndërkombëtar është i angazhuar për ndryshim e reforma.

Më në fund, ky operacion u shërbeu ushtarakëve tanë, ashtu si edhe partnerëve tanë, të “armatosen” me teknikat dhe ekspertizën për të qenë të frytshëm në menaxhimin e krizave dhe të aftë për t’u marrë me sukses me operacionet komplekse të mbështetjes së paqes.

Me vështrim nga e ardhmja...

Gjendja aktuale në Bosnje-Hercegovinë duket qartazi se është përmirësuar ndjeshëm. Kthimi në armiqësitë e fundshekullit të njëzetë është me të vërtetë i paimagjinueshëm. Gjithsesi, shumë punë mbetet për t’u bërë. Krahas integritit e forcimit të institucioneve, ndjekjes së të dyshuarve si kriminelë të luftës, mbikëqyrjes dhe promovimit të reformave të mbrojtjes, e të tjera, ka ende probleme që lidhen me sigurinë e vendit e, posaçërisht, me jetën e qytetarëve.

Siç është e njohur, për shkak të pozitës qendrore gjeografike e strategjike në kuadër të ish-Jugosllavisë, Bosnje-Hercegovina e pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht kryeqyteti Sarajeva, pat qenë përzgjedhur si bazë për instalimin e objekteve ushtarake strategjike me rëndësi të veçantë. Mjafton të përmendim se përqendrimet e industrisë ushtarake në Sarajevë e rrethina ishin më të mëdhatë në të gjithë ish-Jugosllavinë.

Për rrjedhim, ishte krijuar një arsenal i madh dhe i përqendruar armatimesh e municionesh. Ky fakt mund të renditet ndër faktorët kryesorë pse konflikti i viteve '90 u ndez më i ashpër pikërisht në Bosnje-Hercegovinë. Aktualisht, janë identifikuar më shumë se 11.000 vatra të minuara e municionesh të paplasura në të gjithë vendin. Sipas ritmeve të sotme të çminimit, do të duhen disa dhjetëvjeçarë për pastrimin e tyre. Siç është e natyrshme, municionet e paplasura dhe fushat e minuara përbëjnë një pengesë të madhe për promovimin e ekonomisë, bujqësisë, turizmit, punësimin e njerëzve etj. Mbi të gjitha, prania e tyre mban gjallë ankthin e pasigurisë. Mjafton të sillet në kujtesë që vetëm në 5 vitet e fundit janë aksidentuar nga minat apo municionet e paplasura mbi 100 qytetarë.

Në vlerësim të këtij mjedisi ende të pasigurtë, Shqipëria ka shprehur vullnetin dhe ka ofruar vijimin e kontributit në Bosnje-Hercegovinë me një ekip të certifikuar xhenier çminimi, duke demonstruar kështu shkallën e përgjegjësisë të një vendi, i cili i sheh kontributet dhe sigurinë rajonale e më gjerë si detyrime të përhershme, jo si çështje fushatash, interesash të çastit, apo në funksion të koniunkturave politike-diplomatike.

BRIEF SUMMERY IN ENGLISH

(This issue is edited by Erjon Alikaj & Elira Hroni)

From Comprehensive Approach to Comprehensive Capability

Friis Arne Petersen and Hans Binnendijk argue that the Bucharest Summit could be the right stage for taking the next step towards better civilian-military cooperation.

The more effective the civil-military team, the quicker the operation moves to subsequent phases and ultimately its culmination and drawdown, reducing deployment times, costs and casualties, both civilian and military. There is a compelling case for a standing NATO capability and agreements for advanced planning and more effectively integrated civilian-military teams.

With that in mind, NATO should re-double its efforts to move beyond the current limited ad hoc arrangements, and take another step at Bucharest to ensure that the Comprehensive Approach initiative moves closer to a Comprehensive Capability.

Rethinking NATO Partnerships for the 21st Century

Security threats today are globalized and non-traditional. It's time for NATO's partnerships to follow suit, says Ron Asmus.

If one poses these questions today in Brussels, one is often met with an awkward silence – just like in the very early 1990s. Partnerships once again seem to belong to the 'too hard to handle' category. In reality, the requirement to creatively re-

think partnership as a new tool for the world in which we live is greater than ever. The problem we need to resolve is finding the common purpose and political will to decide what we want to achieve strategically. Then there will be enough smart people at NATO that will help us modernize our arsenal of partnerships to help achieve those goals.

Tales of the past, lessons for the future

Petr Lunak reviews Lawrence Kaplan's latest book, which looks at how the fortunes of the Warsaw Pact and NATO differed – and why.

It would have been logical for NATO to die too, without a whimper, if it had been a US imposition on Western Europeans, obliged to accept it in the face of the Soviet military and political threat. But that is not what NATO was.

'Joseph Stalin achieved the exact opposite of what he had hoped for - NATO Secretary General, the Belgian Paul-Henri Spaak, once quipped that NATO should erect a statue to Stalin'. Even today, one can ask: without Stalin overplaying his hand in Eastern Europe and Berlin, would NATO have emerged as we know it?

Regional Security & Regional Ownership

Gen. Lt. Pellumb Qazimi, Ambassador of the Republic of Albania in the Republic of Croatia, is presenting a comprehensive analysis on the Security Sector Reform and Security Sector Governance in South East European countries and broader.

The primary objective of the SEE countries is to strengthen the good neighborly relations among all states in the region, for transforming this region into an area of peace, security, stability and cooperation. European vocation of the Balkans is indisputable; this is a part of Europe geographically and culturally. The aim is to create a SEE whose future lies in peace,

democracy, economic prosperity and full integration into European and Euro-Atlantic structures.

NATO and the Madonna Curve: why a new Strategic Concept is vital

Peter van Ham argues that NATO's remodeling is urgent. NATO's makeover should start with an attempt to forge a new Strategic Concept.

In its multifunctionality, NATO begins to resemble a Swiss pocket-knife with all its tools exposed. But as we all know, unfolded pocket-knives are unwieldy affairs, and whilst prepared to do everything, are actually good at nothing. This is why NATO needs to retool itself, starting with a revision of its outdated strategic concept.

Businesses use Madonna as a role model of self-reinvention. Now it's NATO's turn.

The quality of adapting to new tasks whilst staying true to one's own principles is something which business analysts qualify as the Madonna-curve. This curve is named after the legendary pop-diva who reinvented herself each time her style and stardom went into inevitable decline, but whose audacity has lifted her up to ever higher levels of relevance and fame.

Towards a Practical Human Security Agenda

*The following is a Policy Paper published by DCAF, and written by **Keith Krause**, Professor of International Politics at the Graduate Institute of International Studies, Geneva, Director of its Programme for Strategic and International Security Studies.*

In this document, Professor Krause elaborates on the concept of "human security," which today is widely used by a wide range of governments, international organizations and non-governmental organization (NGOs), is only the latest in a long series of attempts to broaden traditional conceptions of security. Divided in seven chapters, the author describes the

origins and diffusion of the human security concept; two visions of human security, the provision of security and public order, the subordination of armed forces to civil authority, the dynamic between human and state security and a concrete agenda for political action.

Lastly, the author concludes that the contemporary promotion of human security is the culmination of the liberal project of building strong, legitimate and representative political institutions. It has its roots in enlightenment ideas of the importance of individual rights and personal freedoms. And if the 20th century can be characterized as the century of the “national security state”, perhaps the 21st will unfold under the sign of human security.

**Partnership for Peace Seminar:
Critical Infrastructure Protection and Civil Emergency
Planning, November 17–18, 2003, Stockholm, Sweden**

Ms Ann-Louise Eksborg and other attendants of the Seminar through an interview give their opinions about the Critical Infrastructure Protection and Civil Emergency Planning.

“Cross-border co-ordination is more important than ever. We can no longer rely on national solutions for handling threats and vulnerabilities that are European, or global, in nature. In this intricate state of vulnerable inter-dependence, the protection of our critical infrastructure is only as strong as the weakest link. And we no longer have a choice. Safeguarding the functional security of our society must be a joint venture; it requires a common commitment from governments, industry, organizations and academia”.

**Policy Brief - Towards a New Approach
for Crime Prevention**

This policy brief is a product of IDM Centre for Security Studies.

Crime prevention constitutes one of the core issues and most important tasks of a civilized society. At the core of the philosophy and justification of the creation and existence of specialized institutions set up on purpose for ensuring public order, stands indeed the responsibility for crime prevention.

The existing legislation which regulates the organization and performance of institutions in Albania, does not provide always for a legal obligation on preventive work, this being one of the most important steps and with the most sustainable impact in time.

Lack of a comprehensive legal framework and respective structures for crime prevention affects not only the engagement and joint concerns of all elected or appointed State institutions, but also the success of efforts made and the duration of current situation. The often encountered consideration that prevention is merely a Police duty not only is unprofessional, but also unproductive. In fact, addressing such phenomena is a responsibility of the State and entire society.

Private Security Companies, the Case for Regulation

IDM follows the publications on current trends in private security industry. It brings this time the Policy Paper of Caroline Holmqvist, Research Assistant of SIPRI.

The private provision of security and military services challenges conventional assumptions about the roles of the nation state as the main protagonist in military affairs and as the guarantor of physical security for its citizens. In the absence of effective legal or regulatory structures, such activities raise issues of legality, legitimacy and accountability in the sphere of security policy. This study assesses the impact of 'the privatization of security' in various security contexts and examines some of the ways in which the international community might respond to this development.

For the weak state, the risk that privatization will lead to a disenfranchising of the state remains. Every effort must be made to encourage the establishment of functioning and

democratic state security institutions in the first place. Only by escaping from the short-term ‘tyranny of the market’ can weak and strong states alike harness the burgeoning international security industry with the aim of countering threats and promoting equitable security governance.

**11 YEARS SUPPORTING PEACE –
Significant contribution of Albania
to the peace-keeping operation in Bosnia-Herzegovina.**

Col. Zeno Jahaj analyzes and gives his considerations on the situation in this country, starting from the war years, peace-keeping operations of UN and NATO, to actual reality. For the first time Albania contributed abroad with a military mission, in support of peace what beyond the success it had was also a big step toward reaching its Allies’ professionalism.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 7

Formati: 15,5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 22 40 116
Tiranë, 2008